FORUMI I GRUAS ELBASAN

# ZBATUESHMËRIA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE E KONVENTËS SË STAMBOLLIT NË SHQIPËRI



FORUMI I GRUAS ELBASAN



# ZBATUESHMËRIA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE E KONVENTËS SË STAMBOLLIT NË SHQIPËRI

FORUMI I GRUAS ELBASAN

**FORUMI I GRUAS, SHTATOR 2023**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky publikim është realizuar me mbështetje financiare nga Ministria e Punëve të Jashtëme Norvegjeze, në kuadër të programit rajonal 'Smart' - shoqëri civile për vlera të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor". Përmbajtja është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve

# Mbi Forumin e Gruas Elbasan

Forumi i Gruas Elbasan (FGE) është një Organizatë Jo Fitimprurëse (OJF), e themeluar në gusht të vitit 1991, si degë e Forumit të Pavarur të Gruas Shqiptare, e para shoqatë e këtij lloji e krijuar në rrethin e Elbasanit, menjëherë pas ndryshimeve politike që ndodhën në vendin tonë.

Më 7 Janar të vitit 2000, Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve vendosi krijimin dhe regjistrimin e Forumit të Gruas Elbasan në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, si subjekt i pavarur juridik dhe më vonë FGE ri-regjistrohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, konform ligjit të Organizatave Jo Fitimprurëse (OJF), me numër vendimi 4030/1 datë 10.07.2003, ri-regjistruar me numër vendimi 4030/2 dt 16.07.2015 më datë 21.07.2021.
Organizata është e përbërë nga **Asambleja e Përgjithshme e Anëtareve dhe Presidentja.**

**<u>Vizioni i organizatës</u>**
Grua e fuqizuar, familje dhe shoqëri e emancipuar.

**<u>Misioni i organizatës</u>**
FGE synon mbrojtjen e të drejtave të grave dhe arritjen e barazisë gjinore përmes programeve të edukimit, ndërgjegjësimit, avokatisë, shërbimeve psiko-sociale e ligjore kundër dhunës ndaj gruas si dhe përmes shërbimeve të tjera alternative.

*Forumi i Gruas Elbasan* ka një staf profesionistësh të kualifikuar dhe të trainuar, që ofrojnë shërbime dhe ekspertizë nëpërmjet:

***Qendrës së Këshillimit, Studios Avokatore dhe Strehëzës së Emergjencës***

FGE është liçensuar nga MPÇSSHB, sot MSHMS, si organizatë për ofrimin e shërbimeve sociale.
Në Qershor 2011 FGE është liçensuar nga QKL me numër liçence 3495-06-2011.

Ministri i Drejtësisë e autorizon "Forumin e Gruas Elbasan" për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore, të garantuar nga shteti për kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike

Në të parin konkurs kombëtar "Për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror" FGE vlerësohet me çmimin e dytë. Konkursi u organizua nga Fondacioni Partnerët Shqipëri me porosi të UNDP, me mbështetjen e AZZHN, në bashkëpunim me qeverinë shqiptare, konkretisht të MSHMS.

Bashkia e Elbasanit i jep titullin Mirënjohja e Qytetit shoqatës "Forumi i Gruas Elbasan", me motivacionin: "Për kontributin e çmuar në plotësimin e nevojave sociale të qytetit dhe për cilësinë e lartë në ofrimin e shërbimeve, me qëllim përmirësimin e jetës së gruas dhe vajzës në komunitet."
FGE është anëtare e rjetit europian WAVE dhe atij kombëtar AWEN.

FGE është anëtare e KRAT, pranë Institucionit të Prefektiturës, Qarku i Elbasanit dhe anëtare e Komitetit Drejtues dhe Ekipit Teknik në 7 bashkitë e Qarkut të Elbasanit, për "Mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe për mënyrën e proçedimit të tij".

# Përmbajtja


RRETH FORUMIT TË GRUAS ELBASAN ..... 4

MIRËNJOHJE ..... 6

LISTA E SHKURTIMEVE ..... 7

HYRJE ..... 9

INFORMACION RRETH PROJEKTIT ..... 10

BAZA LIGJORE ..... 12

METEODOLOGJIA ..... 22

SITUATA EDHUNËS NË NIVEL BOTËROR DHE NË SHQIPËRI ..... 25

SI JANË SHPREHUR INSTITUCIONET GJATË INTERVISTAVE ..... 26

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE ..... 28

DREJTORIA E PËRGJITHËSHME E POLICISË SË SHTETIT ..... 40

MINISTRIA E BRENDËSHME ..... 42

MINISTRIA E DREJTËSISË ..... 44

MINISTRIA E FINANCAVE ..... 48

AVOKATI I POPULLIT ..... 49

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI ..... 52

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT ..... 54

ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE ..... 59

PYETSORËT ..... 73

INTERPRETIMI I PYETSOREVE ..... 74

Shtojcat ..... 143

- Shtojca 1. Modeli i pyetësorit ..... 143
- Shtojca 2. Kërkesa për bashkëpunim ..... 148
- Shtojca 3. Baza ligjore ..... 149

# MIRËNJOHJE


FORUMI I GRUAS ELBASAN, në bashkëpunim me *SOS Hotline for Women and Children Victims of Violence, Niksic (SOS Telefon za žene I djecu žrtve nasilja Nikšić) dhe Women's Wellness Centre* (WWC) - Qendra për Mirëqenien e Gruas (QMG) po zbatojnë projektin me titull:

*"Improved implementation of Istanbul Convention in Eestern Balkan region"* (Zbatueshmëria ligjore e Konventës së Stambollit në Shqipëri) për një periudhë 18 mujore, 1 Janar, 2023 deri më 30 Qershor 2023.

Në këtë projekt organizata lider është organizata nga Mali i Zi: *SOS Hotline for Women and Children Victims of Violence, Niksic* (SOS Telefon za žene i djecu žrtve nasilja Nikšić). Ky projekt ballkanik mbështetet nga *Centar za promociju civilnog društva* (CPCD) në partneritet me I*nstitutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim* (IDM) dhe *Center for Research and Policy Making* (CRPM), i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA).

FGE i shpreh mirënjohjen në radhë të parë donatorëve që mundësuan realizimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm për veprimtarinë e përditëshme të FGE, si dhe dy OJF-ve të me të cilat po bashkëpunojmë për herë të parë në historinë shumë vjeçare të ekzistencës së FGE.

FGE, që nga nëntori i vitit 1999 dhe deri më sot ka punuar dhe punon kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj gruas në përgjithësi në Qarkun e Elbasanit, por jo vetëm, veçanërisht përmes shërbimeve konkrete për të mbijetuarat e dhunës në familje si :

a. Këshillim psikologjik
b. Këshillim ligjor dhe përfaqësim falas në gjykatë, për procese divorci për shkak të dhunës, për marrjen e Urdhërit Mbrojtës (UMM/UM) në momentin e denoncimit të dhunës.
c. Strehim Emergjent deri në marrjen e UMM/UM-së.

Drejtime shumë të rëndësishme të punës së FGE janë gjithashtu:

1. Ndërgjegjësimi i komunitetit për t'i thënë 'stop dhunës në familje'
2. Ndërtimi i kapaciteteve të aktorëve lokalë për të zbatuar detyrimet ligjore në punën e përditëshme të tyre.

Në këtë mënyrë zbatimi i këtij projekti ishte shumë i rëndësishëm për stafin e FGE, pasi lidhet drejtpërdrejt me verpimtarinë 23-vjeçare të FGE. *Konventa e Stambollit apo siç njihet Konventa e Stambollit kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje* është një instrument shumë i fuqshëm, që na mbështet në punën tonë të përditëshme.

Ju shprehim edhe një herë falenderimet tona, që na mundësuat të zbatojmë këtë projekt.

## LISTA E SHKURTIMEVE

| | |
|---|---|
| BE | Bashkimi Evropian |
| BGJ | Barazia Gjinore |
| DHF | Dhunë në Familje |
| GREVIO | Grup i Pavarur Ekspertësh |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| PSHSH | Policia e Shtetit Shqiptar |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MB | Ministria e Brendshme |
| MAS | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| MBZHR | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| MM | Ministria e Mbrojtjes |
| MTM | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |
| DNJF | Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas |
| INSTAT | Instituti i Statistikave në Shqipëri |
| KMD | Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminim |
| AP | Avokati i Popullit |
| MPÇSSHB | Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta |
| MKR | Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje |
| NJVV | Njësi të Vetëqeverisjes Vendore |
| KDHF | Kordinator të Dhunës në Familje |
| NJMF | Njësi të Mbrojtjes së Fëmijëve |
| NBGJ | Nënpunës i Barazisë Gjinore |
| SDHFMF | Specialist për Dhunën në Familje dhe Mbrojtjen e Fëmijëve |
| OJF | Organizatë Jo-Fitimprurëse |
| OS | Objektiv Specifik |
| SKBGJ | Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| DVP | Drejtoritë Vendore të Policisë |
| UM | Urdhër Mbrojtjeje |
| UMM | Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje |

| | |
|---|---|
| UMPMM | Urdhri për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme |
| ASPA | Sholla Shqiptare e Administratës Publike |
| FGE | Forumi i Gruas Elbasan |
| AWEN | Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri |
| QNLQ | Qëndra për Nisma Ligjore Qytetare |
| CRCSA | Qëndra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri |
| AZZHN | Agjensisë Zvicеriane për Zhvillim Ndërkombëtar |
| KRAT | Komiteti Rajonal Antitrafik |

## HYRJE

Shqipëria e ka nënshkruar Konventën e Stambollit më 19 Dhjetor 2011 dhe ishte vendi i dytë anëtar i Këshillit të Evropës që ratifikoi Konventën më 4 Shkurt 2013. Shqipëria e ratifikoi Konventën pa asnjë rezervë. Konventa hyri në fuqi në Shqipëri më 1 Gusht 2014.

Konventa e Stambollit është traktati me shtrirjen më të gjerë ndërkombëtare, që trajton dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Tërësia e dispozitave të saj gjithëpërfshirëse përfshin masa parandaluese dhe mbrojtëse me në nivel të gjerë, si dhe një numër detyrimesh për të garantuar përgjigjen e duhur të drejtësisë penale ndaj shkeljeve kaq të rënda të të drejtave të njeriut. Ajo mbulon fusha të patrajtuara më pare, duke kërkuar që të analizohen shkaqet rrënjësore të dhunës ndaj grave (si p.sh. stereotipizimi gjinor, traditat e dëmshme për gratë dhe në përgjithësi shfaqjet e përgjithshme të pabarazisë gjinore).

Konventa ngre një mekanizëm monitorimi për të vlerësuar nivelin e zbatimit nga Palët. Ky mekanizëm monitorimi ngrihet mbi dy shtylla: Grupi i Ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO), një grup i pavarur ekspertësh dhe Komiteti i Palëve, një organ politik i përbërë nga përfaqësues zyrtarë të Palëve në Konventë.

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) u hap për nënshkrim në Stamboll më 11 maj 2011 dhe hyri në fuqi në 2014. Konventa e Stambollit deklaron se burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta dhe i detyron autoritetet e vendit të ndërmarrin hapa për të parandaluar dhunën ndaj grave, për të mbrojtur viktimat dhe për të sjellë autorët para drejtësisë. Konventa siguron mbrojtje kundër formave të dhunës, që shpesh nuk janë të parashikuara në ligjet kombëtare, si ngacmimi seksual ose martesa e detyruar si dhe kërkon mbrojtje për të gjitha viktimat, pavarësisht nga mosha, origjina, seksualiteti ose statusi i emigrimit.

## INFORMACION RRETH PROJEKTIT

**Qëllimi kryesor i projektit**: Të kontribuojë në integrimin sa më të shpejtë të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, duke fuqizuar OJQ-të për një rol më të fortë dhe aktiv në monitorimin e zbatimit të Konventës së Stambollit.

**Objektivat specifikë janë dy:**

1. Forcimi i kapaciteteve të OJQ-ve lokale për avokati para institucioneve, me fokus efektet dhe rëndësinë e barazisë gjinore në procesin e anëtarësimit në BE.

2. Forcimi i përgjegjësisë së Qeverisë dhe Pushtetit Vendor në zbatimin e detyrimeve të marra nga ratifikimi i Konventave Ndërkombëtare.

***Përfituesit direktë dhe indirektë:***

Përfitues të drejtpërdrejtë të këtij projekti janë OJF-të lokale, të rinjtë, veçanërisht studentët, ofruesit e ardhshëm të shërbimeve të specializuara dhe gratë dhe fëmijët të mbijetuar të dhunës.

Përfitues indirektë të këtij projekti janë të gjitha grate, fëmijët dhe të gjithë shtetasit e Malit të Zi, të Shqipërisë dhe të Kosovës.

**Aktivitetet e projektit:**

1- Kryerja e një studimi kërkimor midis OJF-ve, studentëve dhe përfaqësuesve të institucioneve përkatëse (veçanërisht të qeverive në 3 vendet e synuara) mbi Konventën e Stambollit. Ky botim është në përputhje me këtë aktivitet.

2- Organizimi i workshopeve për OJF-të në 3 vendet e synuara, për të përmirësuar kapacitetet e tyre se si të angazhohen në mënyrë efektive në dialog me qeveritë, me fokus ndërgjegjësimin e këtyre aktorëve për dimensionin gjinor të procesit të anëtarësimit në BE, për rëndësinë e tij në këto role.

3- Kryerja e një fushate të vazhdueshme për Konventën e Stambollit dhe për rëndësinë e saj për Malin e Zi, Shqipërinë dhe Kosovën dhe shtetësinë e tyre, veçanërisht për gratë e veçanërisht në procesin e anëtarësimit në BE. Fushata do të zhvillohet online përmes postimeve në rrjetet sociale si dhe në komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët.

4- Organizimi i 9 takimeve (klasave) publike në Mal të Zi, Shqipëri dhe Kosovë. Çdo takim do të organizohet me tema të ndryshme (Nene nga Konventa) dhe do të regjistrohet. Materialet video nga takimet publike do të përdoren dhe do të prezantohen për publikun nga mediat sociale.

Do të ftojmë përfaqësues të Sekretariateve të Qeverisë dhe Organeve për Barazi Gjinore, anëtarë të Komisionit për Barazi Gjinore dhe Koordinim, që të marrin pjesë aktive në këto ngjarje publike për t'i njoftuar qytetarët me përgjegjësitë që ka marrë shteti me ratifikimin e konventave ndërkombëtare dhe përfitimet që aplikimi i tyre ka në procesin e anëtarësimit në BE.

5- Organizimi i prezantimeve të shkurtra gjysmë ore të Konventës në universitete, me miratimin e mëparshëm të drejtuesve. Në kuadër të këtyre prezantimeve do t'i njohim studentët, ofruesit e ardhshëm të shërbimeve me Konventën dhe nenet e saj, çka do të çojë më tej në një mbrojtje më të mirë të grave, ndërgjegjësim më të mirë të publikut për problemin e dhunës ndaj grave në shërbimet e disponueshme; detyrime të cilat qeveria ka marrë përsipër me ratifikimin e Konventës për të mbrojtur gratë në përgjithësi dhe veçanërisht gratë e mbijetuara të dhunës.

**Rezultatet e projektit:**

**Rezultati 1:** Kapacitetet e OJQ-ve nga 3 vende të synuara për monitorim dhe analizë gjinore janë rritur.

**Rezultati 2:** Zhvillim i partneritetit të fortë rajonal midis organizatave të grave, zyrtarëve të qeverisë kombëtare dhe aktorëve të tjerë publikë përkatës në procesin e zbatimit të Konventave.

**Rezultati 3:** Rritja e efektivitetit të qytetarëve, duke ndikuar në zbatimin më të mirë të Konventave për Qeverisjen në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

# I. BAZA LIGJORE E PËRGATITUR NË SHQIPËRI NË ZBATIM TË KONVENTËS SË STAMBOLLIT

Studimi filloi me bazën ligjore në web. Si detyrim nga Konventa e Këshillit të Europës pas ratifikimit të saj, u shqyrtua me shumë kujdes e gjitha baza ligjore që shteti shqiptar ka përgatitur që nga Gushti i vitit 2014 e deri më sot, e cila është si më poshtë:.

- **Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave"** (e njohur me akronimet Konventa CEDAW), aderuar me ligjin nr.7767/9.11.1993.

Në kuadrin e OKB-së kjo konventë është një nga dokumentet më të rëndësishme që mbron dhe promovon të drejtat njerëzore të grave, ku pabarazitë gjinore kuptohen si pabarazi të prodhuara nga diskriminimi me bazë seksin. Të gjitha të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, dhe të drejtat specifike që përbëjnë shqetësim për gratë dhe vajzat mund të vihen në rrezik në rastet kur kemi të bëjmë me viktima të dhunës në familje. Konventa CEDAW ka disa dispozita të rëndësishme të cilat përfshijnë:

a) zbatimin e mos-diskriminimit përveç në jetën publike, edhe në atë private;

b) shqetësimin e posaçëm për sa i përket grave të fshatit.

Konventa përbëhet nga një hyrje, e cila pasohet nga tridhjetë nene. Hyrja përcakton qartë se të gjitha format dhe shfaqjet e diskriminimit ndaj grave shkelin "parimin e barazisë së të drejtave dhe respektin për dinjitetin njerëzor". Komiteti CEDAW në rekomandimin e tij të përgjithshëm për dhunën ndaj grave nr. 19 (1992), përditësuar me REKOMANDIMIN E PËRGJITHSHËM NR. 35, (2017) ndihmoi për garantimin e njohjes së dhunës me bazë gjinore ndaj grave si formë e diskriminimit ndaj grave.[1] Ky rekomandim është frymëzuar nga Konventa e Stambollit.

Komiteti CEDAW ka një jurisprudencë të pasur të e cila mund të hulumtohet me qëllim kuptimin praktik të konventës dhe kuptimit të masave që priten të merren prej autoriteteve në situata të dhunës ndaj grave dhe të dhunës me bazë gjinore e diskriminimit gjinor.

Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" (e njohur shkurtimisht si Konventa e Stambollit) dhe e ratifikuar nga vendi ynë me ligjin nr. 104/8.11.2012.

[1] *Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grave në terma të përgjithshme thekson nevojën për: "pjesëmarrje aktive të të gjithë aktorëve relevantë, siç janë organizatat e grave dhe ato që përfaqësojnë grupet e margjinalizuara të grave dhe vajzave, për të adresuar dhe çrrënjosur stereotipat, paragjykimet, zakonet dhe praktikat e përcaktuara në nenin 5 të konventës CEDAW, që e falin ose nxisin dhunën me bazë gjinore kundër grave dhe mbështesin pabarazinë strukturore të grave me burrat".*

Konventa e Stambollit vendosi, për herë të parë, instrumente detyruese ligjore për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, për të mbrojtur viktimat e saj dhe për të dënuar autorët. Konventa e Stambollit plotëson një boshllëk të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut për gratë dhe nxit palët të shtrijnë mbrojtjen e saj te të gjitha viktimat e dhunës në familje. Konventa e Stambollit gjithashtu e vendos çrrënjosjen e dhunës ndaj grave në një kontekst më të gjerë të arritjes së barazisë thelbësore ndërmjet grave dhe burrave duke çuar më tej, në këtë mënyrë, njohjen e dhunës ndaj grave si formë e diskriminimit. Që nga gushti 2021, Konventa e Stambollit është nënshkruar nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe është ratifikuar nga 21 prej tyre.
Pra, shkurtimisht, Konventa e Stambollit nënvizon se shtetet duhet të marrin masat e duhura me qëllim parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen penale dhe politikat e integruara. Vetë Konventa përmban një gamë masash parandaluese, mbrojtëse dhe kompensuese për viktimat. Gjithashtu, ajo parashikon masa ndëshkuese kundër autorëve edhe për format e dhunës, që kërkojnë reagimin e së drejtës penale

- **LIGJI Nr. 9669, datë 18.12.2006 PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE** (Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

Ligji ka parashikuar si legjislacion të zbatueshëm Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (CEDAW) si dhe Konventën e Këshillit të Europës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”. Në këtë këndvështrim, të gjitha autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit si dhe gjykatat, marrin në konsideratë masat e parashikuara në këto Konventa për mbrojtjen e grave e të vajzave. Këtë e kemi në vëmendje për faktin se këto Konventa janë të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe kanë fuqi mbi ligjet. Përmbajtja e nenit 1 e shtrin qëllimin e ligjit vetëm për dhunën në familje, pavarësisht nga gjinia. Ndërkohë, sa u përket shkaqeve të dhunës, ka një shtrirje të gjerë, për çfarëdo shkaku që ka sjellë dhunë midis anëtarëve të familjes. Sidoqoftë, ne nuk shohim pengesë që në bazë të Konventës së Stambollit të kërkohen përpara gjykatës masa mbrojtëse për rastet e dhunës ndaj grave, edhe në rastet kur nuk ushtrohet nga anëtarët e familjes. Nuk ka asnjë pengesë që dispozitat e kësaj Konvente të zbatohen drejtpërdrejt. Mbi këtë bazë, VKM-ja nr. 327/2021 , krahas shërbimeve për viktimat e dhunës në familje ka parashikuar shërbime mbështetëse për gratë edhe nëse dhuna është ushtruar jashtë marrëdhënieve familjare sipas parashikimeve të familjarëve në bazë të këtij ligji. Historiku i ndryshimeve të ligjit në vite, përmbajtja e tij është shtuar përkatësisht me ligjin e vitit 2018 dhe ligjin e vitit 2020. Të dyja këto ligje kanë sjellë ndryshime në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (2006). Ndryshimi i parë konsiston në shtojcën që lejon të ndërmerren edhe masa të tjera të nevojshme, krahas masave ligjore, për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, si dhe për garantimin e mbrojtjes të pjesëtarëve të familjes. Ndryshimi i dytë konsiston në shtimin e subjekteve të veçanta që mbrohen nga ligji: gratë dhe vajzat.

Ligji i Dhunës në Familje (LDHF) evidenton krijimin dhe ndërveprimin në mënyrë të koordinuar të "një rrjeti institucionesh". Zbatimi në praktikë i LDHF-së ka treguar gjithnjë e më shumë se sa e rëndësishme është të saktësohet se cilat janë këto institucione dhe se kush bën çfarë, me qëllim që të mos krijohet konfuzion mes tyre dhe shërbimeve që ato ofrojnë. Legjislatori synon të tregojë qartazi se beteja kundër dhunës në familje nuk është e lehtë dhe kërkon mobilizimin dhe marrjen e përgjegjësive prej shumë aktorëve, me qëllim që secili prej tyre dhe të gjithë së bashku të marrin masat e duhura dhe të kujdesen për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje. Këto përbëjnë edhe drejtimet kryesore të veprimtarisë së rrjetit të institucioneve. Një aktor i vetëm e ka të pamundur të marrë përsipër gjithë gamën e detyrave dhe nevojave të një rasti të dhunës në familje, që siç ka treguar realiteti është me një sërë problemesh që duhet të mbahen në vëmendje. Krijimi i rrjetit është një domosdoshmëri, por edhe një sfidë njëkohësisht, pasi të gjithë aktorët e tij duhet të punojnë në sinkron për t'i dhënë përgjigje dhe mbështetje rastit konkret. Për këtë, pritet që legjislatori ashtu sikurse nënvizon neni 2, germa "b" e këtij ligji, të japë orientimet e duhura se si krijohen këto struktura me qëllim që t'i japin mbështetjen viktimave dhe të parandalojnë dhunën në familje. Sikurse e përmendëm, ky rrjet autoritetesh elaborohet më shumë në komentet e bëra për nenet e kreut II të LDHF-së dhe në aktet nënligjore në fuqi, ku një vend të veçantë zë VKM-ja nr. 327/2017.

Në këtë drejtim vihet re se së pari, përcaktimi i autoriteteve që janë pjesë e këtij rrjeti/ mekanizmi nuk është rastësor, por i lidhur ngushtësisht me nevojat dhe me funksionet e domosdoshme në lidhje me viktimën, përfshi këtu edhe ato për rehabilitimin e dhunuesit, dhe, së dyti, nënvizohet se këto institucione në kryerjen e detyrës së tyre mbajnë përgjegjësi sipas përcaktimeve të detyrave të ngarkuara në këtë ligj dhe aktet normative në fuqi në bazë dhe për zbatim të ligjit (shih për shembull VKM-në nr. 327/2021 etj.). Lidhur me parandalimin, autoritetet mbajnë në konsideratë se përveç LDHF-së rëndësi kanë parashikimet e kreut III mbi parandalimin dhe kreut IV mbi mbrojtjen dhe mbështetjen të përcaktuara prej Konventës së Stambollit.

- **LIGJ Nr. 47/2018, PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9669, datë 18.12.2006, "PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE",** i ndryshuar, e përkufizon dhunën si më poshtë:

1."Dhunë" është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.

2. "Dhunë në familje" është çdo akt dhune, i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

3. "Dhunues/e" është personi i dyshuar dhe/ose i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.

4. “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Termi “i mitur”, i përdorur në këtë ligj, ka të njëjtin kuptim.

5. “Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje” (më poshtë MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.

6. “Njësi shtëpiake” është banesa ose çdo mjedis i përdorur dhe i përshtatur si i tillë, pavarësisht nëse është në pronësi ose në përdorim të familjes.

7. “Pjesëtarë të familjes” janë:

a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish bashkëshorti/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues;
b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake;
c) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nëpërmjet birësimit;
ç) prindërit e bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es, përfshirë dhe thjeshtrin/ thjeshtrën, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi;
d) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e birësuar të bashkëshortit /es ose bashkëjetuesit/es;
dh) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, bashkëshortes, bashkëjetuesit/es;
e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues;
ë) personat, të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje;
f) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuar dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të kodit të familjes.”.

8. “Marrëdhënie intime” është marrëdhënia ndërpersonale që përfshin intimitet fizik ose emocional.

9. “Viktimë “është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

10. “Urdhër Mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët dhe sipas rastit, masa për rehabilitimin e dhunuesit.

11. “Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate.

12. “Urdhëri për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme” është urdhëri i arsyetuar dhe i lëshuar sipas parashikimeve të nenit 13/1, të këtij ligji, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë policisë së shtetit, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.”

*<u>Shënim:</u> Informacion më të zgjeruar për këtë kapitull do të gjeni në Shtojcën nr.3.*

## II. FORMAT E ABUZIMIT, sipas studimeve të ndryshme, janë:

- ABUZIMI FIZIK
- ABUZIMI DHE SHFRYTËZIMI SEKSUAL
- ABUZIMI EMOCIONAL
- ABUZIMI EKONOMIK OSE FINANCIAR

***Dhunë fizike*** përkufizohet "përdorimi i forcës fizike kundër dikujt në një mënyrë që lëndon, dëmton, ose e rrezikon atë person".

***Dhuna fizike përfshin:***

- shtyrjen
- gërvishtjen
- goditjet, frakturat
- pickimin, kafshimin
- të rrahurën, torturat
- mbylljen në shtëpi të partneres
- kërcënimet me thikë, përdorimi i armëve
- refuzimin për ta ndihmuar gruan në shtatzani ose sëmundje
- ndërprerjen e shtatzanisë pa pëlqimin e gruas
- braktisjen e partneres në situata të rrezikshme
- shtyrjen për vetëvrasje

***Dhunë seksuale përkufizohet:*** "çdo akt seksual, çdo përpjekje për të kryer një akt seksual, komente seksuale të padëshiruara, ose çdo veprim tjetër kundrejt seksualitetit të një personi duke përdorur shtrëngim, nga cilido person, pavarësisht nga marrëdhënia e tyre me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë, por pa u kufizuar në shtëpi dhe punë. Shtrëngimi mund të mbulojë një spektër të tërë të shkallëve të forcës. Përveç forcës fizike, mund të përfshijë kërcënime psikologjike, presion ose kërcënime të tjera - për shembull kërcënimi i dëmit fizik, largimi nga puna ose mos marrja e një pune që kërkohet. Mund të ndodhë edhe kur personi i sulmuar nuk është në gjendje të japë pëlqimin - për shembull, kur është i dehur, droguar, në gjumë ose mendërisht i paaftë për të kuptuar situatën. Përpjekja për ta bërë këtë njihet si tentativë për përdhunim. Përdhunimi i një personi nga dy ose më shumë autorë është i njohur si përdhunim në grup. Termat sulm seksual, përdhunim, abuzim seksual dhe dhunë seksuale përdoren shpesh në mënyrë të ndërsjellë.

***Dhuna psikologjike përfshin*** "një gamë sjelljesh që kanë për qëllim të kritikojnë, të poshtërojnë, të mbajnë nën kontroll, të izolojnë, të trembin, të shkaktojnë frikë dhe të sulmojnë karakterin e një individi duke shkatërruar kështu ndjenjën e tij të vetëvlerësimit, vetë-besimit, dhe sigurisë. Fyerjet, poshtërimet, të folurit në një mënyrë që sulmon karakterin e individit, të shkaktuarit e ndjenjës së frikës nëpërmjet kërcënimeve për ta lënduar fizikisht një individ dhe/ose persona të tjerë të afërt me të dhe/ose për të shkatërruar diçka të rëndësishme për të, janë disa prej formave të dhunës verbale, sulmit psikologjik e dhunës emocionale që përfshihen si pjesë e dhunës psikologjike.

***Dhunë verbale/kërcënimet konsiderohen:*** kërcënimi për t'i marrë fëmijët, për ta nxjerrë jashtë shtëpisë, nxitja për të bërë vetëvrasje, për ta vrarë, duke i thënë se do të jetë gjithnjë i aftë ta gjejë atë kudo që të jetë, duke e kërcënuar për të rrëmbyer /apo abuzuar me fëmijët, për ta çpërfytyruar atë, për ta kontrolluar kudo, për të shkatërruar perspektivën e karrierës së saj profesionale .

***Dhunë ekonomike:*** "mbajtja nën kontroll e parave nga një individ, pavarësisht nëse janë të fituara apo jo prej tij, ushtrimi i kontrollit dhe monitorimi i veprimit të një individi kundrejt një individi tjetër mbi përdorimin dhe shpërndarjen e parave, përfshirë dhe ato të fituara prej punës së këtij të fundit, shpërdorimi për qëllime të kënaqësive vetjake nga ana e një individi, i parave të domosdoshme për sigurimin e kushteve bazë të jetesës së familjarëve, kërcënimi konstant për ndërprerjen e burimeve ekonomike, detyrimi i një individi për të plotësuar të gjitha nevojat bazë të familjarëve për një periudhë të caktuar (p.sh. mujore), me një kuotë nën minimalen e parave që të nevojiteshin për këtë qëllim, etj".




I. Studimi kërkimor filloi me institucionin përgjegjës të linjës, Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, konform ligjit **NR.9669, DATË 18.12.2006 "PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE (NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.9914, DATË 12.5.2008, NR.10 329, DATË 30.9.2010, 47/2018, DATË 23.7.2018) (I PËRDITËSUAR)**

## III. AUTORITETET PËRGJEGJËSE

1. Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe të luftës kundër dhunës në familje.

2. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë:

a) ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
b) ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike;
c) ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë;
ç) ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë;
d) ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit;
dh) ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit;
e) ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe formimit profesional;
ë) njësitë e vetëqeverisjes vendore.

3. Lista e autoriteteve të tjera përgjegjëse të linjës, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni ndryshon nëse njëri prej tyre merr rolin e autoritetit kryesor përgjegjës. Në këtë rast, ky autoritet ka edhe rol kryesor përgjegjës dhe mbulon çështjet në fushën përkatëse.



**- VKM-ja nr. 327, datë 2.6.2021, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës".**

Sipas pjesës II: "Bashkërendimi i institucioneve për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje" pika 31, germa "ll", koordinatori vendor:

"monitoron, gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit". Sipas pjesës III mbi "Procedurat bazë për menaxhimin e rastit të dhunës në familje", pikës 7, parashikohet: "7. KV-ja mban një dosje dhe u dërgon anëtarëve përkatës të ETN-së raportin e referimit të rastit me të dhënat shoqëruese për viktimën e dhunës në familje, analizën e riskut, urdhrin e mbrojtjes që është lëshuar, si dhe dokumente të tjera bashkëshoqëruese, duke caktuar detyrat për secilin prej tyre, afatet përkatëse, si dhe shërbimet që kanë nevojë të mbulohen me shpenzime."

Po aty, sipas pikës 14, kemi: "Monitorimi i zbatimit të masave mbrojtëse ndaj dhunës realizohet, si më poshtë vijon:

a) gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UM-në çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë, KV-ja dhe/ose punonjësi social i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki monitoron respektimin e masave të urdhërit të mbrojtjes nga pala përkatëse dhe harton raportin e monitorimit për zbatimin e masave mbrojtëse. Ky raport i bëhet i njohur menjëherë Policisë së Shtetit, së bashku me rekomandimet e KVsë;

b) kur nga monitorimi i zbatimit të masave të UMM-së/UM-së rezulton kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me masat e veçanta që urdhërohen prej saj, njoftohet menjëherë Policia e Shtetit, në çdo kohë, pa pritur të përmbushet afati 60-ditor."

**- Ligji nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"** në nenin 11 me titull "Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike" nënvizohet se: "Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

a) viktimave të dhunës në familje". Kuvendi i Shqipërisë më datë 4.12.2017 miratoi **Rezolutën "Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj"**.

Rezoluta ka konstatuar nevojën për thjeshtimin e procedurave gjyqësore për shqyrtimin dhe lëshimin e urdhrit të mbrojtjes dhe ndjekjen efikase të ekzekutimit të tij, duke parashikuar në çdo rast vijimin e procesit gjyqësor, pavarësisht tërheqjes së mëvonshme të viktimës, si dhe ngritjen e një mekanizmi eficent të mbikëqyrjes së veprimtarisë së organeve gjyqësore në proceset gjyqësore të dhunës në familje.

KLGJ-ja ka treguar kujdes në drejtim të aksesit në drejtësi dhe pa pengesa për çështjet me natyrë të ngutshme edhe në kohën e pandemisë Covid-19. Vendimi nr. 127, datë 10.3.2020, "Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë" dhe dy vendime të tjera të KLGJ-së (nr.128, datë 24.3.2020 dhe nr.133, datë 6.4.2020), "Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë" parashikojnë pezullim të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-19. Të gjitha këto vendime të KLGJ-së përjashtojnë nga efektet e këtij pezullimi veprimtari dhe shërbime gjyqësore, që lidhen me çështje me natyrë të ngutshme.

**- Ligji 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"** në nenin 53 të tij "Mbrojtja e vfëmijës" thekson se: "Mbrojtja e fëmijës realizohet nëpërmjet marrjes së masave të mbrojtjes, realizimit të ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe ofrimit të shërbimeve, sipas nevojave, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës në mjedisin e tij familjar ose ***duke e vendosur atë në përkujdesje alternative,*** kur fëmija është i privuar në mënyrë të përkohshme apo të përhershme nga përkujdesja e mbrojtja e prindërve ose ***kur, për shkak të interesit të tij më të lartë, ai nuk mund të lihet në përkujdesjen e prindërve.*** Këto koncepte thellohen më tej edhe në nenet e tjera që trajtojnë mbrojtjen e fëmijës nga cdo formë dhune dhe abuzimi. Pra e drejta e kujdestarisë dhe vizitat e fëmijëve përcaktohen duke marrë parasysh situatën në të cilën ndodhet fëmija në marrdhënie me prindërit/kujdestarët ligjorë. Nëse provohet se ata kanë ushtruar një nga format e dhunës të përcaktuara në Konventë, atëhere merren masa kufizuese bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, deri dhe në vendosjen e fëmijës në një ambjent për kujdesje alternative.

Miratimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur mbështeti plotësimin e **rekomandimit urgjent 17,** ndërkohë që ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale ku rregullohen çështjet e të drejtave të viktimës së veprës penale, në procesin penal, përfshirë dhe të drejtat e viktimës së mitur apo të viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore, mbështesin plotësimin e **rekomandimeve urgjente 17 dhe 18.**

**- LIGJI NR. 7895, DATË 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013, ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 35/2020, datë 16.4.2020)**

**Neni 130/a**

**Dhuna në familje**
Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune fizike, psikologjike, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim deri në katër vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet burgim.

## IV. METODOLOGJIA

Për përgatitjen e këtij studimi, u përdorën dy metodologji:

1. Intervista me ministritë dhe institucionet kombëtare që kanë detyrimin për zbatimin e Konventës së Stambollit.

2. Plotësim pyetsori në funksion të detyrave nga strukturat e vetëqeverisjes vendore (kordinatorët vendorë të dhunës në familje), nga Policia e shtetit dhe strukturat vartëse (Kordinatorët e dhunës në familje dhe për mbrojtjen e fëmijëve), Prokurori, Gjykatë, OJF. Pyetsori dërguar çdo institucioni përmbante përveç informacionit të përgjithshëm dhe informacion specifik për cdo institutcion.

Megjithatë, duhet thënë që informacioni i përcjellë nga institucionet u përmbahej kërkesave të mësipërme në minimumin e tyre dhe pjesa më e madhe thjesht kanë raportuar mbi aktivitete të kryera, pa i lidhur domosdoshmërisht me qëllimet dhe objektivat. Ishte pozitiv fakti që periudha e realizimit të studimit nga ana FGE kondicionoi me periudhën që MSHMS po mblidhte informacion nga të gjithë strukturat lokale dhe qëndrore për përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve pranë strukturave ndërkombëtare për mënyrën se si Shqipëria ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Konventës së Stambollit. Në muajin shtator, sipas informacioneve të marra, grupi GREVIO inspekton Shqipërinë në lidhje me këto detyrime

Për realizimin e intervistave stafi i FGE, i angazhuar në realizimin me sukses të projektit përgatiti pyetjet për çdo institucion shtetëror në funksion të rëndësisë dhe angazhimit të tyre në zbatim të detyrimeve të Konventës. Më pas u lexua me shumë kujdes raporti i GREVIO-s për Shqipërinë të vitit 2021, që ndodhet në faqen e MSHMS. Nga ky dokument identifikuam organet e rëndësishme në Shqipëri, që kanë detyrimin për zbatimin e IC. Ato janë:

**Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore** - (me anëtarësi të rinovuar sipas Urdhërit të Kryeministrit Nr.239, datë 13.12.2017) - është organi këshillimor për drejtimin, përcaktimin dhe zhvillimin e politikave shtetërore për barazinë gjinore, si dhe për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit. Këshilli ngrihet me urdhër të Kryeministrit, rinovohet një herë në katër vjet, drejtohet nga Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në përbërje ka nëntë përfaqësuese/përfaqësues të ministrive të linjës në rang zëvendësministreje/zëvendësministri dhe drejtuesesh/drejtuesish të lartë, si dhe tre përfaqësuese/përfaqësues të shoqërisë civile, të cilat/cilët zgjidhen mbi bazën e një konkurimi të hapur, duke patur si kriter eksperiencën dhe kontributin për këto çështje (momentalisht janë tre të tillë). Ky Komision drejtohet nga ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ju drejtuam zyrtarisht kërkesën për një intervistë me to. Me ministren kjo intervistë nuk na u mundësua

***Nënkomisioni "Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas",*** - i ngritur pranë Komisionit të përhershëm për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në zbatim të rezolutës "Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj" (miratuar nga Kuvendi në 04.12.2017). Ky nënkomision në kuadër të kontrollit parlamentar kërkon informacion mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, raportim për situatën e dhunës në familje, apo për çështje të diskriminimit ndaj grave, si dhe zhvillon seanca dëgjimore me grupet e interesit dhe institucionet. Për të realizuar intervistën me Aleancën e Grave deputete ju dërguam përmes adresës së e-mailit, dt 16.03.2023 kryetares dhe dy nënkryetareve të kësaj aleance kërkesën për një intervistë me to si dhe pyetjet ku do të konsistonte intervista.

***Zyra e Koordinimit kundër dhunës në familje*** - e ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë (në 25.11.2017), për bashkërendimin e veprimeve institucionale në nivel qendror e vendor, për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen e viktimave të dhunës në familje, kryesisht grave dhe vajzave, si dhe ofrimin e ndihmës në përshkallëzimin e veprimeve institucionale në këtë drejtim. Zyra ka në përbërje përfaqësuese/përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Shërbimi Social Shtetëror) dhe Ministria e Brendshme (Drejtoria për Krimet, pranë Sektorit për Dhunën në Familje dhe Mbrojtjen e të Miturve). Në e-mailin e drejtuar në Ministri të Drejtësisë për një intervistë të mundshme më drejtuesin e kësaj zyre, na vjen përgjigja që kjo zyrë nuk ekziston më.

***Zëvendëskryeministri*** - është caktuar si koordinator kombëtar për barazinë gjinore (me Urdhër të Kryeministrit 32/2018), me rol koordinues për fuqizimin e mekanizmit kombëtar për barazinë gjinore. I dërgojmë kërkesë zyrtare Z/kryeministrit (16.03.2023) për një intervistë, por kjo intervistë nuk na u mundësua.

***Institucionet shtetërore qendrore dhe vendore*** kanë detyrimin ligjor të bashkëpunojnë me ministren/ministrin që mbulon çështjet e barazisë gjinore për të shkëmbyer informacion dhe lehtësuar përmbushjen e funksionit të saj/tij. Ky bashkëpunim lehtësohet përmes Nëpunëseve/Nëpunësve të Barazisë Gjinore (NBGJ). Në nivel qendror janë caktuar NBGJ në 11 ministri dhe pika kontakti në Policinë e Shtetit dhe INSTAT. Në nivel vendor të gjitha 61 bashkitë kanë NBGJ, të cilat/cilët në shumicën e rasteve luajnë dhe rolin e koordinatores/ koordinatorit vendor kundër dhunës në familje. Me ndryshimet ligjore te vitit 2021 funksioni i Kordinatorit Vendor është i ndarë nga funksionet e tjera.

Për këtë arsye dërguam shkresë zyrtare për intervistë në të gjithë institucionet e mësipërme

Gjithashtu në nivelin vendor, MKR kanë në përbërje të tyre të gjitha institucionet përgjegjëse vendore për zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (bashkia dhe shërbimet sociale të saj, policia, prokuroria, gjykata, mjeku ligjor, përmbarimi, shëndetësia, arsimi, shërbimi social shtetëror, punësimi, shërbimi i provës, prefekti i qarkut, etj), si dhe organizata të shoqërisë civile, të specializuara për ofrimin e shërbimeve mbështetëse të domosdoshme për menaxhimin e rasteve dhe ndërhyrjen në drejtim të parandalimit dhe ndërgjegjësimit në tërësi të shoqërisë (organizata që ofrojnë shërbime

strehimi, këshillimi psiko-emocional apo ligjor, shërbime rehabilituese dhe riintegruese, informim, aktivitete të fuqizimit të kapaciteteve të profesionisteve e profesionistëve, etj). Në përmbushje të detyrimit ligjor dhe sipas planifikimit në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020, MKR tashmë janë ngritur në të gjitha bashkitë në vend (61 bashki). Ndërkohë po vijon puna për fuqizimin dhe rritjen e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së tyre në mënyrën e trajtimit të rasteve sipas filozofisë që i karakterizon, si dhe për kryerjen e të gjitha funksioneve (pra jo vetëm atë të menaxhimit të rasteve në mënyrë shumësektoriale të koordinuar, por edhe funksione të lidhura me koordinimin, parandalimin dhe informimin, trajnimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve, mbledhjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave, si dhe dokumentimin). Për përmirësimin e efektivitetit të ndërhyrjes dhe funksionimit në tërësi të MKR-ve, në Qershor 2021 u miratua dhe VKM 327, datë 02.06.2021 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës". Kjo VKM shfuqizon VKM 334/2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij". Përveç përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe të politikave të përditësuar, në këtë VKM ndër të tjera, theksohet edhe detyrimi për identifikimin dhe raportimin e rasteve të tjera të dhunës së ushtruar ndaj grave sipas Konvetës së Stambollit, me qëllim trajtimin e tyre përmes MKR-së.

Për këtë arsye, pasi përpunuam pyetsorin për çdo institucion e dërguam atë përmes adresës së emailit te:

- 35 Koordinatorët vendorë të dhunës në 61 bashkitë e Shqipërisë.
- 11 specialistët për Dhunën në Familje dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në 12 Drejtoritë Vendore të Policisë
- 19 OJF-ve që punojnë me njerëz që kanë probleme të dhunës në familje
- 22 Kancelarë të Gjykatat e rretheve Gjyqësore
- 2 Koordinatore në Prokurori

Ekipi i ngarkuar për realizimin e studimit, realizoi 15 intervista me përfaqësues të:

- Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale (2 përfaqësues),
- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit
- Ministrisë së Drejtësisë,
- Ministrisë së Arsimit dhe Sportit,
- Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,
- Avokatit të Popullit,
- Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
- Ministrisë së Brendshme
- Ministrisë së Bujqësisë
- Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas
- 4 OJF-ve

## V. SITUATA E DHUNËS NË NIVEL BOTËROR DHE NË SHQIPËRI

Në fushaën **UNiTE** të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave deri në vitin 2030, në 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave 25 nëntor - 10 dhjetor 2022 thuhet:

Që nga fillim i pandemisë:

- 45% e grave raportuan se ato vetë ose një grua që ato njohin ka përjetuar një formë të dhunës ndaj grave dhe vajzave.
- 7 në 10 gra thanë se mendojnë se abuzimi verbal ose fizik nga një partner është bërë më i zakonshëm.
- 6 në 10 gra mendonin se ngacmimi seksual në hapësirat publike është përkeqësuar.

Në Shqipëri dhuna me bazë gjinore dhe kryesisht ajo ndaj grave dhe vajzave vijon të mbetet një barrë e rëndë për shoqërinë dhe autoritetet. Gjatë 5 viteve të fundit ka rënie me 9% të numrit të grave dhe vajzve të dëmtuara nga veprat penale në përgjithësi, ndërsa vihet re me shqetësim rritja me 21% e denoncimeve të dhunës ndaj grave dhe vajzave në familje, për të njëjtën periudhë. Situata sipas ekspertëve u përkeqësua gjatë pandemisë së Covid 19. Sipas të dhënave zyrtare në dy vite dhuna ndaj tyre u rrit me 10%, gjë që çoi edhe në rritjen e numrit të vrasjeve. 12 gra dhe vajza gjithsej humbën jetën nga dhuna në vitin 2021, 10 prej tyre nga ajo në familje, kundrejt 9 grave dhe vajzave në vitin 2020, 6 prej tyre nga dhuna në familje.

Gjatë vitit *2022 Forumi i Gruas Elbasan* ka këto të dhëna bazuar në tre shërbimet e saj për vitin 2022:

- Qëndra e Këshillimit ka realizuar në total 827 Këshillime Psikologjike dhe Sociale, nga të cilat 524 ballë për ballë dhe 303 përmes linjës telefonike. Kanë marrë këshillime dhe 20 burra dhe 22 fëmijë. Nga 824 këshillime 257 kanë qenë raste të reja. Për G/V dhe fëmijët e tyre janë ofruar 153 seanca “Terapia e Artit”. Nëpërmjet ESD janë fuqizuar 174 psikologë, punonjës socialë, officerë sigurie, studentë dhe nxënës si të mbrohen nga dhuna kur ajo ndodh.
- Studio avokatore ka realizuar 440 këshillime juridike, janë hapur 42 kërkesë padi në gjykatë. Janë pregatitur dhe drejtuar drejt institucioneve të tjera 53 kërkesa në ndihmë dhe mbështetje të të mbijetuarave të dhunës në familje. Janë ndjekur në gjykatë 134 seanca gjyqësore, janë ofruar 320 këshillime ligjore para dhe pas seancave
- Strehëza e emergjencave ka strehuar 32 gra/vajza dhe 43 fëmijë të grupmoshave të ndryshme. Rastet kanë qenë nga 7 bashkitë e Qarkut Elbasan, por kanë qenë dhe dy raste nga Bashkitë Sarandë dhe Tiranë.
- Për vitin 2022 në Gjykatën e Elbasanit janë depozituar 251 kërkesë padi për UM, nga ku j anë miratuar 131 UM, 64 janë rrëzuar dhe 56 pushuar.

## VI. SI JANË SHPREHUR INSTITUCIONET GJATË INTERVISTAVE:

**MSHMS**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor. Ajo është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkë-rendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.

**Konform Ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE:**

**Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës**

Autoriteti kryesor përgjegjës ka këto detyra:

**a)** hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;

**b)** financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes, si dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;

**c)** mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, në bashkëpunim me mekanizmin e referimit, për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave e të masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës, si dhe plotësimin e tyre me gjithë infrastrukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e “përshtatjes së arsyeshme”, që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje, përfshirë këtu asistencë financiare, si dhe shërbime mjekësore e sociale, sipas legjislacionit në fuqi;

**ç)** organizimin e trajnimeve për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje për punonjësit e shërbimeve sociale, të cilët ofrojnë shërbime, pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore, strukturat e Policisë së Shtetit, stafit mjekësor dhe për punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale. Trajnimet mund të organizohen në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, me Shkollën e Magjistraturës, me Urdhrin e Psikologut dhe Urdhrin e Punonjësit Social ose me organizata dhe agjenci të akredituara për të ofruar trajnime për tematika që lidhen me çështje të dhunës në marrëdhëniet familjare, për të gjitha autoritetet përgjegjëse administrative, ligjzbatuese dhe gjyqësore;

**d)** bashkërendimin e punës për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave statistikore, për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë dhe analizimin, publikimin dhe raportimin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nën-komisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave për rastet e dhunës në familje bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Botimi i tyre bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për statistikat zyrtare

**dh)** mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje;

**e)** mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare;

**ë)** licencimin e OJF-ve të ndryshme, për të ofruar shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit.

**g)** harton politikat dhe mbikëqyr marrjen e masave për eliminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo, në rastin kur fëmijët jetojnë në familje ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin, nëpërmjet vendosjes në përkujdesje alternative ose dhënies së masave mbrojtëse emergjente, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;

**gj)** ofrimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit në Qendrën Kombëtare të Përkujdesjes Shoqërore për viktimat e dhunës në familje;

**h)** hartimin, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të linjës, të procedurave, standardeve ose protokolleve, lidhur me vlerësimin e riskut dhe planet e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

**i)** koordinimin dhe monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.

*2/1. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë kryen edhe këto detyra:*

**a)** organizon trajnime dhe specializime për stafin mjekësor, psikologjik e të punonjësve sociale në fushën e dhunës në familje, duke përgatitur edhe një listë të profesionistëve të trajnuar e të specializuar në këto fusha, në bashkëpunim me urdhrat e ngritur sipas legjislacionit në fuqi;

**b)** monitoron përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj, nga ana e personelit mjekësor;

**c)** parashikon ngritjen e qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, që të sigurojnë mundësinë e funksionimit të dhomave, që shërbejnë për emergjenca pranë spitaleve ku viktima trajtohet. Standardet e ngritjes dhe funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë .

## INTERVISTA: MSHMS

***-A mund të përmendni një ligj/akt nënligjor të ri, që është miratuar/dekretuar nga shteti në përputhje me Konventën? Cilin?***

**Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"** është akti kryesor që synon të parandalojë dhe zvogëlojë dhunën në familje në të gjitha format e saj, si dhe të sigurojë më shumë mbrojtje për viktimat. Ky ligj ka pësuar ndryshime të rëndësishme në vitin 2018 (ligji 47/2018) dhe 2020 (Ligji 125/2020), duke përmbushur rekomandimet kyçe të Vëzhgimeve Përfundimtare të Komitetit CEDAW (2016) dhe Raportit Fillestar Vlerësues të GREVIO (2017) për Shqipërinë.

**Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 2.06.2021 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës".** Ky vendim rregullon procedurat standarde bazë për bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, duke garantuar të drejtat e njeriut e promovuar barazinë gjinor, si edhe duke eliminuar të gjitha format e diskriminimit ndaj grave. Përveç përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe të politikave të përditësuar, në këtë VKM ndër të tjera, theksohet edhe detyrimi për identifikimin dhe raportimin e rasteve të tjera të dhunës së ushtruar ndaj grave sipas Konvetës së Stambollit, me qëllim trajtimin e tyre përmes MKR-së.

Kodi Penal pësoi një amendim shumë të rëndësishëm në lidhje me dhunën në familje, me miratimin e Ligjit nr. 35, datë 16.04.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Ndryshimi kryesor konsiston në kriminalizimin e dhunës psikologjike në marrëdhëniet familjare si dhe përfshirja në këto marrëdhënie të personave në lidhje ose ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, duke harmonizuar përmbajtjen e nenit 130/a të Kodit Penal me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe ndryshimet e vitit 2018 në ligjin për dhunën në familje.

Ndryshime pësoi edhe legjislacioni procedural penal, Ligji 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, "Kodi i Procedurës Penale", ku parashikohen dispozita të ligjore, që përmirësojnë ndjeshëm pozitën e viktimës në çështjet penale, si dhe të drejta procedurale të posaçme për viktimën e mitur, të abuzuar seksualisht dhe viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore. (nenet 58 dhe 58/b).

Strategja e katërt Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i saj i Veprimit, 2021-2030 (SKBGJ 2021- 2030). SKBGJ 2021 – 2030" përbëhet nga katër qëllime strategjike kryesore, një ndër të cilat edhe "Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje". Angazhimet e parashikuara nën këtë Qëllim Strategjik bazohen veçanërisht në detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Stambollit dhe rekomandimet e GREVIOs.

***-A mendoni se shteti ndan burime të mjaftueshme, njerëzore dhe financiare, për zbatimin e politikave/ masave/ programeve?***

Alokimi i fondeve për aktivitete për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave që mbulohen nga Konventa e Stambollit realizohet në kuadër të Buxhetimit të Përgjithshëm Gjinor, si në nivelin qendror ashtu dhe në atë të vetëqeverisjes vendore.

Përveç buxhetit të shtetit, një rol me rëndësi në financimin e programeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave ka luajtur edhe program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara "T'i japim fund dhunës ndaj grave" i zbatuar nga UNDP, UNFPA, UN Women me fonde të Qeverisë Suedeze.

Shteti shqiptar i kushton një vëmendje të veçantë dhe ndihmës financiare për viktimat e dhunës në familje. Në vitin 2022 ndihma ekonomike për viktimat e dhunës në familje të pajisura me urdhër mbrojtje u trefishua nga 3000 në 9,900 ALL

.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale financon gjithashtu edhe dy shërbime mbështetëse të specializuara në nivel kombëtar, të cilat ofrojnë strehim dhe trajtim afatgjatë me fokus riintegrimin, për viktimat e dhunës në famile dhe të trafikimit të qenieve njerëzore.

Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përgjegjësitë koordinuese përmbushen nëpërmjet Sektorit të Politikave të Barazisë Gjinore në Drejtorinë e Politikave të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Mbrojtjes Sociale.Sektori i Politikave të Barazisë Gjinore përbëhet nga 2 specialistë dhe nga një përgjegjës. Në terma financiarë ka rritje të buxhetit kryesisht për pagat e personelit. Veprimtaritë e tjera të lidhura me aktivitete ndërgjegjësuese, të fuqizimit të kapaciteteve të profesionistëve që trajtojnë çështjet e dhunës me bazë gjinore, si dhe të proceseve monitoruese e vlerësuese, kryhen edhe me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare. Po kështu, këtij sektori i është siguruar asistenca teknike përmes ekspertëve/eksperteve që këto organizata ndërkombëtare angazhojnë vazhdimisht pranë tij.

Gjithashtu për Mekanizmat Kombëtarë të Referimit (MKR-të), si strukturat kryesore ndërsektoriale që trajtojnë rastet e dhunës në nivel lokal të ngritura në të 61 bashkitë e vendit, fokusi ka qenë gjithmonë në rritjen e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme për mbrojtjen e viktimave. VKM nr. 327, datë 2.06.2021 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës", ka përcaktuar gjithashtu fuqizmin e rolit të koordinatorit vendor, duke përcaktuar që në bashkitë e mëdha të emërohen dy KVDH dhe në bashkitë e vogla një KVDH. Aktualisht në të 61 bashkitë janë emëruar KVDH, por jo të gjithë janë të emëruar vetëm me këtë detyrë. Mund të luajnë njëkohëshisht edhe rolin e nëpunësit/nëpunëses gjinore ose si punonjës për mbrojtjen e fëmijëve, etj.

Nga pikëpamja financiare, Fondi Social është një nga burimet më të rëndësishme të mbështetjes financiare në nivel lokal për shërbimet dhe projektet në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Pjesë e buxhetit të shtetit për barazinë gjinore dhe dhunën në familje është edhe shuma që akordohet për organizatat e shoqërisë civile nga AMSHC.

***-Si e kuptoni rolin/ rëndësinë e Komitetit GREVIO ?***

Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është i një rëndësie tepër të lartë, pasi monitoron zbatimin e kësaj Konvente nga Shtetet Palë.

GREVIO përcakton mjetet e duhura për të kryer procedurat e monitorimit, si dhe mund të marrë informacion mbi zbatimin e Konventës nga organizatat joqeveritare dhe shoqërisë civile.

GREVIO mund të marrë informacion mbi zbatimin e Konventës nga Komisioneri i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut, Asambleja Parlamentare dhe organet përkatëse të specializuara të Këshillit të Europës, si edhe ato të krijuara në bazë të instrumentave të tjera ndërkombëtare.

Roli i GREVIO-s është i rëndësishëm pasi GREVIO mund të miratojë, kur është e përshtatshme, rekomandime të përgjithshme mbi zbatimin Konventës së Stambollit.

Për sa më sipër rekomandimet e dhëna nga GREVIO, pas shqyrtimit të raporteve të shtetit apo inspektimeve në vend, ndihmojnë në këtë rast Shtetin në kuadrin e përmirësimit të politikave, legjislacionit për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Po ashtu ndihmojnë dhe janë një udhërrëfyes për organizatat e shoqërisë civile për të lobuar lidhur me iniciativa në mbrojtje të grave nga dhuna.

***- A mund të tregoni për një progress specifik të arritur që nga miratimi i raportit/ rekomandimeve të komitetit GREVIO në fushën e mirëqenies sociale/ veprimit policor/ hetimit/ ndjekjes?***

Që nga miratimi i raportit të vlerësimit fillestar të GREVIO-s, në Shqipëri ka pasur zhvillime, në lidhje me:

Tendencat e reja në lidhje me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, duke përfshirë edhe format e tyre digjitale (llojet, grupet e viktimave, format e dhunës);

Sipas bashkive, tendencat e reja të hasura gjatë menaxhimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare lidhen me dhunën online dhe për rrjedhojë masat mbrojtëse të përcaktuara në vendimet gjyqësore konsistojnë në ndalimin e çdo lloj forme të ngacmimit dhe dhunës përmes rrjeteve sociale, telefonit apo çdo forme tjetër. Të gjitha rastet e dhunës në familje përmes formave digjitale, janë gra dhe vajza dhe kryesisht dhunesit janë partnerët intimë, bashkëjetuesit ose bashkëshortët.

Tendencat e reja në jurisprudencë që lidhet me dhunën ndaj grave;

Tendencat e reja në akordimin e fondeve dhe buxheteve nga autoritetet shtetërore

Në kuadër të SKBGJ 2021-2030 janë parashikuar forma të shumta të mbështetjes së grave dhe vajzave pjesë e grupeve të margjinalizuara në zonat sub-urbane dhe rurale, pjesë e të cilave janë edhe viktimat e dhunës me bazë gjinore si financimi i strat-up, bizneseve, subvencionimi i sipërmarrjeve që zbatojnë ide inovatore me fokus tek dixhitalizimi dhe ekonomia mjedisore, heqja e tarifave vendore të tyre për dy vitet e fillimit etj. Buxhetimi i shërbimeve sociale nga Bashkitë për viktimat e dhunës në familje është një tjetër risi që garanton shërbime strehimi, linjë këshillimi, mbështetje ligjore, psikologjike etj për viktimat e DHBGJ.

Qasjet novatore në lidhje me parandalimin paraprak, p.sh. audiencat e reja të synuara dhe mjetet e komunikimit, partneritete publik/privat.

Masat e marra nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) për të përfshirë për herë të parë parimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në Kodin e Transmetimit për Median Audiovizive. Ndryshimet kanë si qëllim përmirësimin e çështjeve të barazisë gjinore në media, shmangjen e gjuhës seksiste dhe mbrojtjen e grave dhe vajzave viktima të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje nga ri-viktimizimi gjatëraportimit të rasteve specifike në transmetimet mediatike. Sipas seksionit të ri të shtuar të Kodit të Transmetimit "Promovimi i barazisë gjinore, parandalimi dhe lufta ndaj diskriminimit në median audiovizive", operatorët e transmetimit inkurajohen të marrin masa konkrete për të luftuar diskriminimin me bazë gjinie, ri viktimizimin e viktimave, mbrojtjen e të drejtës për jetë private të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe çdo forme tjetër dhune ndaj grave dhe fëmijëve të tyre.

Programi "T'i japim fund dhunës ndaj grave" mbështeti partneritetin midis Vodafone Albania, MSHMS dhe Ministrisë së Brendshme, për të hartuar dhe lançuar aplikacionin Bright Sky, një program i ri mbështetës online për gratë viktima/të mbijetuara të DhF dhe DHBGJ, i aksesueshëm që nga qershori 2021.

Gjithashtu, gjatë vitit 2018 është kryer një vlerësim i kuadrit ligjor, institucional dhe burimeve njerëzore mbi dhunën ndaj fëmijëve në Shqipëri, me fokus shfrytëzimin seksual të fëmijëve dhe abuzimin në hapësirën virtuale. Qeveria e Shqipërisë dhe shoqëria civile (ALO 116, www.isigurt.al) kanë dhënë mbështetje për të krijuar mekanizma raportimi dhe ndërgjegjësimi për djemtë, vajzat dhe prindërit për abuzimin në internet dhe është investuar në fuqizimin e edukatorëve(eve) të bashkëmoshatarëve që mund t'i ndihmojë djemtë dhe vajzat të kuptojnë më mirë dhe të mbrojnë veten nga rreziqet online, etj

***Tendencat e reja që lidhen me aksesin ndaj azilit dhe mbrojtjes ndërkombëtare të grave, viktima të dhunës ndaj grave.***

***-A janë lehtësuar/ përmirësuar ndonjëherë procedurat tuaja për shkak të Konventës së Stambollit? A i jeni referuar ndonjëherë një dispozite të veçantë të Konventës në marrjen e një vendimi ? Kur ?***

Në rolin e saj si politikëbërëse dhe koordinues përsa i përket politikave për dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, MSHMS, duke iu referuar neneve specifike të Konventës për ngritjen dhe funksionimit e Linjave të Ndihmës (neni 24) apo shërbimeve të specializuara për viktimat e dhunës seksuale (neni 25), strehëzave (neni 23), ka ngritur dhe ka mbështetur Linjën Kombëtare të Këshillimit për Gra dhe Vajza 116-117; Qendrën LILIUM në vitin 2018, dhe 16 strehëza emergjente.

***-A ju kujtohet ndonjë veprim/ procedurë specifike në lidhje me Konventën ?***

<u>Miratimi</u> i:
-Tri Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) në fushën e shëndetësisë dhe të shërbimeve të kujdesit shoqërore për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe situatat emergjente. Qëllimi: për t'u ardhur në ndihmë profesioninistëve që janë pjesë e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit për hapat që duhet të ndjekin për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, miratveuar me Urdhërat e Ministres Nr.100.101 dhe 102 në prill 2020.

-Dy Udhëzimeve të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratimin e:

a) Protokollit për "Funksionimin e qendrave rezidenciale publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime strehimi për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje dhe për viktimat/të mbijetuarat e trafikimit në situatën e pandemisë COVID-19" si dhe

b) Udhëzimit për "Menaxhimin e rasteve që përfshijnë fëmijët në nevojë për mbrojtje gjatë urgjencës COVID-19".

Përgatitja e 3 protokolleve të unifikuara:

a) për dhunën në familje,

b) dhunën seksuale

c) dhunën në familje gjatë situatës së Pandemisë Covid -19, për t'i ardhur në ndihmë anëtarëve të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR) gjatë menazhimit të rasteve të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale.

Në detyrim të l**igjit Nr. 47/2018, (LDHF i ndryshuar në 2018) janë miratuar katër Udhëzime:**

- Udhëzimi Nr. 816, datë 27.11.2018, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për miratimin e standarteve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të Qendrave të menaxhimt të krizës për rastet e dhunës seksuale".

- Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Brendshëm Nr. 912, datë 27.12.2018 "Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme".

- Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Brendshëm Nr 866/20.12.2018 "Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje".

- Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 9, datë 17.06.2020 "Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre".

- ***Në çfarë mënyre kontribuon institucioni juaj në Zbatimin e Konventës së Stambollit?***

Shqipëria e nënshkroi Koventën e Këshillit të Evropës mbi **Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Gruas dhe Dhunës në Familje** (Konventa e Stambollit, CETS nr.210) më 19 Dhjetor 2011. Kuvendi i Shqipërisë e ratifikoi atë me **Ligjin Nr.104/8.11.2012 *"Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"***. Konventa u adoptua nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në 7 Prill 2011 dhe hyri në fuqi më 1 gusht 2014. Shqipëria me ratifikimin e 'Konventës së Stambollit' shpreh dhe merr përsipër angazhimin për të bashkëpunuar në nivel rajonal dhe ndërkombëtar kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Angazhimi përfshin gadishmërinë për të ndërmarrë masa legjislative, politike dhe ekzekutive kundër këtyre fenomeneve. Arritja e barazisë gjinore dhe reduktimi i dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje është ndër prioritetet e Shqipërisë artikuluar qartësisht në një tërësi dokumentesh e programesh kombëtare, duke u konsideruar si kusht drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

***Si kontribuon MSHMS:***

* Ministrja e MSHMS është kryetare e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore. Ky Këshill, si një nga detyrat e tij ka dhe monitorimin e zbatimit të Konventës së Stambollit.
* MSHMS nëpërmjet strukturës së barazisë gjinore, përgatit raportet qeveritare për zbatimin e kësaj konvente.
* Propozon ndërhyrje në legjislacionin për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje (siç u shpjegua më sipër ndryshimet në 2018 dhe 2020 të LDHF)

* Në përgatitjen e politikës kryesore si SKBGJ 2021-2030, në masat dhe veprimet e parashikuara, sidomos qëllimin e Politikës III, ka patur parasysh dhe detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Stambollit dhe rekomandimet e dhëna nga GREVIO.
* Mbështetet shërbimet e specializuara për viktimat e dhunës në familje në nivel qarku dhe bashkie me Fondin Social, si dhe Qendrat Kombëtare si Qendra e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra LILIUM nëpërmjet fondeve buxhetore.

1. Në bashkëpunim me donatorët, kryesisht të UN-it organizon ngritjen e kapaciteteve për MKR dhe KVDH.
2. Koordinon fushatat e përvitshme të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj grave.

***- A keni pasur ju apo institucioni juaj një mundësi për të kontribuar në raportimin mbi zbatimin e Konventës? Në çfarë mënyre ?***

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e institucionit përgjegjës për zbatimin në nivel qendror dhe koordinimin e politikave dhe masave për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave ka koordinuar punën me ministritë kryesore përgjegjëse dhe institucione të tjera si: Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Financave, Kuvendi i Shqipërisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroritë dhe gjykatat, Shkolla e Magjistraturës, Dhoma Kombëtare e Noterëve, Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë, Urdhëri i Psikologut, INSTAT, AMSHC etj, lidhur me procesin e raportimit.

Në këtë proces vlerësohet mbështetja e agjencisë së OKB-së, UN Women në Shqipëri përmes vënies në dispozicion të burimeve financiare dhe të ekspertizës. Lidhur me metodologjinë, pas mbledhjes së informacionit dhe përpunimit të tij në një draft raport Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, realizoi një tryezë konsultimi me grupet e interesit duke përfshirë institucionet përgjegjëse dhe OJF-të që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe veçanërisht të grave, institucione shtetërore, qendrore dhe vendore, dhe agjenci ndërkombëtare.

Sa më sipër u ofruan sugjerime, komente dhe mendime se si ky raport mund të përmirësohej dhe të ishte gjithëpërfshirës. Pjesë e metodologjisë për mbledhjen e të dhënave përmbajtësore dhe statistikore ishte edhe analiza, krahasimi dhe studimi i raporteve ekzistuese të realizuara kohët e fundit nga institucionet shtetërore qendrore dhe lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare. Këto të dhëna janë konfirmuar dhe përmirësuar më qëllim që të jepet një tabllo sa më e qartë, reale dhe e përditësuar e situates.

***-Si i mbledh, klasifikon dhe ruan institucioni juaj të dhënat (lloji i dhunës, gjinia, mosha e viktimës/dhunuesit, marrëdhënia, vendi, numri i urdhërave të ndalimit dhe mbrojtjes, shkeljet e urdhërave të mbrojtjes, ndalimi, dënimet, heqja e të drejtave prindërore/ kufizimi i të drejtave prindërore, kujdestaria)***

MSHMS është autoriteti kryesor përgjegjës për bashkërendimin e punës për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave statistikore, për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë dhe analizimin, publikimin dhe raportimin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/ nënkomisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave (ligji i dhunës në familje neni 6) si dhe ka akses në të dhënat e sistemit REVALB.

Një rol të rëndësishëm në mbledhjen e të dhënave mbi rastet që identifikohen dhe menaxhohen në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar përmes Mekanizmave të Koordinuar të Referimit në nivelin vendor, luan sistemi REVALB, një sistem i përgatitur posaçërisht për këtë qëllim. Gjatë dy viteteve të fundit janë bërë një sërë ndërhyrjesh përmirësuese në sistem dhe paralelisht është punuar edhe me trajnimin e koordinatoreve/koordinatorëve vendorë, me qëllim që të mund të vijojnë me hedhjen rregullisht e në mënyrë të përditësuar të të dhënave. Sistemi bën të mundur jo vetëm mbledhjen e të dhënave mbi numrin e rasteve të trajtuara, por edhe mbi performancën e institucioneve, urdhërat mbrojtës të lëshuar dhe monitorimin e tyre.

Sistemi gjeneron të dhëna edhe sipas grupeve të disavantazhuara si romë, persona me aftësi të kufizuar, sipas grupmoshës, ndarjes zonë rurale dhe zonë urbane; sipas punësimit, arsimit etj.

Të dhënat kryesore jepen nga Drejtoria e Përgjtihshme e Policisë së Shtetit mbi bazë 3 mujore.

Të dhëna të tjera, si për përfituesit e ndihmës ligjore apo numri i përfituesve dhe llojet e shërbimeve mblidhen dhe publikohen në kuadër të raportit të monitorimit të SKBGJ ose kur kërkohet në kuadër të raportimeve ndërkombëtare.

MSHMS nuk disponon të gjitha llojet e të dhënave të përmendura në pyetjen 9, siç është p.sh., heqja e të drejtave prindërore/kujdestaria etj.

***- Sipas mendimit tuaj, kush është në gjendje të ofrojë trajnimet më të mira për Dhunën me Bazë Gjinore në Shqipëri? Pse?***

MSHMS mbështetet dhe nga organizatat ndërkombëtare, veçanërisht UN si UN WOMEN, UNDP dhe UNFPA, lidhur me ngritjen e kapaciteteve të koordinatorëve vendorë dhe fuqizimit të mekanizmave të koordinuar të referimit dhe aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuese, në kuadër të Programit të Përbashkët “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”. Ekspertët gjinorë dhe ligjorë të kontraktuar nga këto agjensi vlerësohen për njohuritë e larta dhe përcjelljen e tyre tek audienca e targetuar, sipas programeve të nënshkruara midis MSHMS dhe këtyre agjensive. Po ashtu Organizatat e Shoqërisë Civile të cilat japin kontribut në vite në

fushën e barazisë gjinore dhe dhunës në familje kanë kapacitete të mira trajnuese. Si p.sh., në trajnimin e specialistëve të shëndetësisë, të përkujdesit shoqëror, të policisë, anëtarëve të MKR etj.

***- A ka ndonjë mekanizëm multidisiplinar për mbrojtjen nga Dhuna me Bazë Gjinore i parashikuar në Konventën e Stambollit ( grupi i punës, protokollet, udhëzuesit) ?***

Në nivelin vendor, bazuar në Ligjin 9669/2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar dhe VKM NR. 327/2021, ngrihen Mekanizmat e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare (MKR), të udhëhequra nga bashkitë (autoritetet përgjegjëse për ngritjen dhe fuqizimin e këtyre mekanizmave) dhe të bazuara në filozofinë e qasjes shumësektoriale të koordinuar. MKR kanë në përbërje të tyre të gjitha institucionet përgjegjëse vendore për zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (bashkia dhe shërbimet sociale të saj, policia, prokuroria, gjykata, mjeku ligjor, përmbarimi, shëndetësia, arsimi, shërbimi social shtetëror, punësimi, shërbimi i provës, prefekti i qarkut, etj), si dhe organizata të shoqërisë civile të specializuara për ofrimin e shërbimeve mbështetëse të domosdoshme për menaxhimin e rasteve dhe ndërhyrjen në drejtim të parandalimit dhe ndërgjegjësimit në tërësi të shoqërisë (organizata që ofrojnë shërbime strehimi, këshillimi psiko-emocional apo ligjor, shërbime rehabilituese dhe riintegruese, informim, aktivitete të fuqizimit të kapaciteteve të profesionisteve e profesionistëve, etj). Aktualisht MKR janë ngritur në të gjitha bashkitë 61. MSHMS ka punuar në vitet e fundit për fuqizimin dhe rritjen e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së anëtarëve të MKRve në mënyrën e trajtimit të rasteve sipas filozofisë që i karakterizon, si dhe për kryerjen e të gjitha funksioneve (pra jo vetëm atë të menaxhimit të rasteve në mënyrë shumësektoriale të koordinuar, por edhe funksione të lidhura me koordinimin, parandalimin dhe informimin, trajnimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve, mbledhjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave, si dhe dokumentimin).

Nga MSHMS janë përgatitur 3 protokolle të unifikuara a) për dhunën në familje, b) dhunën seksuale dhe c) dhunën në familje gjatë situatës së Pandemisë Covid -19, për t'i ardhur në ndihmë anëtarëve të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR) gjatë menazhimit të rasteve të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale.

***- Si e kuptoni dhe aplikoni qasjen e ndjeshme gjinore në punën me të mbijëtuarat e dhunës (duke i dhënë përparësi sigurisë, qasjes së përqëndruar te viktima, fuqizimit) ?***

- Në formulimin e politikave dhe programeve me fokus dhunën ndaj grave dhe vajzave ( SKBGJ 2021-2030)
- Me Programe rehabilitimi dhe riintegrimi për vitkimat e dhunës në familje
- Me ngritjen e shërbimeve të specializuara në të gjithë vendin, të aksesueshme

***- A merren institucionet e sistemit në mënyrë adekuate me sigurinë e viktimave ? Në çfarë mënyre ?***

Në protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje, përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar, që, në masat që parashikohet se do të përmbajë UMPMM/UMM/UM jepet qartësisht respektimi i të drejtave dhe sigurisë së viktimave apo fëmijëve. Edhe vetë filozofia funksionimit të MKR-ve në praktikë, bazohet së pari në qasjen për sigurinë dhe mbrojtjen e viktimës dhe fëmijëve të saj (parimi kryesor: “Siguria është e qenësishme!”).

Në Qendrën e Menaxhimit të Krizës për rastet e dhunës seksuale i jepet prioritet kujdesit shëndetësor ndaj viktimës, pasi në rastet e dhunës seksuale dëmtimet shëndetësore mund të jenë të rënda dhe mund të rrezikojnë edhe jetën e viktimës. Kështu që siguria, shëndeti dhe mirëqenia e viktimës janë parësore. Vendosja e qendrës në mjediset spitalore lehtëson ofrimin e kujdesit shëndetësor urgjent edhe në rastet kur viktima mund të paraqitet me probleme shëndetësore akute si plagosje, goditje në kokë, etj., që kërkojnë ndërhyrje dhe trajtim mjekësor urgjent.

***- Cilat procedura përdoren në punën me të mbijetuarat në punën me të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore/dhunës seksuale/ përndjekjes ?***

Dokumentat e mëposhtëme përcaktojnë procedurat e punës me të mbijeturat e dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore përfshirë dhe dhunën seksuale.

Udhëzimi Nr. 816, datë 27.11.2018, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e standarteve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të Qendrave të menaxhimt të krizës për rastet e dhunës seksuale”

Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Brendshëm Nr. 912, datë 27.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”

Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Brendshëm Nr 866/20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”

MSHMS ka miratuar Udhëzimin nr.744 datë 15.11.2019 “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat/ të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtëra) publike dhe jopublike (strehëzat emergjente).

Protokolli nr. 254, datë 10 prill 2020 “Për funksionimin e qendrave rezidenciale publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime strehimi për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje dhe për viktimat/të mbijetuarat e trafikimit në situatën e pandemisë COVID-19".

Tri Procedura Standarde të Veprimit (PSV) në fushën e shëndetësisë dhe të shërbimeve të kujdesit shoqërore për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe situatat emergjente. Qëllimi: për t'u ardhur në ndihmë profesioninistëve që janë pjesë e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit për hapat që duhet të ndjekin për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, miratuar me Urdhërat e Ministres Nr.100.101 dhe 102 në prill 2020.

Nga MSHMS janë përgatitur 3 protokolle të unifikuara a) për dhunën në familje, b) dhunën seksuale dhe c) dhunën në familje gjatë situatës së Pandemisë Covid -19, *për t'i ardhur në ndihmë anëtarëve të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR) gjatë menazhimit të rasteve të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale.*

***- A ekzistojnë mjete detyruese të standartizuara të përdorura nga institucionet dhe në çfarë masë aplikohen ato për vlerësimin e rriskut (për vrasje, sulme të përsëritura)?***

Ndryshimet e LDHF të vitit 2018, përcaktuan për herë të parë hartimin në bashkëpunim me autoritetet e tjera të linjës, të procedurave, standardeve/protokolleve, për vlerësimin e riskut, planet e ndërhyrjes dhe monitorimin e zbatimit të tyre, miratimin e udhëzimit për vlerësimin e riskut, lëshimi nga policia e Urdhërit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPMM), rritja e kapaciteteve të punonjësve të policisë për rastet e dhunës në familje.

Në zbatim të detyrimeve ligjore, u miratua Udhëzimi i Përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018, "Për miratimin e modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje", i cili përcakton procedurat për kryerjen e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit dhe modelin e këtij vlerësimi.

Vlerësimi i riskut kryhet me shpejtësi, bazuar në informacionin që disponohet si rezultat i identifikimit ose raportimit të rastit të dhunës, si dhe të informacioneve të tjera që mund të mblidhen menjëherë nga pyetja e të dhunuarës, e dhunuesit ose e anëtarëve të tjerë të familjes, si dhe nga institucionet, organizatat ose individët, që kanë dijeni për rastin. Mbledhja e informacionit synon të krijojë të dhëna në lidhje me: disponimin e armëve, jo vetëm në rastet kur dyshohet për armëmbajtje pa leje, por edhe në rastet kur një e tillë disponohet me leje (ligji i dhunës parashikon se dhunuesit i bllokohet menjëherë arma e zjarrit, masë që zbatohet deri në përfundim të masave te dhena në UMM/UM); rastet e përsëritura të dhunës në familje dhe burimit të saj, nëse ka pasur edhe më parë urdhra gjyqësorë të mbrojtjes apo masa të mbrojtjes së menjëhershme; qëndrimin e dhunuesit/es ndaj urdhrave të mëparshëm për mbrojtjen nga dhuna në familje; mbi vendimet gjyqësore penale ndaj tij; gjendjen psikologjike të dhunuesit/es, nëse është përdorues i lëndëve alkoolike, narkotike ose nëse përbën kërcënim për jetën, shëndetin a lirinë e viktimës, të fëmijëve ose të anëtarëve të tjerë të familjes.

***- A e dini nëse përdoret analiza retrospektive e feminicidit në kontekstin e dhunës në familje për të identifikuar mangësitë sistematike me qëllim parandalimin ?***

Nuk ka një përkufizim të feminicidit në Shqipëri. Megjithatë, raporti vetëm i bërë lidhur me feminicidet është kryer nga Qendra “Nisma Ligjore Qytetare”.

Rastet e vrasjeve ndaj grave dhe vajzave në vite, të cilat në disa raste kanë impikuar organet ligjzbatuese si dhënia e vendimeve jo të plota të gjykatave, mo-szbatimi i Urdhrave të Mbrojtjes, mosreagimi në kohë nga Policia apo aktorë të tjerë i kanë shërbyer analizës për ndryshime ligjore, qoftë në LDHF, po ashtu në Kodin Penal. Përmendim p.sh., ashpërsimin e dënimeve për dhunuesit në vitet 2013 apo 2020.

***- A e informojnë institucionet të mbijetuarën në rastet kur autori lirohet nga burgu/ paraburgimi apo nëse arratiset ?***

Po. Kanë detyrimin ligjor sipas LDHF dhe Kodit të Procedurës

***- A janë të disponueshme shërbimet e mbështetjes për të gjitha të mbijetuarat, pa përjashtim?***

Ka vështirësi në dhënien e shërbimeve përsa i përket rasteve të dhunës, kur viktima ose dhunuesi janë me probleme të shëndetit mendor.

***- A është e mundur të sigurohet mbrojtja ndërkombëtare për të mbijetuarat nëse është e nevojshme ? Jepni një shembull nga praktika juaj.***

**LDHF në Nenit 4 të tij parashikon se:**

Subjektet që mbrohen nga ky ligj janë të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 7, të këtij ligji, që janë shtetas shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Subjekte që mbrohen nga ky ligj janë edhe shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë dhe të huajt me qëndrim të rregullt për motive të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt, që përfshihen në kategorinë e subjekteve të përcaktuara në nenin 3, pika 7, të këtij ligji.

**Raste nga praktika:**

Shtetase kosovare në një situatë të dhunës në familje, e cila u referua gjatë vitit 2020 nga KVDH Kamëz dhe u strehua në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, e larguar më pas me dëshirën e saj

## VIII. Konform Ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE:

**MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR ÇËSHTJET E RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE** ka këto detyra:

a) krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë;

b) trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje, me qëllim rritjen e kapaciteteve në identifikimin e rasteve të dhunës në familje, vlerësimin e riskut dhe intervistimin e viktimës e të dhunuesit dhe me aspekte të tjera të lidhura me zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj.

b/1) miratimin, me udhëzim të përbashkët me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, të modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje përkatëse;

c) për të evidentuar rastet edhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë;

ç) për të pajisur edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës;

d) për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

## INTERVISTA ME PËRFAQËSUESEN E DPPSH-së

Sipas të intervistuarës nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Konventa e Stambollit ishte një gjë shumë e rëndësishme për vendin tonë, duke marrë parasysh që një shoqëri maskiliste si e jona ka ende prezencë të dhunës. Ndryshimet e fundit ligjore që kanë ardhur si rrejdhojë e ratifikimit të Konventës janë pasqyruruar në rritje të numrit të denoncimeve nga gratë, pra rritje e denoncimeve dhe jo domosdoshmërisht e rasteve të dhunës. Rritja e shifrave të denoncimeve është një tregues pozitiv dhe kjo e shpreh qartë se sa rëndësi ka patur ratifikimi dhe zbatimi I konventës për SHqipërinë.

Duke filluar nga viti 2008 të gjitha ligjet kanë qenë në zbatim të Konventës, por udhëzimet e fundit nga Ministria e Brendshme dhe e Shëndetësisë për vlerësimin e rriskut dhe UMPMM ishin risi të reja që u futën në punën e policisë dhë ndihmuan goxha në vlerësimin e situatave të viktimave të dhunës në familje.

Lidhur me pyetjen që ju drejtua për burimet financiare apo njerëzore, e intervistuara u shpreh se nuk ishte dakord me shtimin e burimeve njerëzore, por për të është e nevojshme që puna të bëhet më mirë nga ata që tashmë janë.

Në raport të punës së policisë, në bazë të rekomandimeve që janë dhënë për shërbimet e viktimave të dhunës në familje janë bërë goxha përmirësime. Më parë viktimat ngeleshin në komisariate, skishin shërbime, skishin strehëza dhe tani kjo gjë është zgjidhur në shumicën e rretheve për të mos thënë në cdo bashki. Kjo është si për viktimat por edhe lehtësimi i punës së punonjësve të bashkisë.

Drejtoria e Policisë ka procedurat e veta standarde të dhunës në familje, të cilat i zbaton në mënyrë sa më rigoroze për çdo rast që paraqitet. Këto raste ruhen në statistikat e policisë me të gjitha të dhënat e nevojshme dhe që përdoren më vonë për të raportuar apo dhe kërkesat që bëjnë institucione të ndryshme.

Policia përfshihet gjithmonë në masa sensibilizuese kundër dhunës, janë 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës në familje dhe me bazë gjinore.

E intervistuara u shpreh se trajnimet nuk mungojnë dhe punonjësit e policisë marin pjesë kryeisht në ato për dhunën në familje dhe të miturit. Trajnimet më të mira ofrohen nga ekspertë të fushës të cilët shkojnë në qelizë të cështjeve të ndryshme që duhet të ketë parasysh nje punonjës policie dhe ka pasur rritje të cilësisë së shërbimit që është ofruar.  Duhen marrë parasysh nevojat në përgjithësi të një punonjësi, ku calon puna dhe cfarë duhet bërë në mënyrë që të punohet për ti zgjidhur këto problematika. Përgjegjësia për të ofruar shërbime tek viktimat është e njëjtë pavarësisht gjinsië, prejardhjes, fesë, kulturës etj.

Çdo institucion, ashtu si edhe policia kanë procedura standard për rastet e dhunës në familje dhe/ policia ka prioritet sigurinë fizike të viktimës, sepse aq mund të bëjë, më pas bëhet referimi tek mekanizmi në mënyrë që të marrë shërbimet e nevojshme, duke qenë se dhe bashkëpunimi është i frytshëm me këdo institucion apo OJF.

Përsa i përket vlerësimit të rriskut e intervistuara u shpreh se pati një efekt shumë të mirë, sepse çdo punonjës policie duhet ta plotësonte dhe nuk mund ta neglizhojë duke qenë se gjykata e kërkon atë.

Përveç ardhjes në komisariat, një grua mund ta denoncojë dhunën dhe në komisariatin dixhital, nëpërmjet numrit të telefonit, të numrit të koordinatorit në bashki apo dhe nëpërjet OJF. E intervistuara u shpreh se cdo DVP ka një koordinator për dhunën në familje dhe të miturit si dhe OPGJ për përndjekjen, dhunën në internet, por nuk ka për të gjitha format e dhunës që mbulon KS. Mbledhja e të dhënave apo provave për rastet e dhunës bëhet nëpërmjet procedurave standarde që kanë format e dhunës. Masat mbrojtëse janë për dhunën në familje, ndërsa për përndjekjen dhe sulmet kibernetike nuk kemi të parashikuara.

Të mbijetuarat e dhunës në familje marrin të gjitha shërbimet e nevojshme që janë të parashikuara, pa bërë dallim.

## INTERVISTA ME PËRFAQËSUESIN E MINISTRISË SË BRENDSHME

Në intervistën me Ministrinë e Brendshme, e intervistuara u shpreh se Konventa më së shumti prek barazinë gjinore, dhunën në familje e cila është një nga elementët që çon në trafikimin e qenieve njerëzore, perveç situatës social- ekonomike. Në punën e tyre të përditshme ky institucion përpiqet të bëjë një përmirësim të kuadrit ligjor dhe institucional, kombinuar me implementimin e tyre sa i takon ngritjes së kapaciteteve, fushatave ndërgjegjësuese në komunitet, për gratë në nevojë, viktimat e trafikimit, grupet vulnerabël etj. Në këtë institucion nuk ka një sektor apo koordinator të posacëm të dhunës në familje sepse me këtë kategori merret policia e shtetit.

Ashtu si çdo institucion edhe MB ka një sistem të dhënash që e administron sekretariati i autoritetit përgjegjës, i ngritur nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme dhe Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Anti-trafikim. Është menduar që të përfaqësohet nga profesionistë kyç në identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit. Të dhënat mblidhen të ndara sipas gjinisë, moshës, sipas statusit, viktimë e mundshme trafikimi apo viktimë trafikimi. Më pas bëhet mbledhja e të dhënave dhe raportohen një herë në 3 muaj tek Mekanizmi Kombëtar i Referimit. E intervistuara u shpreh se të gjitha shërbimet merren njësoj nga të gjithë ata që kanë nevojë. Hartuesit janë kujdesur që të kenë një optikë më të gjërë, në mënyrë që të gjithë ato masat ndërkombëtare ose evropiane të përthithen nga aktet tona ligjore apo nën ligjore.

Rritja e profesionaliszmit quhet objektivi me trajnime qoftë të avokatëve që janë shumë të rëndësishëm edhe për dhunën në familje dhe për viktimat e trafikimit. Trajnime të punonjësve të vijës së parë, të mësuesve janë shumë të rëndësishëm, sidomos për të miturit, punonjësit shëndetësorë apo dhe ato përfaqësitë diplomatike në rastet kur kemi viktima të huaj. Këto trajnime bëhen shumë shpesh për të ngritur kapacitetet për identifikimin dhe referimin e tyre. Në planin kombëtar të veprimit MB është kujdesur që të shkojmë dhe në pushtet lokal, në njësitë e qeverisjes vendore, me adminnistratorët shoqërorë, me punonjës social në bashki, me punonjësit e NJMF sepse ata e njohin më mirë realitetin dhe i dinë rrisqet që i kanosen ku ai kryen atë fushën e veprimtarisë së vet.

Përsa i përket qasjes gjinore, e intervistuara u shpreh se ata kanë një qasje të orientuar tek viktima duke I dhënë të gjitha shërbimet e nevojshme për të cilat ka nevojë. Dhe viktimat e trafikimit kanë një mekanizëm kombëtar të referimit ku janë miratuar VKM për ndihmën juridike falas, ndihmën shëndetësore falas apo dhe paisjne me libra të fëmijëve në shkollë falas sepse kemi raste kur edhe fëmijët janë viktima ose fëmijë të viktimave të trafikimit.

MB ka ngritur një bord këshillimor të viktimave të trafikimit, i cili përbëhet nga vetë viktimat. Janë gra dhe vajza të cilat kanë mbijetuar nga trafikimi dhe e shohin këtë gjë nga vetë profili i tyre sepse e dinë mirë se ku duhet ne të qasemi, cili duhet të jetë prioritet, çfarë duhet të ndryshojë etj. Sepse hartuesit mund të mos I dinë aq mirë ato.

E intervistuara shtoi se ata bashkëpunojnë me të gjitha strukturat ligjzbatuese, shtëtërore ose jo. bashkëpunimi dhe partneriteti me organizatat kombëtare e ndërkombëtare është shumë I rëndësishëm, sepse presupozohet edhe si një mjet monitorimi.

Për të krijuar besim tek oficerët e policisë e intervistuara u shpreh se bëjnë trajnime me punonjës të policisë për cështje të ndryshme për qasje positive ndaj viktimës.  Tek rastet e lypjes së fëmijëve ka pasu problematika. Në momentin që është identifikuar një fëmijë që del dhe lyp, pra një viktimë e mundshme trafikimi, punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve ka çuar dosjen në prokurori dhe çështja është pushuar. Vitet e fundit për shkak edhe të trajnimeve, gjyqtarët në bashkëpunim me MB janë kujdesur ta klasifikojnë si vepër penale.

E intervistuara u shpreh se tek MB për viktimat e trafikimit ka mbrojtje, që garantohet bazuar në ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe sigurohet një mbrojtje me të gjithë parametrat që duhet të ketë një dëshmitar.

***Konform Ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR DREJTËSINË KA KËTO DETYRA:***

a) trajnime për ekspertët mjeko-ligjorë në njohjen, diagnostikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës në familje dhe akteve të dhunës ndaj fëmijëve;

b) merr masa për përgatitjen profesionale dhe specializimin e përmbaruesve gjyqësorë në ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes, si dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre në realizimin e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj;”

“b/1) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për përgatitjen e programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje, si dhe vë në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse listën e përditësuar të të trajnuarve për këto çështje.

c) mbikëqyr funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike për viktimat e dhunës në familje, sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

ç) përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe siguron unifikimin e regjistrimit të këtyre çështjeve;

d) harton formularë të posaçëm për përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje, si dhe publikon këto të dhëna në vjetarin statistikor;

dh) nëpërmjet strukturave përgjegjëse të varësisë, siguron zbatimin e detyrimit të përgatitjes së raportit mjeko-ligjor dhe psikiatriko-ligjor nga ana e stafit të mjekësisë ligjore, bazuar në kërkesën e institucioneve kompetente dhe/ose të viktimës.

## INTERVISTA ME PËRFAQËSUESIN E MINISTRISË SË DREJTËSISË

**L**IGJ Nr. 104/2012 PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS **"PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE".**

**Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror**

**Të dhënat statistikore mbi ekzekutimin e titujve ekzekutivë me objekt "urdhër mbrojtjeje" dhe "urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje" për periudhën Janar - Dhjetor 2022:**

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 465, datë 18.07.2012 "Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm'', tashmë duke filluar nga viti 2014 është përfshirë në procesin e buxhetimit gjinor dhe ka të përcaktuar në buxhetin e tij tregues të matshëm për barazinë gjinore, ekzekutimin njëqind për qind të titujve ekzekutivë me objekt ''Urdhër mbrojtje'' dhe ''Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje''. Të dhënat statistikore të raportuara në raportet e monitorimit nga viti 2014 e në vijim, konfirmojnë një përgjegjshmëri të strukturave të shërbimit në realizimin e ekzekutimit të cështjeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2022, nëpërmjet fakteve dhe shifrave parashtrojmë veprimtarinë e ekzekutimit të titujve ekzekutivë *'urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes'* dhe *'urdhëra të mbrojtjes',* si më poshtë :

a) ***517*** *(peseqind e shtatëmbëdhjetë)* çështje me objekt **''urdhër mbrojtje''** rezultojnë të regjistruara për ekzekutim, nga këto **202** *(dyqind e dy)* çështje janë pushuar bazuar në germën (a) neni 616, i ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë'', i ndryshuar, si të ekzekutuara tërësisht, 140 (njëqind e dyzet) çështje janë pushuar bazuar në germën (c), neni 616. me dhe **174** *(njëqind e shtatëdhjetë e katër)* çështje janë në ekzekutim të vazhdueshëm në përputhje me masat mbrojtëse të përcaktuara në titullin ekzekutiv, dipsozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 ''Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare'', i ndryshuar

| Totali i Çështjeve ne ekzekutim "Urdhera mbrojtje" Janar - Dhjetor 2022 | Në ekzekutim të vazhdueshëm brenda afateve procedurale | Të ekzekutuara 616/a | Te pushuara 616/c |
|---|---|---|---|
| 517 | 174 | 202 | 140 |

b) **<u>523</u>** *(pesëqind e njëzet e tre)* çështje me objekt **''urdhër i menjëhershëm mbrojtje''** rezultojnë të regjistruara për ekzekutim, nga këto **<u>242</u>** *(dyqind e dyzet e dy)* çështje janë pushuar bazuar në germën (a) neni 616, i ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë'', i ndryshuar, si të ekzekutuara tërësisht, **<u>128</u>** *(njëqind e njëzet e tetë)* çështje janë në ekzekutim në përputhje me masat mbrojtëse të përcaktuara në titullin ekzekutiv, dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 ''Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare'', i ndryshuar, dhe **<u>118</u>** çështje janë pushuar bazur ne germen (c) neni 616.

| Totali i Çështjeve me ekzekutim "Urdhera të menjëhershëm të mbrojtjes" Janar - Dhjetor 2022 | Në ekzekutim brenda afateve procedurale | Të ekzekutuara tërësisht 616/a | Te pushuara 616/c |
|---|---|---|---|
| 523 | 128 | 242 | 118 |

- Në përmbushje të misionit të tij, atë të ekzekutimit të titujve ekzekutive si dhe parandalimin, dhe reduktimin e dhunës, Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, përgjatë kësaj periudhe, ka treguar një impenjim korrekt, të vazhdueshëm dhe në përputhje me dispozitat ligjore lidhur me ekzekutimin e çështjeve me objekt ''Urdhër mbrojtje'' dhe ''Urdhër i menjëhershëm mbrojtje'', duke garantuar ekzekutimin 100% të tyre dhe në përputhje më objektivat e parashikuara dhe të vazhdueshëm të tyre si dhe mbrojtjen me masa ligjore të viktimave të dhunës.

Vështirësitë me të cilat janë përballur më shumë përmbaruesit, duke iu referuar angazhimeve të marra për ekzekutimin e këtyre titujve ekzekutivë kanë qënë kryesisht:

- Mbingarkesa dhe volumi i punës, i cili nuk ruan një raport normal midis dosjeve përmbarimore, në total dhe numrit të përmbaruesve gjyqësore shtetërore.

- Nuk janë të pakta rastet kur masat e mbrojtjes të përcaktuara në vendimin e gjykatës nuk janë të qarta apo rastet kur dhunuesi ose debitori detyrohet të dalë nga banesa dhe Gjykata ka përcaktuar si detyrim të Shërbimit Social pranë pushtetit vendor për të gjetur strehim për dhunuesin/debitorin. Masa të tilla mbrojteje paraqesin veshtirësi për tu ekzekutuar për shkak se pushteti vendor nuk ka mundësi të garantoje strehim për dhunuesin/debitorin.

- Mungesa e bashkërendimit me efikasitet me institucionet shtetërore, të cilët në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9669, datë 18.02.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare'', i ndryshuar, kanë detyrimin ligjore për të koordinuar, bashkërenduar, zbatuar, monitoruar peroidikisht zbatimin e masave dhe parandaluar të gjitha format e dhunës, si dhe plotësimin e tyre me gjithe infrastrukturën e nevojshme, në përputhje me parimin e ''përshtatjes së arsyeshme'', që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje, përfshirë këtu asistencë financiare, shërbime mjekësore sociale, strehim, trajtim me psikolog.

- ***Ofrimi i ndihmës juridike falas***

- Në vitin 2017, Ministria e Drejtësisë ndërmori iniciativën ligjore për të bërë disa ndryshime në ligjin organik që rregullon sistemin e ndihmës juridike falas. Ligji ekzistues nr.10039/2008, u shfuqizua duke passjellë hyrjen në fuqi të ligjit nr.111/2017, i cili solli një sistem të ri të ndihmës juridike falas. Me Urdhrin nr.59, datë 25.03.2019, Ministria e Drejtësisë ndryshoi strukturën/ organikën duke parashikuar tashmë si një institucion varësie **Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas**. Kjo drejtori është institucioni i dedikuar për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas në Republikën e Shqipërisë.

- Me synim forcimin e aksesit në drejtësi përmes ligjit për Ndihmën Juridike, Ministria e Drejtësisë ka përgatitur aktet nënligjore me qëllim zbatimin e këtij ligji duke i dhënë një rëndësi të veçantë pikërisht ofrimit të ndihmës juridike falas për gratë.

- Me ligjin e ri, u zgjerua rrethi i subjekteve përfitues duke konsideruar si përfitues të ndihmës juridike jo vetëm personat në pamundësi ekonomike, por edhe personat të cilët përfitojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në cilësinë e kategorive të veçanta:

<u>Tashmë në cilësinë e kategorive të veçanta, pavarësisht të ardhurave apo pasurive të tyre, do të përfitojnë edhe: viktimat e dhunës në familje; viktimat e abuzuar seksualisht apo trafikimit të qënieve njerëzore apo viktimat e mitur.</u>

Tashmë, kategoritë vulnerable mund të drejtohen pranë ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike për të përfituar nga format e shërbimit të ndihmës juridike, të cilat përfshijnë:

- ***Ndihmë juridike parësore, e cila konsiston si vijon:***

- Informacion në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;

- Këshillim ligjor;

- Këshillim mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;

- Ndihmë në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;

- Përfaqësim përpara organeve administrative;

- Dhënien e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Për të përfituar nga kjo formë e ndihmës ligjore qytetarët mund t’í drejtohen qendrave të ofrimit të ndihmës juridike.

- ***Ofrimi i ndihmës juridike parësore*** **nëpërmjet platformës juristionline.al .**

Në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e pandemisë (Covid-19), u mbyllën qendrat e ndihmës parësore dhe një pjesë e procesve të punës u pezulluan. Duke qënë një shërbim ngushtësisht i lidhur me qytetarin, kurrëssi ndihma juridike nuk mund të mos ofrohej dhe në këto kushte kufizimi. Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me OSFA, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka vijuar me ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes platformës juristionline.al

DNJF ka ndërmarrë një sërë masash në kuadër të promovimit të kësaj platforme por edhe sa i përket cilësisë së shërbimit të ofruar. Shërbimi i ndihmës juridike falas quhet se është garantuar në mënyrë të plotë, me eficiencë dhe efektivitet vetëm atëherë kur është ofruar me cilësinë e duhur. Në këtë kuadër, është shumë e rëndësishmë që t'i kushtohet vëmendja e duhur kombinimit të shifrave sasiore me të dhënat e cilësisë së shërbimit.

- ***Ofrimi i ndihmës juridike parësore nëpërmjet numrit të gjelbër pa pagesë 08001010.***

Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarra për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike parësore, DNJF me mbështetjen e OSFA, ka vendosur në dispozicion një linjë të gjelbër, në të cilën kanë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosja e një numri falas është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. Si platforma juristionline ashtu edhe linja e gjelbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime profesionale dhe me standard te lartë dhe duke qenë sa më pranë qytetarit.

## MINISTRIA E FINANCAVE

### *Masat e marra dhe buxhetet përkatëse në fushën e aksesit të grave në programin e Strehimit Social*

Referuar nenit 16 të ligjit të strehimit nr. 22/2018 “Për strehimin social“, viktimat e dhunës në familje/viktimat e trafikimit apo viktima të mundshme të trafikimit dhe gra kryefamiljarë që kanë në ngarkim fëmijë janë kategori të cilat trajtohen me prioritet me programe strehimit. Gjatë vitit 2022 rezultoi se prej 2,761 përfituesve në total nga programet e strehimit 182 ose 7% e përfituesve janë gra kryefamiljare dhe viktima të dhunës në familje. Tabela në vijim paraqet në mënyrë më të detajuar përfituesit e këtyre kategorive nga programet e strehimit.

Viti 2022:

| Programet e Strehimit | Buxheti në total për vitin 2022(lekë) | Nr. i përfituesve | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Përfitues në total | Përfituese femra | % e përfituesve femra ndaj totalit |
| Subvencionimi i Interesave të Kredive të reja | 8,543,000 | 241 | 26 | 10.8% |
| Subvencionimi i Qirasë | 169,723,000 | 1784 | 75 | 4.2% |
| Grant I Menjëhershëm | 6,340,000 | 28 | 14 | 50% |
| Programe e Investimit(Përmirësimi i kushteve të banimit dhe Banesa Sociale me qira) | 330,778,000 | 708 | 67 | 9.4% |
| Total | 515,384,000 | 2,761 | 182 | 7% |

P**ërqindja e përfituesve të kategorisë "femra të dhunuara" dhe "gra kryefamiljare"** është një nga treguesit e performancës në programin e strehimit. Ky tregues llogaritet në mënyrë akumulative nga viti 2016, bazuar në “Strategjisë e Strehimit Social 2016-2025”. Realizimi i këtij treguesi performance, deri në fund të vitit 2022 është **763** (këtu nuk përfshihen përfituesit e kredive të vjetra para vitit 2019).

Buxheti për programin e Strehimit është i ndarë sipas zërave programeve dhe nuk ka një fond të dedikuar vetëm për përfituese gra dhe vajza.

Nëse i referohemi përqindjes së përfituesve për ketë kategori buxheti i vitit 2022 është rreth **36 milionë lekë.**

## INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT

Institucioni i Avokatit të Popullit është parashikuar për herë të parë në Kushtetutën Shqiptare të miratuar në Nëntor 1998, kurse ligji “Për Avokatin e Popullit” është miratuar nga Parlamenti Shqiptar në shkurt të vitit 1999. Ky ligj është hartuar duke patur parasysh dhe legjislacionin e vendeve të tjera të Evropës, të cilat e kanë krijuar më parë një Institucion të tillë. Drejtimi i Institucionit të Avokatit të Popullit është monokratik. Avokati i Popullit zgjidhet nga tre të pestat e gjithë anëtarëve të Kuvendit për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Institucioni i Avokatit të Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai ka si mision të tij parandalimin e konflikteve të mundshme midis administratës publike dhe individit. Avokati i Popullit vepron në bazë të ankesës apo kërkesës së paraqitur pranë tij. Ai vepron edhe me nismën e vet, për raste të veçanta, të bëra publike, por gjithmonë duhet të marrë më vonë pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit.

Në rastet kur Avokati i Popullit fillon proçedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur apo i paaftë mendërisht apo me aftësi të kufizuara ose për mbrojtjen e të drejtave të një numri të madh të individëve.

Në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjerë, të cilët mund të preken nga proçedimi administrativ, Avokati i Popullit ka të drejtë të fillojë një procedim administrativ dhe të marrë pjesë në të, në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative.

Avokati i Popullit nuk vendos direkt vetë për t’ju dhënë të drejtat personit që ankohet, por bën rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi i administratës publike që, sipas tij, ka shkaktuar shkeljen e saj. Në rastet kur organi përkatës nuk reagon ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ky i fundit mund t’i drejtohet shkallë-shkallë organeve më të larta në hierarki, deri edhe Kuvendit (Parlamentit) me një raport, duke propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.



## INTERVISTA ME INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT

Në intervistën me përfaqësuesen e institucionit të Avokatit të Popullit, e intervistuara pohoi se Shqipëria ishte vendi i dytë pas Turqisë që firmoi dhe ratifikoi KS. Ajo u shpreh se kjo konventë bashkë me atë të OKB-së, përbëjnë kuadrin më të rëndësishëm ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria në fushën e të drejtave të grave dhe të luftës kundër dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhe dhunën në familje. Por më e rëndësishme se ratifikimi i tyre është zbatimi nga institucionet përgjegjëse. Shqipëria ka ndërmarrë hapa të herëpas-hershme për ta zbatuar konventën. Ligje të ndryshme kane pësuar ndryshime në elementë shumë të rëndësishëm që vijnë si rrjedhojë e rekomandimeve të Komitetit Grevio. Dhe Shqipëria në fakt vërtet vlerësohet që ka një legjislacion të mirë për dhunën në familje, dhunën me bazë gjinore. Por pavarësisht legjislacionit të mirë dhe të përmirësuar ka ende nevojë për më shumë përmirësime.

E intervistuara u shpreh se ka qenë pjesë e hartimit të KS prandaj dhe e njeh shumë mirë atë.

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP) është një institucion kushtetues për të drejtat e njeriut, i cili shqyrton dhe ka në vëmendjen e tij ose në fushën e veprimtarisë së tij promovimin, mbrojtjen dhe garantimin nga shkeljet e të drejtave të njeriut që bën administrata shtetërore, administrata publike ndaj individid apo grupeve të individeve. Shkeljet e të drejtave të grave është një nga format më të përhapura, roli i AP mund të jetë mjaft i madh pikërisht në promovimin e këtyre të drejtave dhe mbrojtjen e të drejtave të grave. Përvec raporteve vjetore AP përgatit dhe raporte specifike të cilat kërkohen nga parlamenti ose vetë me iniciativën e tij të cilat jua dërgon institucioneve në nivel vendor apo qëndror. Më pas mbetet përgjegjshmëria e tyre nëse i respektojnë/zbatojnë apo jo. Në këtë lloj forme, pra npm raporteve, rekomandimeve institucioni i AP kontribuon në zbatimin e KS.

Problematikat që e intervistuara theksoi kishin të bënin me çështjet e strehimit të viktimave të dhunës në familje dhe strehimit të tyre pasi dalin nga qendrat, ose që kanë të bëjnë në mënyrë direct të drejtpërdrejtë me integrimin e riintegrimin e tyre. Cështjet që janë hasur më shumë në punën e saj kanë qenë cështje të ngacmimit seksual por edhe të atyre grave dhe vajzve me problem të shëndetit mendor të cilat dy vitet e fundis sidomos pas pandemisë janë shtuar shumë. Ndoshta ka shumë elementë që nga ligji, strukurat, ndërhyrja, roli që është bërë me ndërgjegjësimin nga organizatat të shoqërisë civile, nga media nga ana tjetër mund të ketë bërë që ta nxjerrë më në pah problemin e denoncimit të këtyre rasteve ose që këto të dalin më hapur.

Lidhur me burimet financiare apo njerëzore që shteti ndan, e intervistuara u shpreh se ka mungesë të burimeve njerëzore të mjaftueshme dhe sidomos e burimeve financiare. po nuk u fuqizuan strukturat në nivel qëndror dhe vendor, strukurat shtetërore, shërbimet dhe po nuk u ndanë burimet e mjaftueshme financiare nuk mund të shkojmë drejt përparimit. ka nevojë shumë për struktura me burime njerëzore, financiare dhe të fuqizuara dhe nga ana e kapaciteteve që të njohin mirë cështjen. Ka nevojë shumë që koordinatorët vendorë të punojnë vetëm për këtë cështje. Në shumë bashki ato vazhdojnë të luajnë shumë funksione si nënpunës gjinor, punonjës për mbrojtjen e fëmijëve, për romët, aftësinë e kufizuar dhe kjo nuk mund të bëhet më.

Trajnimet që organzohen qoftë nga projekte, programe të ndryshme apo qoftë edhe nga strukturat shttërore janë shumë të vlefshme. trajnimet ngelen një fushë në ngritjen e kapaciteteve që duhet të vazhdojë. Megjithatë lidhur me policinë ka ende shumë nevojë për ato struktura që kanë lidhje direkte me denoncimet ose cështjet e dhunës në familje që ende nuk dinë të plotësojnë vlerësimin e rriskut, urdhërin paraprak të mbrojtjes së menjëhershme të vazhdojnë të bëhen trajnime.

Janë bërë shumë trajnime në të gjithë vendin me policinë por edhe pas trajnimit të tyre kur është kërkuar të monitorohen se si e plotësojnë vlerësimin e rriskut ka rezultuar që shkruajnë dhe budalliqe aty, ose që nuk dinë fare se si ta plotësojnë. Vështirësi ka pasur edhe me punonjësit e shëndetësisë të cilët edhe pas trajnimeve rezulton se regjistrat nuk ekzistojnë pranë mjekut të familjes, nuk lëshohen raportet mjekësore, që është raporti mjeko-ligjor ai që do të paraqitet dhe që ka vlerën e provës në procesin gjyqësor. kjo si problematikë ka ardhur nga shoqëria civile që gjithmonë ka shtyrë ka nxjerrë si problematika të tilla. duhet cdo institucion përgjegjës të bëjë detyrën e tij.

Ka mjaft mekanizma kombëtarë të referimit që janë ngritur si rrjedhojë e rekomandimeve të KS, por nuk mafton vetëm ngritja e tyre, duhet edhe që të fuqizohen dhe të rivlerësohen pasi VKM-të kanë ende probleme.

Në momentin që një e mbijetuar dhune ka nevojë për ndihmë dhe paraqitet në ambientet e këtij institucioni, pritet, dëgjohet he më pas referohet tek shërbimet e nevijshme në bazë të problematikës që ka.

E intervistuara u shpreh se kishte marrë pjesë në shumë trajnime për barazinë gjinore, dhunën si brenda ashtu dhe jashtë vendit dhe mendon se të gjithë komisionerët duhet të marrin trajnim për barazinë gjinore dhe të dhunës në mënyrë që institucioni të marrë atë ndjeshmërinë gjinore në cdo aspect.

Grupet vulnerabël janë ata që pësojnë diskriminimin më të madh, romët egjiptianet, mungojnë shërbimet e specializuara sidomos për aftësinë e kufizuar. Psh qendrat nuk janë të aksesueshme ose janë pjesërisht të aksesueshme. Shteti duhet të japë më shumë dhe për programet e rehabilitimit dhe ato të riintegrimit të cilat janë cështje që i ngre dhe KS.

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucion publik i pavaruar, i cili është krijuar dhe funksionon në zbatim të Ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në përputhje me Direktivat e BE në fushën e mosdiskriminimit.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me datë 04.02.2010 miratoi ligjin nr.10 221” Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u krijua bazuar në këtë ligj si institucion i pavarur në ushtrimin e detyrës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor,orientimit seksual,bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjëndjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore,përgjegjësisë prindërore,moshës, gjendjes familjare ose martesore,gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, preidispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar,përkatësisë në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër

## INTERVISTA ME KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

I intervistuari u shpreh se :

-ligji për dhunën në famije është më i rëndësishmi si dhe ka pasur ndikim të madh, duke qenë se nga ana ligjore është reflektuar në shumë aspekte, por përsa i përket zbatimit është gjë tjetër. Shqetësimi më i madh që hasim sot ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës pasi nuk janë krijuar të gjitha kushtet e nevojshme duke filluar me strehimin e fuqizimin ekonomik të këtyre viktimave.

-Shteti nuk ka burime të mjaftueshme financiare apo njerëzore dhe për këtë duhen marrë masa. Duke qenë se dhuna ndodh në marrëdhënie familjare, kanë ngarkesë ekstra dhe duan ndërhyrje speciale nga ana e shtetit duke pasur me patjetër psikologë, sociologë, vlerësim si dhe aspektin material. Duhen shërbime konkrete të mira pasi kjo gjë bën që të kemi raste të përsëritura.

-Për pjesën e Komitetit të Grevio-s, i intervistuari u shpreh se një pjesë të tyre i njihte duke qenë se këto rekomandime janë pjesë e punës së tij por se sa realizohen këto rekomandime dhe masat që merren për realizimin e tyre është e vështirë të përcaktohet. Institucioni i Komisionerit ka më shumë në vëmendje aspektin rekomandues dhe aspektin studimor si dhe bashkëpunimi me organisma të tjerë. Edhe pse miratohen ligje të mira, zbatueshmëria e tyre ka problematika si nga aspekti i akteve nënligjore ashtu edhe nga interpretimet që administrata jep në situata të ndryshme. Institucioni ka bërë monitorime të situatësnë mënyrë që më pas të bëjë rekomandimet për problematikat e nxjerra. Më pas këto i janë dërguar Komisionit të Çështjeve Sociale në Kuvend apo dhe organizmave të tjerë që të dinë se cfarë ndodh me ligjet e tyre dhe si zbatohen ato.

-Përsa i përket referimit të rasteve të viktimave të dhunës, i intervistuari shtoi se për shkak të natyrës së situatës, viktimat e dhunës në momentin që kanë përballje me dhunë kanë nevoja të tjera për të shmang rrezikun ku janë. Ndërsa fokusin e tyre ka të bëjë më shumë me ceshtjet e diskriminimit dhe jo me shërbimet direkte që mund të marrin gratë. Momentalisht Komisioneri po bën një rekomandim për kategoritë brenda grave sepse mund të jenë gra por vijnë nga zonat rurale, janë me aftësi të kufizuar, vijnë nga komunitete të ndryshme etj. Dhe duhet parë si trajtohet dhuna në këto kategori, si ofrohen shërbimet dhe cilat janë problematikat.

-I intervistuari u shpreh se ne nuk jemi në një fazë të mirëstruktuar të zbatimit të këtyre ligjeve si dhe nuk kemi burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzish për t'iu përgjigjur në mënyrë sa më efektive situatave. Problematika të ndryshme hasen në trajtimin e situatave të dhunës në familje prandaj dhe është e nevojshme që shoqëria si fillim të marrë edukimin e duhur, të ketë shërbimet e nevojshme si dhe të merremi me fuqizimin e viktimave.

-Duhen fuqizuar shërbimet e OJF-ve të cilat kanë një eksperiencë të gjatë dhe veprojnë në zona të ndryshme duke kontribuar më të mirën e tyre. duhet që ato njerëz që punojnë të dedikuar për këtë gjë, nëse ti një njeriu i ngarkon 3-4 punë për të bërë, do ta ketë të vështirë ai t'i përgjigjet të gjithave me të njëjtën cilësi. Kështu që kjo kërkon të ketë njerëz që janë aty për atë gjë dhe do të duhet të bashkëpunojnë me të gjitha institucionet e tjera për të arritur për ti dhënë përgjigje një familjeje duke i dhënë të gjitha shërbimet që i nevojiten.

## MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**Konform Ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARËDHËNIET FAMILJARE, MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT ka këto detyra:**

3/1. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulojnë, kanë këto detyra:

a) harton programet mësimore për shkollat e mesme dhe të larta për rregullat e sjelljes në familje.
b) Përgatit teksetet shkollore dhe material të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare.
c) parashikon programe për arsimimin parauniversitar e profesional të të miturve dhe të rinjve nga 18 deri në 21 vjeç, që janë dhunues, dhe të të miturve që janë viktima, me qëllim rehabilitimin, riintegrimin dhe rishoqërizimin e tyre.

## INTERVISTA ME PËRFAQËSUESIN E MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

Konventa e Këshillit të Europës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" (Konventa e Stambollit), është ratifikuar me ligjin nr.104/2012 datë 08.11.2012, Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje".

***- Në çfarë mënyre/deri në çfarë mase zbatohen standardet/masat/detyrimet e Konventës në Shqipëri ?***

Në bazë të nenit 116, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj prevalojnë mbi ligjet e brendshme.

Bazuar në nenin 122, të Kushtetutës, çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren **Z**yrtare. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji.

***- A ka nevojë Shqipëria për Konventën e Stambollit? A është legjislacioni kombëtar i zhvilluar mjaftueshëm për mbrojtjen efektive nga dhuna për gratë dhe fëmijët të mbijetuar të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje ?***

- Sipas ligjit nr. 9770, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri" dhe ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, autoriteti shtetëror përgjegjës për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje është ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore.

- Gjithashtu, në bazë të vendimit nr. 609, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", MSHMS, ushtron veprimtarinë e saj, ndër të tjera dhe për: "Zhvillimin e politikave për adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore, të abuzimit ndaj fëmijëve, grave dhe grupeve të tjera, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, etnisë dhe minoritetit".

- Sa më sipër gjykojmë që kjo pyetje lidhet me MSHMS, por lidhur me miratimin e akteve ligjore për mbrojtjen efektive nga dhuna për gratë, në Republikën e Shqipërisë është miratuar ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" (para ratifikimit të Konventës).

- Në përputhje me këtë ligj, si dhe me Konventën, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (ministri përgjegjës në atë kohë), Këshilli i Ministrave ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe të Planit të Veprimit 2016-2020, me vendimin nr. 733, datë 20.10.2016.

-Po ashtu, me vendimin nr. 400, datë 30.6.2021. të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është miratuar Strategjia Kombëtare për barazinë Gjinore, 2021-2030 dhe të Planit të saj të Veprimit. Në përmbajtje të Strategjisë citohet që: "Ky dokument strategjik reflekton në mënyrën e duhur edhe plotësimin e standardeve apo detyrimeve që rrjedhin nga dokumente të tjera ndërkombëtare, ku ndër më të rëndësishmet veçojmë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskrimiminit ndaj Grave (CEDAË) , Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit, si dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)".

Në pikën 2, të Strategjisë përmendet që:

"Qeveria e Shqipërisë prej vitesh tashmë ka vënë në prioritet fuqizimin e kuadrit ligjor dhe institucional, në lidhje me barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore e dhunën në familje, duke synuar njëkohësisht dhe harmonizimin e këtij kuadri ligjor kombëtar me atë ndërkombëtar, bazuar veçanërisht në: Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË) dhe Protokollin Shtesë të saj, Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020–2025 të Bashkimit Evropian dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III)

2021–2025 etj”.

***- A mund të përmendni një ligj/akt nënligjor të ri që është miratuar/dekretuar nga shteti në përputhje me Konventën ? Cili ?***

Referuar Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, konstatohet që ligji nr. 35/2020, “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar, që konsiston në kriminalizimin e dhunës psikologjike, mbrojtjen e personave në lidhje ose ish-lidhje intime me autorin e veprës penale etj., pra që harmonizon përmbajtjen e këtij neni me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe ndryshimet në ligjin për dhunën në familje. Gjithashtu, ligji parashikon ashpërsimin e dënimeve për disa figura të kësaj vepre penale. Ky ndryshim i Kodit Penal për çështje që lidhen me dhunën në familje është tepër i rëndësishëm dhe në vijim të të gjitha parashikimeve, si vepra penale për dhunën në familje dhe forma të tjera të dhunës ndaj grave, ndryshime këto të ndodhura në vitet 2012 dhe 2013”.

***- A mendoni se shteti ndan burime të mjaftueshme, njerëzore dhe financiare, për zbatimin e politikave/masave/programeve ?***

Po, janë burime të mjaftueshme.

***-Si e kuptoni rolin/rëndësinë e Komitetit GREVIO ?***

Si një organ i pavarur i përbërë nga anëtarë të pavarur dhe të paanshëm, të zgjedhur për kompetencën e tyre të pranuar në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, dhunës ndaj grave dhe/ose ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave, luan një rol kyç në monitorimin e kësaj Konvente. Gjithë procesi i monitorimit në hapat e parë të tij nga vlerësimi fillestar e deri tek propozimi dhe mbështetja për realizimin e masave për të përforcuar zbatimin e Konventës janë një mbështetje por edhe një shtysë për përmirësimin e Konventës për vendet të cilat e kanë ratifikuar.

***- A jeni njohur me rekomandimet e Komitetit GREVIO për forcimin e zbatimit të Konventës? Nëse po, a keni pasur mundësi t'i lexoni ato ?***

Po, nëpërmjet Raportit të GREVIO- s për Shqipërinë, për masat legjislative dhe të tjera që zbatojnë dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

***-Në çfarë mënyre institucioni juaj kontribuon në zbatimin e Konventës së Stambollit ? Si kontribuoni në zbatimin e Konventës së Stambollit ?***

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka kontribuar në realizimin e masave të parashikuara në Konventën e Stambollit respektivisht në nenin 14 “Edukimi”, përfshirë arsimin parauniversitar dhe atë të lartë nenin 15 “Trajnimi i Profesionistëve” lidhur me trajnimin e duhur për profesionistët përkatës që parashikon kjo konventë. Në fushën e edukimit MAS dhe institucionet

e saj të varësisë marrin hapat e nevojshme për të përfshirë materiale mësimore mbi çështje të tilla si: barazia midis burrave dhe grave, rolet gjinore të pasteriotipizuara, respekti i ndërsjelltë, zgjidhja e konflikteve pa dhunë etj të përshtatura me kapacitetin në zhvillim të nxënësve në programet mësimore zyrtare dhe në të gjitha nivelet arsimore. Në kuadër të Konventës së Stambollit, të Këshillit të Evropës, "Për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", edhe nga institucionet e Arsimit të Lartë (IAL-të), në vendin tonë, janë ndërmarrë një sërë iniciativash si akte regullatore, marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata jofitimprurese, si dhe janë zhvilluar aktivitete si fushata ndërgjegjësuese, programe trajnimi etj lidhur me parandalimin e këtij fenomeni.

***- A keni pasur ju apo institucioni juaj një mundësi për të kontribuar në raportimin mbi zbatimin e Konventës ? Në çfarë mënyre ?***

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si autoriteti kryesor përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje përgatit raportin për Shqipërinë në kuadër të zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën ndaj dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”, Konventa e Stambollit. MAS dhe ministritë e tjera të linjës apo edhe institucionet e tjera të përfshira raportojnë periodikisht mbi realizimin e masave që përfshijnë fushën e përgjegjësisë së tyre.

***- Sa shpesh merrni pjesë në trajnime? Në cilat tema? Keni material edukativ? Cilat tema mungojnë?***

Trajnime për punonjësit arsimorë, punonjësit e shërbimit psiko-social, mësues, nxënës, prindër, koordinatorë të dhunës ndaj grave pranë bashkive, oficerë sigurie organizohen në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme gjatë vitit shkollor. Disa nga temat e trajneve janë:

• Rritja e kapaciteteve për stafet që adresojnë dhe ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës me bazë gjinore.
• Baza Ligjore për mbrojtjen e te drejtave te njeriut, Dhuna në familje, 16 ditët e aktivizmit të dhunës me bazë gjinore.
• Dhuna ne familje dhe Barazia gjinore. Kuptimi mbi barazinë gjinore dhe si te dallojmë shenjat e para që tregojmë se kemi të bëjmë me një rast dhune.
• Nenet mbi dhunën, ligjet dhe shërbimet e ofruara mbështetëse.
• Mënyra të shëndetshme te zgjidhjes se konflikteve;
• Menaxhimi i zemërimit dhe shmangja e konflikteve me fëmijët;
• Stop Dhunës ndaj gruas pasojat qe sjell dhuna në familje dhe komunitet. Mbrojtja e femijëve nga dhuna në familje. Si ta denoncojmë dhunën.
• Menaxhimi i konflikteve; Bullizmi Gjinor, Menaxhimi i klasës.
• Menaxhimi i zemërimit te adoleshentët. Mënyra të sukseshme të prindërimit. Stilet e prindërimit.
• Sensibilizim për të parandaluar dhunën ne familje. Pankarta, informacione, raste të grave te dhunuara shkaqet dhe pasojat qe kanë çuar në këtë dhunë.
• Liria e gruas; pavarësia e gruas në familje; sjellja në shoqëri;

***- A merren institucionet e sistemit në mënyrë adekuate me sigurinë e viktimave ? Në çfarë mënyre ?***

Mbrojtja dhe Mbështetja e Viktimave të dhunës bazuar në Ligjin për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare është detyrë e Institucioneve Vendore, pra e bashkive përkatëse. ZVAP-të mund të raportojë lidhur me këtë çështje bazuar në informacionin që ato mund të kenë pasur në institucionet arsimore. Në Ekipin Teknik Ndërsektorial dhe në Grupin Teknik Ndërsektorial të ngritur si Ekipe Ndërsektoriale të trajtimit të rasteve të referuara të dhunës, marrin pjesë përfaqësues të të gjitha institucioneve të cilët japin mendime në hartimin e planit të ndërhyrjes si dhe marrin detyrat që duhet të realizojnë në zbatim të planit të ndërhyrjes.

***-Cilat janë masat për reduktimin e barrierave ligjore dhe praktike ?***

Sipas ligjit nr. 9770, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri" dhe ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, autoriteti shtetëror përgjegjës për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje është ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore e për pasojë masat për reduktimin e barriera ligjore propozohen nga autoriteti përgjegjës.

## IX. INTERVISTA me 4 OJF

***-Kur filloi të implementohet Konventa e Stambollit në Shqipëri ?***

-Prej ratifikimit te Konventës së Stambollit, shtetit shqiptar i burojnë detyrime të caktuara që duhet t'i permbushë. – **OJF nr 1.**

Shqipëria është vendi i dytë që e ratifikoi dhe sigurisht që filloi të implementohet në momentin që konventa hyri në fuqi dhe, (nuk e mbaj mend saktë vitin) në momentin që hyri në fuqi të gjithë shtetet, bashkë me Shqipërinë sigurisht që e kishin si detyrim implementimin e saj. **– OJF nr 2**

Me sa di unë rreth vitit 2011 e ka filluar dhe e ka ratifikuar vendi ynë, ndër vendet e para. Është e rëndësishme se përcakton detyrimet ndaj shteteve, por që atëhere, siç e dimë ne dhe siç e dinë të gjithë përsa i përket këtij konteksti vazhdojnë ende detyrime të përgjithshme që i gjeneron ose i kërkon konventa të mos zbatohen. Ndër to unë do përmend kryesisht detyrimin që i takon shërbimeve sociale në përgjithësi për gratë dhe vajzat e dhunuara dhe sidomos gama më e gjerë jo thjesht dhuna në familje që mbeten jashtë shërbimeve të specializuara sipas kërkesës së konventës.

Me këtë kam thënë dhe faktin sa e rëndësishme është konventa dhe pse detyrohen shtetet si Shqipëria që t'i zbatojnë disa detyrime. Është instrument ligjor ndërkombëtar dhe i detyron shtetet që të zbatojnë këto, ajo ka përcaktuar detyrimet dhe kërkon zbatimin e tyre. Është edhe për parandalimin, por edhe përsa i përket direkt luftës së dhunës ndaj grave. **–OJF nr 3**

-Ka një rëndësi të madhe sepse ka ligje që janë të nevojshme, janë rregullatore dhe ne si shoqëri duhet t'i zbatojmë. **– OJF nr 4**

***-Cila është rëndësia e Konventës së Stambollit për Shqipërinë ? Pse ?***

Konventa e Stambollit e ngarkon Shqipërine me detyrime të caktuara ne lidhje me parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave te dhunes me baze gjinore, perfshire dhunen ne familje. Kjo e avancon Shqipërinë në përmbushjen e standardeve nderkombetare dhe sjell progress ne zbatimin efektiv te neneve te Konventes. **–OJF nr1**

Është një rëndësi e jashtëzakonshme sepse Konventa e Këshillit të Europës që ka lidhje me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje ështe detyruese, ligjore për shqipërinë, ndryshe nga konventat e tjera që ke thjesht një Gentleman agreement kurse ne rastin e kësaj konvente sic janë përgjithësisht konventat e Këshillit të Europës, detyrimi është që ato të zbatohen në mometin që ato ratifikohen dhe ti e ke detyrim pastaj si shtet që ti kesh të gjitha gjerat që parashikon Konventa. Ti ndërtosh si sisteme dhe pastaj ti zbatosh. **– OJF nr 2**

Me këtë kam thënë dhe faktin sa e rëndësishme është konventa dhe pse detyrohen shtetet si Shqipëria që ti zbatojnë disa detyrime. Është instrument ligjor ndërkombëtar dhe I detyron

shtetet që të zbatojnë këto, ajo ka përcaktuar detyrimet dhe kërkon zbatimin e tyre. Është edhe për parandalimin por edhe përsa i përket direkt luftës së dhunës ndaj grave.**- OJF nr 3**

Ka një rëndësi të madhe, sepse ka ligje që janë të nevojshme, janë rregullatore dhe ne si shoqëri duhet t'i zbatojmë. **OJF nr 4**

***-Në çfarë mënyre/deri në çfarë mase zbatohen standardet/masat/detyrimet nga Konventa në Shqipëri ?***

Standardet e Konventes në Shqiperi zbatohen ne menyre progresive. Per te matur progresin e Shqiperise ne zbatimin e standardeve te Konventes se Stambollit shihni raportet e shtetit shqiptar dhe rekomandimet e Komitetit te Paleve.
*https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/albania* **- OJF nr 1**

Për këtë arsye ekziston një monitorim i Grevios dhe një raport. Kur Grevio monitoron secilin prej vendeve nuk është se nxjerr një përqindje se sa prej neneve të konventës zbatohen dhe sa nuk zbatohen. Çdo shtet që monitorohet, dhe monitorohen të gjitha shtetet që e kanë ratifikuar konventën, në fusha të caktuara kanë detyrime nga konventa që nuk i zbatojnë dhe u lihen si detyrë që të zbatohen në raportimin e rradhës. **- OJF nr 2**

Në çfarë mase zbatohen...? Unë e përmenda pak më sipër që për parandalimin për hir të së vërtetës I është kushtuar një vëmendje e mjaftueshme në objektivat e Strategjisë Kombëtare kundër dhunës në familje dhe barazisë gjinore. Strategjia që është 10 vjecare ka një nga fushat apo drejtimet strategjike pikërisht për parandalimin, patjetër që ka për shërbimet sic e kërkon dhe konventa mbrojtja, siguria etj. Cështja është që një pjesë e mirë e konventës është ende e pazbatuar në Shqipëri sidomos detyrimet që lidhen me ngritjen e strehëzave emergjente, ngritjen e strehëzave afatgjata edhe cështje që I takojnë pastaj shërbimeve afatgjata sociale jo detyrimisht brenda në strehëza, në rehabilitimin dhe rikthimin në jetën normale. **- OJF nr 3**

Besoj që ka zbatim deri diku të këtyre masave dhe rekomandimeve apo detyrimeve që ka kjo konventë. Nuk jam ekspert për Konventën e Stambollit, Ok, i njoh ato më kryesoret, por nuk di të them më shumë. **OJF nr 4**

***-A ka nevojë Shqipëria për Konventën e Stambollit ? A është legjislacioni kombëtar i zhvilluar mjaftueshëm për mbrojtjen efektive nga dhuna për gratë dhe fëmijët të mbijetuar të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje ?***

Po, Shqipëria ka nevojë për Konventën e Stambollit. Legjislacioni shqiptar është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme referuar në Konventën e Stambollit, duke u përqasur dhe duke u sjellë në përputhje me të. Shumë nga ndryshimet që legjislacioni shqiptar ka pësuar në vitet e fundit janë bërë në përqasje me kërkesat e konventës si psh., pjestarët e familjes dhe rrethi i tyre, mbrojtja e menjëhershme dhe efektive, buxhetimi i sherbimeve etj. Të tjera ndryshime që priten të bëhen lidhen me adresimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore. **- OJf nr 1**

Shqipëria, e thashë dhe më përpara që ka shumë nevojë për KS, sepse parashikon standardet më të larta për të mbrojtur gratë nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje. Është mjaftueshëm është, ama nga ana tjetër ne nuk kemi një legjislacion të mirëfilltë që flet për dhunën për gratë ne kemi vetëm lëgjislcaion që flet për dhunën në familje. Kjo është një nga gjërat që duhet të ndryshohet dhe është dhe një nga rekomandimet e Grevios për Shqipërinë. **OJF nr 2**

Sigurisht që ka nevojë pasi po flasim për një legjislacion kombëtar dhe Shqipëria dhe jo vetëm do thoja cdo shtet ka nevojë për të tilla legjislacione. Sic është kjo e Stambollit, CEDAW apo ajo që ne merremi dhe kemi në focus: Konventa e të drejtave të fëmijëve. **OJF nr 3**

***-Si do t'i vlerësonit njohuritë tuaja mbi Konventën e Stambollit nga 1 në 5?***
***Rretho.***
***1 2 3 4 5 - të tria OJF- të***

Midis 1 dhe 2, njohuritë janë të pakta sepse më së shumti punën e kemi me të drejtat e fëmijëve. **OJF nr 4**

***-A mund të përmendni një ligj/akt nënligjor të ri që është miratuar/dekretuar nga shteti në përputhje me Konventën ? Cili ?***

Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar. **OJF nr 1**

Patjetër të gjitha, edhe ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare dhe ndryshimet që janë bërë ligjit patjetër që kanë lidhje me zbatimin e detyrimeve që vijnë si pjesë e rekomandimeve te KS. Edhe krijimi i fondit social për mbështetjen e organizatave jo fitimprurëse prap vjen si detyrim i KS, edhe ngritja e një qendre për viktimat e dhunës seksuale patjetër që vjen prap si pjesë e rekomandimeve të Grevios. Kështu që nga koha kur është bërë baseline i evaluation që ka qenë në 2016 der tani kanë ndodhur shumë ndryshime pozitive në mënyrë që pjesa ligjore të shkojë në të njëjtën linjë me udhëzimet e KS dhe me detyrimet që vijnë prej saj. **OJF nr 2**

Akti nënligjor i ri është pikërisht ky mbi regjistrin e dhunës seksuale duke qenë se konventa ka specifikuar që nuk do merremi vetem me dhunën por do punojmë me cështje që i takojnë, patjetër dhuna seksuale është formë e rëndë e dhunës me bazë gjinore por të mos qëndrohet vetëm tek ajo dhuna në familje. Regjistri për dhunuesit, regjistri kombëtar është po themi nisma më e re dhe më e rëndësishme ligjore deri tani. Janë dhe këto amendimet që i janë bërë ligjit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Të gjitha amendimet që kanë ndodhur në vitin 2018, amendimet më të fundit në 2020 që janë të rëndësishme, sidomos do vecoja largimin nga banesa të dhunuesit. **OJF nr 3**

Po, mund të përmend ligjin për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. **OJF nr 4**

***- A mund të jepni një përkufizim në legjislacionin kombëtar që është ndryshuar dhe përafruar me Konventën e Stambollit ?***

Pjestarët e familjes, Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar. **OJF nr 1**

Përkufizim në legjislacionin shqiptar që eshtë ndryshuar dhe përafruar…këto që përmenda tani më të fundit janë ndryshuar dhe mbetet ende shumë punë për të bërë sidomos tani përsa i përket ligjit të barazisë gjinore në shoqëri që është I vjetër dhe ka nevojë urgjente që të ndryshohet. **OJF nr 3**

***- A mendoni se shteti ndan burime të mjaftueshme, njerëzore dhe financiare, për zbatimin e politikave/masave/programeve ?***

Nevojiten të rriten burimet njerëzore dhe financiare, për zbatimin e politikave/masave/programeve. **OJF nr 1**

Unë do thoja që ndryshe nga disa vjet më përpara që shteti pothuajse nuk ndante fare kur vjen puna për programet për dhunë në familje por ndante deri në atë periudhë vetëm për viktimat e trafikimit, tani sigurisht që ka filluar ta bëjë këtë gjë, ka filluar ta bëjë me mbështetjen e qendrave kombëtare si Linja e këshillimit për gra dhe Vajza apo ALO 116 që është linja e fëmijëve apo streha për komunitetin LGBT, ndërsa pjesën tjetër e realizon npm financimit të fondit social që pastaj i alokohet bashkive …. A është kjo e mjaftueshme, sigurisht që nuk është e mjaftueshme dhe sigurisht që duhet të ketë shumë më teper burime financimi dhe alternativa për të mbështetur të gjitha këto programe. **OJF nr 2**

Jo, nuk ndan burime të mjaftueshme as për zbatimin e politikave as për masat e programeve për parandalim sidomos për rehabilitim dhe riintegrim. Nuk ndan burime të mjaftueshme, një shqetësim kryesor i yni është që strategjia kombëtare për këtë cështje që po flasim ne mbulohet në 60% të saj dhe kjo përqindje është kryesisht nga donatorët ndërkombëtarë dmth kërkohet nga ndërkombëtarët që të mbulohet një strategji kombëtare dhe kjo nuk është fare serioze dhe tregon që nuk janë alokuar burime të mjaftueshme të të gjitha llojeve. **OJF nr 3**

Mendoj që jo, janë të pamjaftueshme sidomos në aspektin financiar. Mendoj që duhet të ketë më shumë programe rehabilitimi sepse strehëzat, nuk dua ti quaj kështu por mendoj që nuk janë mjaftueshëm duke parë dhe sfidat që ne hasim në punën tonë të përditshme. **OJF nr 4**

*- Si e kuptoni rolin/rëndësinë e Komitetit GREVIO ?*

Shumë të rendesishem, sepse kerkon te ndermerren masa progressive nga shteti shqiptar ne zbatim te Konventës së Stambollit. **OJF nr 1**

Është një rëndësi e madhe në kuptimin që njerëzit që formojnë komitetin grevio janë njerëz që janë ekspertë të pavarur, ata zgjidhen nga komiteti i palëve të Këshillit të Europës në Strasburg, kështu që roli I tyre nga ana tjetër është totalisht i rregulluar me një kornizë ligjore që parashikon detyrat edhe cilësitë që duhet të ketë një anëtar i komitetit Grevio. Deri tani Komiteti i Grevios konsiderohet edhe nga Këshilli i Europës si një nga Komitetet më të suksesshme me raporte shumë të detajuara dhe me detyra shumë të qarta edhe specifike për secilin prej vendeve që ka kaluar fazën e monitorimit. **OJF nr 2**

Komiteteti Grevio ka rol të rëndësishëm jo vetëm monitorues por edhe shtytës nëse mund të themi kështu sa I takon zbatimit të detyrimeve që i jane vendosur shtetit shqiptar pikërisht nga ky komitet. Është komitet që kërkon nga shtete që të vendosin masa të rëndësihme por gjithashtu do të dija të ritheksoja dhe njëherë rolin që mbase duhet ta rishikojnë, mënyrën se si i monitorojnë dhe "detyrojnë" shtetet që të përmbushin kriteret e tyre, pra nuk mund të vazhdohet më me praktikën që ky komitet i përgatit në raport për shtete të caktuara dhe i jep sugjerime dhe rekomandimet e tij. Megjithëse një nga rekomandimet thotë WW URGE STATES që do të thotë i kërkojmë urgjent shteteve, ose dëshirojmë të ngremë vëmendjen e shteteve në mënyrë urgjente që të zbatohen 1 2 3 4 5 masat më poshtë, kjo nuk ka qenë e mjaftueshme deri tani të paktën për shtete si I yni por edhe rajonale jo vetëm për Shqipërinë. Kështu që duhet të shikojmë pak rolin e tyre edhe detyrimet që duhet të kenë ata si komitet. **OJF nr 3**

Grevio ka patur një rol të rëndësishëm me komentet dhe rekomandimet që ka bërë në 2018. Mesa di unë këtë vit do mblidhen sërish pasi bëhet një herë në 4-5 vjet kjo si procedurë. **OJF nr 4**

***- A mund të tregoni për një progres specifik të bërë që nga miratimi i raportit/rekomandimeve të komitetit GREVIO në fushën e mirëqenies sociale/veprimit policor/hetimit/ndjekjes...?***

Ngritja e qendres LILIUM për viktimat e dhunes seksuale; (set up rape-crisis centres and/or sexual violence referral centres in the frameëork of a multi-sectorial response targeting the community at large, aiming at breaking the existing taboos in regard to sexual violence and encouraging reporting) (paragraph 110);, *https://rm.coe.int/reccomendation-cop-albania/1680783ffa )* **OJF nr 1**

I përmenda unë ato cilat janë ndryshimet që kanë ndodhur dhe ndryshimet ligjore që kanë ndodhur në korrik të 2018 dhe në nëntor të 2020. Të dyja kanë të bëjnë me rekomandimet e Komitetit Grevio që kane lidhje dhe me hetimin e dhunës në familje, ndryshimi i fundit psh I nëntorit 2021 kishte lidhje me forcimin e mekanizmit që policia ta largojë nga banesa dhunuesin në momentin që kemi të bëjmë me një rast dhune. **OJF nr 2**

Progres specifik është ai më sipër që përmendëm në fushën e legjislacionit, një tjetër mund të jetë ky komenti që ne kemi bërë Grevios gjithë këto vite në lidhje me ndihmën ekonomike, këtë për viktimat e dhunës megjithëse është trefishuar dhe shteti e përmend gjithandej si një arritje shumë të madhe dhe sukses. Është me rol vendimtar dhe ndryshon jetën dhe mirëqenien sociale sidomos të viktimave të dhunës por edhe për njerëzit në përgjithësi. **OJF nr3**

Progres specific them se me rekomandimet e Grevios ka pasur progress pasi kemi pasur rekomandime që shteti dhe ligjzbatuesit është dashur ti marrin parasysh. **OJF nr 4**

***- A janë lehtësuar/përmirësuar ndonjëherë procedurat tuaja për shkak të Konventës së Stambollit? A i jeni referuar ndonjëherë një dispozite të veçantë të Konventës në marrjen e një vendimi ? Kur ?***

Po, në litigim dhe litigim strategjik. **OJF nr 1**

Patjetër, sepse gjithë pjesa që ka lidhje me pjesën juridike ti i referohesh elementëve të konventës, I referohet më tepër pjesës së legjislacionit vendas. Kur ti e ndërton legjislacionin vendas në parimet e Konventës së Stambollit faktikisht i ke në të njëjtën mënyrë të zbatuara. **OJF nr 2**

Procedurë specifike: nga ana e Konventës ose Grevios ka procedura të caktuara, bëjnë takime konsultative me qeverinë, me shoqëinë civile. Ne kemi dhënë gjithmonë edhe inpute me shkrim lidhur me situatën aktuale të grave dhe jemi takuar duke dhënë periodikisht aq sa e ka Grevio. **OJF nr 3**

Siç edhe e përmenda pak më lart, fokusi I punës sonë në organiztë ka lidhje me të drejtat e fëmijëve, dhe Konventa e Stambollit nuk është se na përputhet shumë me atë që ne duam të bëjmë. **OJF nr 4**

***- A ju kujtohet ndonjë veprim/procedurë specifike në lidhje me Konventën ?***

Po, jemi njohës të shkelqyer te Konventës se Stambollit. **OJF nr 1**

Ndërtimi i qendrës Lilium p.sh., patjetër që u ndërtua sipas procedurave specifike që parashikon KS. Deri në atë moment ne nuk kishim asnjëherë një qendër që të merrej drejt për së drejti me viktimat e dhunës seksuale aq më tepër një qendër që është e ndërtuar dhe qëndron pranë qendrës spitalore Nënë Tereza, ashtu sic e parashikon dhe konventa sepse ideja është për krijimin e një One Stop Shop për viktimat e dhunës seksuale në mënyrë që ti mos ta bësh viktimën të tregojë disa herë atë që ka përjetuar dhe shërbimet ti marrë të gjitha njëherësh që në këtë rast është qendra Lilium. **OJF nr 2**

Po, kemi qenë pjesë e procedurës, jemi ndjerë të përfshirë nga procedura që përdor Grevio nëpër vende por sic e thashë duhet rishikuar ajo pjesa pavarësisht se ne e kuptojmë që është thjesht një komitet që del me rekomandime po mbase në vendet si tonat kështu funksionon. Roli i monitoruesve ndërkombëtarë duhet të jetë pak më i fortë edhe detyrues, do thoja.
**OJF nr 3**

***- Në çfarë mënyre institucioni juaj kontribuon në zbatimin e Konventës së Stambollit? Si kontribuoni në zbatimin e Konventës së Stambollit ?***

Në të gjitha menyrat, duke i referuar ne litigim standardet e Konventes se Stambollit, duke i përdorur per lobim, duke i perdorur ne advokaci; **OJF nr 1**

Fakti që ne menaxhojmë Linjën Kombëtare për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, do të thotë që është kontributi ynë në zbatimin e KS. Pra ne menaxhojmë një linjë që është 24 orë në 7 ditë të javës sipas asaj që parashikon KS duke ofruar jo vetëm mbështetje psiko-emocionale, terapi edhe këshillim viktmave por edhe duke ju ofruar atyre facilitate dhe ndihmë ligjore, shoqërim në gjykatë edhe referimin në shërbime të tjera. **OJF nr 2**

Institucioni jonë së fundmi, përsa i takon të gjitha anëtarëve të rrjetit, e di shumë mirë që janë të gjitha me eksperiencë të konsiderueshme, i kemi parë dhe dosjet e tyre, janë të gjitha konfidencuale, kanë status profesional të gjitha duke përfshirë këtu psikologe, jurist, kujdestare sociale, punonjëse sociale dhe është gjithcka sipas protokolleve të konfidencialitetit dhe ruajtjes së të dhënave, pra brenda ligjit. **OJF nr 3**

***- A keni pasur ju apo institucioni juaj një mundësi për të kontribuar në raportimin mbi zbatimin e Konventës? Në çfarë mënyre ?***

Po, kemi raportuar për GREVIO dhe për Komitetin e Palëve te Konventes se Stambollit si organizate si edhe si Rrjeti i Monitorimit Kunder Dhunes me Baze Gjinore. *https://rm.coe.int/albania-report-the-monitoring-netëork-against-gender-based-violence-co/1680a4681f* **OJF nr1**

Patjetër, sepse ne gjithmonë kemi qenë pjesë e përmirësimit të legjislacionit që bëhet për ta përafruar atë me udhëzimet dhe nenet e konventës. **OJF nr 2**

Vetëm në kuadër të Rrjetit të Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, aty është bërë diçka e përbashkët. Ata kontribuojnë se e kanë pjesë të tyre esenciale. **OJF nr 4**

***- Si i mbledh, klasifikon dhe ruan institucioni juaj të dhënat: lloji i dhunës, gjinia, mosha e viktimës/ dhunuesit, marrëdhënia, vendi, numri i urdhrave të ndalimit dhe mbrojtjes, shkeljet e urdhrave të mbrojtjes, ndalimi, dënimet, heqja e të drejtave prindërore/ kufizimi i të drejtave prindërore, kujdestaria...?***

Po, te gjitha te dhenat per rastet e dhunes ne familje ruhen ne nje database te rasteve te mbeshtetura me ndihme ligjore falas per parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ne familje. **OJF nr 1**

Ne kemi një database, e cila funksionon prej shumë kohësh, kështu që kjo është dhe mënyra se si ne i ruajmë dhe klasifikojmë të dhënat për të gjitha viktimat që marrin shërbim këshillimi tek linja e këshillimit për gra dhe vajza. Edhe të gjitha funksionojnë sipas kësaj tabele që ju keni këtu në të njëjtën formë. **OJF nr 2**

Organizatat e grave sidomos jo vetëm organizatat e shoqërisë civile kanë qenë pionere në këtë drejtim dhe kanë qenë ndër të parët që kanë bërë ruajtjen dhe klasifikimin e të dhënave, sugjerimin dhe kërkesën më të fortë për shtetin shumë vite më parë që të krijohet një program i posacëm që të ruhen të dhenat e klasifikuara. Por sic e di të paktën egziston një format I tillë, dhe kjo ka qenë një kërkesë që lidhet direct edhe me kërkesat që kërkon ky komitet por edhe shoqëria civile në fillim fare kanë ushtruar presion që të jetë. Ndërsa ne me ato pak projekte që kemi ofruar të shërbimit ligjor falas për Tiranën dhe jo vetëm, po edhe për ato zona që nuk punojnë I kemi të dhënat konfidenciale që ruhen nga profesionistët në rastin tonë nga juristja edhe asnjëherë nuk I ndajmë … madje ne kemi brenda organizatës, kjo si informacion shtesë, kemi si aneks kontratën e punës që mirë do ishte ta kemi të gjitha dhe do ta ndajmë dhe me ju për të cilin firmoset për konfidencialitetin e të gjithë të dhënave që ti shikon në organizatë, jo vetëm për rastet që nuk diskutohet për përfitueset por edhe për të dhëna të rëndësishme për organizatën sic mund të jenë projekte ose informacione të ndryshme që për organizatën janë asset dhe është e rëndësishme. **OJF nr 3**

Të gjithë institucionet, organizatat e shoqërisë civile, pra të gjithë ne kemi metodat tona, mënyrat tona se si I ruajmë dhe klasifikojmë të dhënat në varësi të punës dhe shërbimit që ne ofrojmë. Kemi një sistem brenda organizatës sonë ku bëjmë ruajtejn dhe klasifikimin e të dhënave të cilat më pas i raportojmë, dërgojmë në institucione të tjera. **OJF nr 4**

***- A mbani mend/ mund të paraqisni ndonjë masë në lidhje me ndryshimin e qëndrimeve, normave për reduktimin e dhunës ? Keni marrë pjesë ?***

Po, kemi pergatitur një studim per ndrydhimin e mendësive te profesionisteve që punojnë për dhunen ne familje dhe forma te tjera te dhunës me baze gjinore. **OJF nr 1**

Kemi marrë pjesë në mënyrë aktive, pothuajse në të gjitha masat, në të gjitha ndryshimet, në të gjitha sugjerimet e mundshme që janë dhënë dhe janë bërë nga shteti shqiptar. Ne dhe organizojmë trajnime, të gjithë anëtarët e rrjetit marrin pjesë në trajnime. **OJF nr 3**

Patjetër që ne si organizata të shoqerisë civile ku në fokus kemi dhunën, ndër vite jemi përpjekur ta minimizojmë atë duke advokuar për ndryshimin e qëndrimeve të komunitetit. Do thoja për dhunën seksuale, e cila më herët ka qenë një tabu dhe do diskutohej psh midis një gazetari dhe një personi tjetër pa e ndarë me të tjerët, publikun, sot mund të them që kjo është ndryshuar. Tani kjo është një temë që preket më gjërë nga shoqëria jonë, edhe pse duhet ta them që nuk është se kemi ligje specifike për dhunën seksuale dhe këtu ka Akoma gjëra për të berë. **OJF nr 4**

***-Sa shpesh merrni pjesë në trajnime ? Në cilat tema ? Keni material edukativ ? Cilat tema mungojnë ?***

Përdorimi i Konventës së Stambollit si mjet real. **OJF nr 1**

Tani, ne më tepër japim trajnime. Megjithatë trajnime për stafin bëjmë gjithmonë për të përmirësuar cilësinë dhe njohurotë brenda stafit, sepse e gjitha kjo është një fushë që është në evolim, nuk mund të pretendosh që e ke trajnuar para 10 vitesh dhe ta lësh me aq. Dhe kjo është një process që është ongoing. Kështu që dhe temat janë të ndryshme në fakt sepse psh gjëja që po bëjmë ne tani është një nga gjërat që ka lidhje me dhunën online, është një gjë e re dhe stafi ka nevijë të trajnohet. Ne kemi bërë shumë trajnime gjatë tre viteve të fundit për gjëra që kanë lidhje me dhunën online. **OJF nr 2**

Sa shpesh merrni pjesë në trajnim…unë do thoja shpesh, tematikat janë të ndryshmë më gamë të gjërë sigurisht dhuna me bazë gjinore mbizotëron. Ne mundohemi që dhe t'i ndërthurim dhe t'i përfshijmë tematika që së fundmi lidhen shumë ndjeshëm me cështje të barazisë gjinore, ndryshimet klimaterike, mjedisi, gratë në vendimmarrje në politikë. Për mendimin tim ekspertet më të mira janë strukturat përgjegjëse sic mund të them këtu specialistët ose ekspertët e ministrisë për cështje të caktuara administrative ose civile sa i takon llojit të shërbimeve, problematikave dhe zbatimit të strategjisë si është bërë, për legjislacionin etj **OJF nr 3**

Ne marrim shpesh pjesë në trajnime për shkak edhe të natyrës së punës që kemi. Temat janë të ndryshmë por të gjitha me rëndësi të madhe dhe sigurisht që kanë material edukativ, informues. Tani tek temat që mungojnë do përmend sërish dhunën seksuale. **OJF nr 4**

***- Sipas mendimit tuaj, kush është në gjendje të ofrojë trajnimet më të mira për Dhunën me Bazë Gjinore në Shqipëri ? Pse ?***

Qendra per Nisma Ligjore Qytetare ka nje ekspertize shume te larte ne fushen e dhunes me baze gjinore dhe dhunes ne familje. **OJF nr 1**

Unë mendoj që përgjithësisht organiztat që ofrojne shërbime janë edhe ato qe ofrojnë edhe trajnimet më të mira sepse nuk kanë vetëm pjesë teorike por edhe praktike nga eksperienca që ato kanë në dhënien e shërbimit për viktimat. **OJF nr 2**

Sa i takon trajnimeve informuese, ndërgjegjësuese dhe rreth tematikës së gjërë të barazisë gjinore unë do thoja organizatat e grave që janë eksperte dhe kanë një eksperiencë të gjatë prej më shumë se 20 vitesh. **OJF nr 3**

Trajnimet më të mira i ofrojnë organizatat e shoqërisë civile, ekspertët që ata kanë, trajnuesit e tyre. Përsa i përket shtetit më duhet të them që nuk i ofron fare këto trajnime, nuk ka as kushtet dhe as njerëzit e përshtatshëm për të trajnuar. **OJF nr 4**

***-A ka ndonjë mekanizëm multidisiplinar për mbrojtjen nga Dhuna me Bazë Gjinore i parashikuar në Konventën e Stambollit (grupi i punës, protokollet, udhëzuesit) ?***

Po, Mekanizmat e Koordinuar të Referimit të rasteve te dhunes ne familje ne nivel bashkie, te cilat funksionojne bazuar ne protokolle te miratuara. **OJF nr 1**

Patjetër ka një mekanizëm, që është neni 10 i Konventës dhe që flet për mënyrën e koordinimit të punës për të ndihmuar viktimat e dhunës, edhe sigurisht aty tani nuk i mbaj mend me detaje rekomandimet që ka dhënë Grevio për shqipërinë. Ka një mekanizëm multidisiplinar që ekziston në të gjitha bashkitë e vendit, kemi një vendim të këshilli të ministrave që detyron të gjitha bashkitë e vendit që të kenë mekanizmin e referimit të viktimave. Praktikisht në letër e kemi atë që funksionon dhe që është ndërtuar në cdo njësi të qeverisjes vendore. Edhe protokolle për këtë punë sigurisht që ka. **OJF nr 2**

Kanë mekanizma, kanë grup pune, protokolle, udhëzues, janë të gjithë këto ekzistojnë, cështja e vetme sic e dimë shumë mirë vazhdon mbetet tek zbatimi. Kemi mekanzima të mira që funksionojnë në bashki të ndryshme, pavarësisht edhe buxhetimit por ngelen gjithmonë në vullnetin, dëshirën dhe ndërgjegjësimin e punonjësve të caktuar që janë pjesë e këtyre grupeve të punës. **OJF nr 3**

Patjetër që ka një mekanizëm ku bëhet dhe referimi i rasteve në varësi të problematikës që kanë për të marrë dhe ndihmën e nevojshme. Ka mekanizma, grup pune, udhëzues të ndryshëm. **OJF nr 4**

***- Si e kuptoni dhe aplikoni qasjen e ndjeshme gjinore në punën me të mbijetuarat e dhunës (duke i dhënë përparësi sigurisë, qasja e përqendruar te viktima, fuqizimi ...)***

E aplikojme qartë kete qasje, duke konsideruar faktin se viktimat e dhunes me baze gjinore perballen me dhunen per shkak se jane gra. **OJF nr 1**

***Po ne vetëm qasje gjinore kemi dhe flasim.*** **OJF nr 2**

Ne jemi nga ato organizata që e kemi përmendur dhe përfshirë për herë të parë në protokollet tona këtë lloj terminologjie, këtë qasjen e ndjeshme gjinore, çështjet gjinore në përgjithësi. Kështu që kuptojmë dhe e aplikojmë sidomos sa I takon fuqizimit të viktimës ose të ish viktimës së dhunës. **OJF nr 3**

Qasja e ndjeshme gjinore...duhet të kishim nje gender mainstreaming, por nuk mund të them se e kemi aq mainstream sa duhet. **OJF nr 4**

***- A merren institucionet e sistemit në mënyrë të përshtatshme me sigurinë e viktimave ? Në çfarë mënyre ?***

Po, institucionet e sistemit punojne ne zbatim te legjislacionit kunder dhunes ne familje dhe VKM Nr. 327, datë 2.06.2021 PËR MEKANIZMIN E BASHKËRENDIMIT TË PUNËS NDËRMJET AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE PËR REFERIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE, SI DHE PROCEDIMIN E TIJ PËR MBËSHTETJEN E REHABILITIMIN E VIKTIMAVE TË DHUNËS. Efektiviteti nevojitet te permiresohet. **OJF nr 1.**

Këtu gjithmonë ka nevojë për të përmirësuar, sepse patjetër që ka institucione që e marrin këtë gjë seriozisht dhe e bëjnë në mënyrën e duhur por ka edhe institucione që jo gjithmonë e marrin seriozisht dhe I mungon trajnimi I nevojshmë ose janë njerëz që ndryshohen në vendin e punës dhe skanë trajnimin e duhur. Sigurisht që ka institucione që I përgjigjen në mënyrë adekuate sigurisë së viktimave po ka edhe vende ku patjetër sistemi calon.**OJF nr 2**

Nuk merren me sigurinë, ne kemi probleme me sigurinë. Jemi në vitin 2023, çështja e sigurisë është problem më vete, sistemi i mbrojtjës nuk funksionon sic duhet dhe ne kemi parë jo vetënm siguria e viktimave por edhe siguria e shtetasve shqiptarë në përgjithësi këtë periudhë është e cënuar ndjeshëm. **OJF nr 3**

Në momentin që ne kemi një rast, i cili ka nevojë për shërbime të tjera të caktuara të cilat ne nuk mund t'ia ofrojmë, patjetër që I drejtohemi institucioneve relevante. Pra këtu funksiono sistemi I referimit, dhe këto institucione më pas bëjnë punën e tyre, në mënyrë adekuate apo jo kjo ngelet për diskutim. **OJF nr 4**

***- Cilat procedura përdoren në punën me të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore/dhunës seksuale/përndjekjes/...?***

Për rastet e dhunës në familje që kerkojnë mbrojtje perms urdhrave te mbrojtjes zbatohet legjislacioni civil për mbrojtjen nga dhuna ne familje si ligji nr.9669, date 18.12.2006, "Per masa ndaj dhunës ne marredheniet familjare", i ndryshuar dhe aktet e tij nenligjore. Rastet e raportuara ne polici referohen per ndjekje penale. Në lidhje me mbrojtjen permes legjislacionit penal zbatohen procedurat e parashikuara ne Kodin e Procedures Penale. **OJF nr 1**

I ka të parashikuara KS, por i ka të parashikuara dhe legjiskacioni shqiptar me të njejtat forma sic I parashikon dhe konventa**. OJF nr 2**

Ka procedura, ka protokolle, duke filluar që me plotësimin e urdhërit të mbrojtjes ose urdhërave të menjëhershëm të mbrojtjes, në rast se përfituesja vendos të denoncojë rastin ka protokolle brenda strehezave afatgjata, protokolle dhe standarde që duhen zbatuar brenda strehëzave të emergjencës. Sa I takon dhunës seksuale, nuk janë shërbime të mjaftueshme, këtu ne kemi një qendër që është qendra Lilium, për minorenë e pamjaftueshme sepse është 72 orë. Kështu që ka nevojë urgjente për shërbime për sa i takon dhunës seksuale, përndjekja pastaj është një nga problematikat që ne kemi, është e njohur me ligj, dënohet me ligj por është shumë e vështirë nga eksperiencat që kemi, nga eksperienca që kanë edhe jurist në rrjetin tonë e para të vendosin 5 persona të denoncojnë për arsye të ndryshme të mentalitetit, turpit etj, e dyta ta vërtetosh përndjekjen në varësi të provave që kërkon prokuroria, gjykata dhe ky kalvar i gjatë i bën këta persona që edhe të tërhiqen, kështu që me këtë përndjekje duhet të merremi ne në mënyrë urgjente**. OJF nr 3**

Secili prej nesh ka procedurat, standardet dhe protokollet e veta besoj. Ne kemi hapjen e dosjeve me të dhënat e fëmijëve në rastin tonë, me shërbimet që I ofrojmë, nevojat specifike që ata kanë, pra cdo gjë të nevojshme dhe të gjitha këto ruhen në databazën tonë. **OJF nr4**

***- Në çfarë mënyre i referoni të mbijetuarat e dhunës tek shërbimet e specializuara të ndihmës dhe mbështetjes ? Si e informoni të mbijetuarën për të drejtat dhe shërbimet e saj ? Cilat janë kriteret ?***

Mënyra se si i referojmë sigurisht që ka lidhje me atë krijimin e një zinxhiri shërbimesh që ne I ofrojmë vikimave të dhunës, qofshin ato dhunë ndaj grave apo dhunë në familje. Tani gjithmonë kemi një check list që I informojmë të mbijetuarat të cilat janë të drejtat që ato kanë dhe cilat janë shërbimet që mund ti ofrohen duke filluar në bazë të identifikimit të nevojave që bëhët në bazë të rastit. Ka njerëz që kanë nevojë për bonus qeraje po ka dhe njerëz që nuk e kanë këtë nëvojë, ka njerëz që duan mbështetje ligjore, ka njerëz që nuk e duan kete. Keshtu që kjo bëhet rast pas rasti bazuar në nevojat që kanë. **OJF nr 2**

Referimi bëhet nëpërmjet një sistemi të mirëfilltë, funksional referimi dhe çdo organizatë e njeh sistemin e referimit e di shumë mirë ku do drejtohet për të mos thënë që shpeshherë ne jemi ato të cilat na referohen raste dhe jo anasjelltas kështu që sa I takon ofrimit të informimit të të mbijetuarës ka standardet që secila organizatë si I informon, cilat janë info që I jep edhe cilat janë rregullat që një punonjës social dhe psikolog ndjek në këto raste dhe ka dhe kritere të caktuara, lista është shumë e gjatë **OJF nr 3**

Në bazë të nevojave dhe specifikave që këta të mbijetuar kanë. Ndërsa të drejtat dhe shërbimet që ne mund ti ofrojmë I bëhen të ditura që në fillim kur ata paraqiten pranë ambienteve tona. **OJF nr 4**

***- Me cilat shërbime të specializuara bashkëpunoni ? Cilat procedura përdorni për të lidhur të mbijetuarën me këto shërbime ?***

Bazuar në detyrimet qe na burojne nga ligji, ne referojmë çdo rast prane koordinatores vendore kunder dhunes ne familje ne bashkine perkatese**. OJF nr 1**

Ne jemi pjesë e mekanizmit të referimit në disa bashki të vendit sigurisht dhe tek bashkia e Tiranës dhe kjo është mënyra si ne bashkëpunojmë me të gjitha shërbimet, edhe mënyra se si diskutohen rastet kështu që prcedurat janë totalisht të qarta sipas VKM për krijimin e mekanizmit të referimit në njësitë e qeverisjes vendore. **OJF nr 2**

Shërbime të specializuara të gjitha, që në shërbimin ligjor, shërbimin psikologjik, emocional … Përdorim systemin e referimit, kontaktet, shpeshherë dhe kontaktet personale dhe mekanizmin, procedurat dhe rregullat që ka përcaktuar VKM për funksionimin e mekanizmit vendor kështu që janë aty të gjitha. **OJF nr 3**

Kemi bashkëpunime të mira do thoja me institucione të ndryshme që ofrojnë shërbime të ndryshme relevante për rastet që ne kemi. Për këto bashkëpunime kemi marrëveshje të firmosura nga të dyja palët. **OJF nr 4**

***- A kanë grupet vulnerabël akses të barabartë në këto shërbime? Po të mbijetuarat që nuk i përkasin kategorive vulnerabël ? Cilat zgjidhje janë zgjidhjet më të zakonshme për ta ?***

Aksesi në sherbime sigurohet permes bashkive perkatese apo permes sherbimeve te ofruara nga OJF ne nivel vendor dhe kombetar. Keto sherbime jane te vlefshme per te gjitha te mbijetuarat e dhunes ne familje dhe formave te tjera te dhunes me baze gjinore, me nje focus te vecante tek grupet e margjinalizuara. **OJF nr 1**

Kur ti je e mbijetuar dhe je viktimë patjetër që je vulnerabël, nëqoftëse do flitet p.sh., për minoritetet sic janë grupet romë, egjiptianë, me aftësi të kufizuara etj., etj., nuk është i barabartë aksesi për to, sepse ti ke shumë shërbime që nuk kanë një njeri me karrige me rrota që t'i aksesojë shërbimet, duke filluar që nga kjo pjesë; patjetër që ka grupe vulnerabël të cilët nuk kanë akses të barabartë. **OJF nr 2**

Grupet vulnerabël nuk akses të barabartë në këto shërbime. Nëse përmendim këtu komunitetin LGBT, komunitetin rom e egjyptian apo grupe të tjera të komunitetit janë të destinuara të diskriminohen shpesh herë do thoja nga të gjithë por shpeshherë edhe nga shërbimet sociale jo nga ne se organizatat e kanë parim dhe nuk bëjnë ndasi të tilla. Shërbimet sociale vendore, shërbimet e policisë, prokurorisë, gjykata këto ne I ndeshim në jetën e përditshme edhe të mos jemi pjesë e kësaj pune që bëjmë ne e dimë shumë mirë që nuk ka akses do thoja të barabartë. Nuk është I barabartë si aspect do thoja për të gjithë grupimet ose minoritetet. Zgjidhjet më të zakonshme janë npm njohjeve personale, duhet të telefonojmë njerëz që njohim në mënyrë që ti marrin në konsideratë, ndërkohë që nuk ka nevojë, sepse kemi gjithë ligjet që ekzistojnë për të drejtat e njeriut dhe nuk ka nevojë që të përdorim metoda të tilla. **OJF nr 3**

**T**ë gjithë e dimë që aksesi nuk është i barabartë për kategori të ndryshme. Pra ka një ndarje dhe diferencim jo vetëm gjinor, por edhe ne varësi të etnicitetit që kanë. Dhe këto grupe janë përherë pre e diskriminimeve të ndryshme. Sidomos ata që I përkasin komunitetit LGBT që ne e dimë shumë mirë reagimin dhe mënyrën si I trajton komuniteti. **OJF nr 4**

***- Cilat janë masat për reduktimin e barrierave ligjore dhe praktike ?***

Mbështetje per të mbijetuarat, ofrimi i nje seti sherbimesh dhe qasje e koordinuar sepse nese qasja nuk eshte e koordinuar dhe nuk ofron siguri per te mbijetuarat dhe ne te njejten kohe mbeshtetje dhe shernbime ato demotivohen dhe nuk perdorin mjetet ligjore**. OJF nr 1**

Në këtë pjesë unë do thoja që Shqipëria e ka pasur të suksesshëm, sepse nuk është se nuk kemi ligje të mira, unë mendoj që ne kemi probleme me implementimin e ligjeve dhe zbatimin e tyre në praktikë. Nuk mendoj që ka barriera ligjore mendoj që më tepër ka barriera zbatimi.**OJF nr 2**

Legjislacioni është i plotë, kemi ligje antidiskrimin, ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, kemi ligj për dhunën, kemi kushtetutën që të gjithë personat janë të barabartë dhe të gjitha këto janë masa ligjore që reduktojnë barriera të ndryshme, barriera ligjore dhe praktike. Për reduktimin e barrierave praktike unë do përmendja një VKM që ka nxjerrë kryeministri të fundit,

në vitin 2021.VKM më e fundit që ka nxjerrë ministria në lidhje me zbatimin e mekanizit mund të gjendet dhe online, ajo është një masë e mirë sepse kur vjen nga kryeministria merret pak më seriozisht. Dhe kjo e përforcon atë VKM që kishte dalë për funksionimin e mekanizmit, ka masa të rëndësishme aty brenda dhe rekomandime që ne I kishim sugjeruar dhe I kërkojmë psh me systemin e nënpunësit gjinor me patjetër, edhe disa gjëra të tjera që mua mu duk atëherë sikur u mor pak më seriozisht për faktin që erdhi si masë nga kryeministria. **OJF nr 3**

Ligjet i kemi, fatmirësisht për këtë dhe fatkeqsisht nga ana tjetër që nuk kemi një zbatim të plotë të tyre për të gjitha sa diskutuam më lart. Pra mendoj që barrierat më të shumta ne i kemi në zbatimin e këtyre ligjeve. **OJF nr 4**

# X. PYETSORËT

Në fillim u bë formulimi i pyetsorëve në bazë të grupeve dhe detyrave të tyre funksionale. U pregatit një model pyetsori me 27 pyetje për OJF-të, nje tjetër me 48 pyetje për kordinatorët vendorë të dhunës në çdo bashki si dhe për njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në bashki, një pyetsor me x pyetje në kancelaritë e gjykatave në të gjithë shqipërinë si dhe me Prokuroritë në të gjithë Shqipërinë.

Nje model tjetër pyetsori me 45 pyetje iu dërgua specialistëve të dhunës në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve në 12 Drejtoritë Vendore të Policisë në Shqipëri. Pyetësorët u punuan dhe ruajtën në Google Forms.

Disa herë u kemi telefonuar dhe u kemi kërkuar me mirësjellje të plotësojnë pyetsorin, pasi që të arrihej studimi duheshin patjetër 60 pyetsorë të plotësuar në platformën online.

Nga 35 pyetsorë të dërguar në 61 bashkitë në vend vetëm 28 bashki e plotësuan pyetsorin, nga 12 pyetësorë për t'u plotësuar nga specialistë të dhunës në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve në 12 Drejtoritë Vendore të Policisë në Shqipëri vetëm 6 prej tyre e plotësuan, nga 19 OJF- 24 përfaqësues e plotësuan. Nga gjykatat e ka plotësuar vetëm Gjykata e Shkallës së parë Elbasan dhe nga Prokuroritë e ka plotësuar vetëm Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan

| Nr | Institucioni | Nr i pyetsorëve të dërguar | Numri i pyetsorëve të plotësuar | Shënime |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bashki | 35 | 28 | |
| 2 | OJF | 19 OJF | 24 | E kanë plotësuar më shumë se një person në disa OJF |
| 3 | Polici | 11 | 6 | |
| 4 | Prokurori | 2 | 1 | |
| 5 | Gjykate | 22 | 1 | |

## PYTESORI I PLOTESUAR NGA BASHKITË, OJF të dhe SDHFMF

**Sipas njohurive tuaja, Shqipëria:**

a) firmosi konventën e Stambollit c) nuk e firmosi

**b)** e firmosi dhe e ratifkoi d) nuk e ratifikoi

Përgjigjet janë si më poshtë sipas intstitucioneve që e kanë plotësuar





**BASHKITË**

Vetëm 64.29 % e personave që kanë plotësuar pyetsorin nga strukturat e bashkive kryesisht KDHF, NJMF apo NBGJ, kanë informacion në lidhje me datën kur Shqipëria e ka firmosur dhe ratifikuar Konventën e Stambollit.





**OJF-të:**

Kanë 100% informacion të saktë ato OJF që kanë plotësuar pyetsorin për datën kur Shqipëria e njohu dhe më pas e ratifikoi Konventën e Stambollit.





**SDHFMF:**

Nga 12 specialistë të dhunës në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve në 12 Drejtoritë Vendore të Policisë në Shqipëri, e kanë plotësuar pyetsorin 7 prej tyre dhe kanë informacion të saktë për datën kur Shqipëria e ka firmosur dhe ratifikuar Konventën e Stambollit

***- Në çfarë mënyrë/deri në çfarë mase zbatohen standartet/masat/detyrimet e Konventave në Shqipëri ?***

Për këtë pyetje përgjigjet janë si më poshtë:

## BASHKITË:

21.43% ose pjesa më e madhe mendojnë që standartet zbatohen por ka nevojë për përmirësim.



**OJF-të:**

33.34% shprehen që bazuar në rekomanidimet e GREVIO-s , Shqipëria ka përmirësuar dukshëm legjislacionin e brendëshëm.



**SDHFMF:**

33.33% pjesa dërmuese, shprehen që bazuar në rekomanidimet e GREVIO-s , Shqipëria ka përmirësuar dukshëm legjislacionin e brendëshëm .



***- A mendoni se shteti ndan burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për zbatimin e politikave.masave/programeve?***

**BASHKITË:**

39.29% e personae` që kanë plotësuar petsorin` shprehen që jo shteti nuk ndan burime të mjatueshme njerzore apo inanciare ą̊



***- Si e kuptoni rolin e komitetit  GREVIO?***

**BASHKITË:**

28.57% shprehen që GREVIO është një organ që monitoron shtetet që kanë irmosur` dhe ratifikuar Konventën si zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga kjo konventë.



**SDHFMF:**

në olicì  shprehen 50% që GREVIO është një grup ekspertësh që lerëson`  masat e marra për dhunën ndaj grae`  dhe dhunën në amilje` dhe 50% shprehen se është mekanizëm i rëndësishëm që realizon monitorimin e masae`  të marra. ë`  njejtin opinion ndajnë dhe OJF-të që kanë plotësuar pyetsorin.



***-A jeni njohur me rekomandimet e komitetit GREVIO për forcimin e zbatimit të Konventës? Nëse po, a keni patur mundësi t'i lexoni ato?***

**BASHKITË:**

46.43 % shprehen se kan patur mundësi të njihen dhe t'i lexojnë rekomandimet e grupit të ekspertëve GREVIO

Në fakt nga kjo pyetje me strukturat e pushtetit lokal prisnim që % të ishte shumë më e lartë, pasi MSHMS e ka të publikuar në faqen e saj të ëeb këtë raport. Rezulton që këto struktura nuk e kanë këtë informacion ose nuk e kan lezuar megjithëse e dinin që ky dokument ishte i aksesueshëm



***- A mund të tregoni për një progres specifik të arritur që nga miratimi i raportit/ rekomandimeve të komitetit GREVIO në fushën e mirëqënies sociale/veprimit policor/hetimit/ …Ndjekjes ?***

**BASHKITË:**
35.71% nuk kanë informacion për ndonjë progres specifik të bërë që nga miratimi i raportit apo rekomandimeve të Komitetit GREVIO, ndërkohë që ka të tjerët njohin ndryshimet ligjore që ka pësuar ligji i dhunës, Hartimi i Strategisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2021-2030, ndryshimi I MKR.

Konkluzion: mbasi Komiteti Grevio pregatit raportin mbi zbatimin e rekomandimeve adresuar shqipërisë Nga komiteti i palëve Të Konventës së këshillit të evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit) ky raport duhet t’ë punohet me të gjithë KDH që rë njohin situatën në vënd dhe sidomos me rekomandimet e lëna për përmirësim të situatës pasi janë pikërisht këto struktura që duhet të zbatojnë detyrat në nivel local



***-A janë lehtësuar/përmirësuar ndonjëherë procedurat tuaja për shkak të Konventës së Stambollit ? A i jeni referuar ndonjëherë ndonjë dispozite të veçantë të Konventës në marrjen e një vendimi ? Kur ?***

**BASHKITË:**

28.57 % shprehen se janë lehtësuar lehtësuar dhe përmirësuar proçedurat për shkak të Konventës së Stambollit, por 10.71% shprehen se këto proçedura nuk janë lehtësuar apo përmirësuar, ndërsa 17.86% shprehen se këto proçedura janë lehtësuar/përmirësuar për shkak të legjislacionit që shteti shqiptar ka ndërmarrë mbasi e ratifikoi Konventën e Stambollit**.**



***- A ju kujtohet ndonjë veprim/procedurë specifike në lidhje me Konventën ?***

**BASHKITË:**

25% shprehen se nuk i kujtohet ndonjë veprim/proçedurë, 14.29% u shprehën për dokumentat që përdorin në punën e tyre të përditëshme, 17.86% nuk I janë përgjigjur kësaj pyetje dhe vetëm 3.57% kujtonin proçedurën për vlerësimin e rriskut



**SDHFMF:**

Përgjigjet e tyre janë të ndara në 33.33% për një shprehje e lartë e mbrojtjes së jetës së vajzave, 33.33% trajtimi pa paragjykim dhe diskriminim të të viktimave të dhunës, 33.33% vlerësimi i rriskut dhe menaxhimi i rastit. Siç shikohet mendimet e këtyre strukturave pranë DVP janë thothuaj të njëjta.

Konform Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 866, datë 20.12.2018" Për proçedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje" është detyrë kryesore e Policisë së Shtetit për vlerësimin e riskut që bashkëpunon me kordinatorin vendor pranë njësive përkatëse të vetqeverisjes vendore. Kur fëmijët janë viktima të dhunës së drejtëpërdrejtë në familje, bashkëpunon me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki



**OJF-të** ndajnë të njëjtin opinion në lidhje me këtë pyetje



***-Në çfarë mënyre institucioni juaj kontribuon në zbatimin e conventës së Stambollit? Si kontribuon në zbatimin e Konventës së Stambollit?***

**BASHKITË:**

17.86 % nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje. 25% zgjedhin respektimin e ligjeve në fuqi, menaxhimin e rasteve, 10.71% bashkëpunimin me institucione të ndryshme, 3.57% informimin dhe monitorimin dhe në po këtë përqindje duke I mbeshtet rastet, duke i menaxhuar ato dhe duke ju ofruar shërbime. 7.14% KDH I referon rastet në institucionet e tjera që kanë detyrimin ligjor për t'i mbështetur. Janë 3.57% e rasteve që shprehen se nuk kanë informacion. Me siguri janë punonjës të rinj në bashki që kryejn funksionin e KDH, NJMF apo NBGJ.



**SDHFMF:**
50% thonë që çdo punonjës policie ka një protokoll komunikimi dhe 50% shprehen që zbatojnë detyrimet sipas masave të ligjit duke marrë masat e nevojshme për parandalim



OJFtë-shprehin opinione të ndryshme. 20.83% nuk shprehen. Ndajnë % të barabarta 8.33% përmes ofimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse,përmes dhënies së rekomandimeve, duke lobuar dhe advokuar, dedikuar në luftën kundër trafikimit të qënieve njerzore,mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të viktimave përmes progranmeve të informimit, edukimit, advokimit dhe shërbimeve sociale residenciale dhe komunitare, duke informuar komunitetin për ndryshimet ligjore dhe keshillimin ligjor falas për njerzit në nevojë, fushata ndërgjegjësimi me burra gratë rinj të reja dhe institucione vendore, me nxënës dhe student, trajnim të institucioneve vendore si antarë të MKR,mbrojtjen e të mbijetarave në gjykatë me avokat falas etj



***- A keni pasur ju apo institucioni juaj një mundësi për të kontribuar në raportimin mbi zbatimin e Konventës? Në çfarë mënyre ?***

**BASHKITË:**

28.57% shprehen se kanë kontribuar por nuk japin asnjë informacion në lidhje me nëyrën si kanë kontribuar. 17.87% nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje,17.86% thonë nuk kanë informacion dhe 35.71% thonë shkurt jo.



***- Si i mbledh, klasifikon dhe iruan institucioi juaj të dhënat (lloj i dhunës, gjinia, mosha e viktimës, marrëdhënia, vendi, numri i të mbrojturave, shkeljet e urdhërave të mbrojtjes, ndalimi, dënimet, heqja e të drejtave prindërore/kufizimi i të drejtave prindërore, kujdestaria…)***

**BASHKITË:**

25% përmendin sistemin Revald,17.86% përmes databasit, 14.29% përmes dosjeve personale të hapura , 10.71 % përmes statistikave . vetëm 3.57 % e tyre shprehen se nuk kanë informacion për mënyrën si mblidhen, klasifikohen dhe ruhen të dhënat



**OJF-të:** nuk kanë informacion dhe nuk I janë përgjigjur kësaj pyetje reth 29.17% e personave që kanë plotësuar pyetsorin, 41.67% shprehen se ruhen në database të organizatës, 12.50% nëpërmjet formularëve të këshillimit/identifikimit të nevojave të rasteve, ndërsa me ;

4.17% nëpërmjet formateve të vlerësimit

4.17% nëpërmjet kodeve përkatëse

4.17% skeda e përfituesit , e cila përfshin gjeneralitetet , histrokikun dhe ndërhyrjen specifike

4.17% organizata nuk mbledh të dhëna të tilla



***-A mbani mend/a mund të paraqisni ndonjë masë në lidhje me ndryshimin e qëndrimeve, normave për reduktimin e dhunës? Keni marrë pjesë?***

**BASHKITË:**

7.14% nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje por dhe 28.57% nuk mbajnë mënd ndonjë ndryshim qëndrimi, norme,14.29% plotësojnë trajnimet dhe takimet sensibilizuese, 7.14 % bashkëpunimin me organe të ndryshme që merren me rastet e dhunës, si gjykatat etj



**OJF-të:**

- 8.33% shprehen për ndryshimet që ka pësuar ligji i dhunës,po kaq shprehen për ndryshimet që ka pësuar kodi penal sidomos neni 130/a, 12.50 realizimi i trajnimeve dhe i sesioneve sensibilizuese, 37.50% dhe 12.50% nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje ose nuk mbajnë mënd dhe nuk mund të paraqesin ndonjë masë në lidhje me ndryshimin e qëndrimeve,normave për reduktimin e dhunës.



**-Sa shpesh merrni pjesë në trajnime ? Në cilat tema keni material edukativ ? Cilat tema mungojnë ?**

**BASHKITË:**

35.71 % shprehen se kanë pjesë në trajnime ku janë trajtuar tema për dhunën në familje,mbrojtjen e fëmijëve, trafikimin e qënieve njerzore por nuk japin informacion për trajnime konkrete të organizuara



**OJF-të:**

29.17% shprehen që marrin shpesh pjesë në trajnime, 16.67% shprehen që marrin pjesë pothuaj çdo muaj në trajnime, 8.33 % shprehen se temat për të cilat kanë ndjekur trajnimet kanë qenë për dhunën me bazë gjinore, trafikimin e qënieve njerzore, edukimin seksual, 20.83% shprehen se marrin pjesë shpesh në trajnime, 8.33% kanë thënë sipas aktiviteteve të parashikuara nga donatorët që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve të stafit. Ndërsa 16.67 % nuk janë përgjigjur.



***- Sipas mendimit tuaj, kush është në gjendje të ofrojë trajnimet më të mira për dhunën me bazë gjinore në Shqipëri ? Pse ?***

**BASHKITË:**

71,43% mendojnë që organizatat e ndryshme janë në gjëndje të ofrojnë trajnimet më të mira për dhunën me bazë gjinore në Shqipëri,17.86% mendojnë që MSHMS dhe të tjerët me 3.57% mendojnë për mekanizma joshtetërorë që mund të klasifikojmë përsëri OJFtë sidomos ato OJF që prej vitesh merren me dhunën në malije dhe dhunën me bazë gjinore, 3.57% përsëri shprehen për organizata të ndryshme dhe 3.57% shprehen për shërbimin social



**OJF-të:**

20.83% nuk kanë dhënë opinionin e tyre në lidhje me këtë pyetje dhe kjo tregon që personi që e ka plotësuar është I ri/e re në organizatë apo vetë OJF nuk ka marrë trajnime të ndryshme, 16.67% shprehen për institucionet përkatëse, po 16.67% trajnimet janë organizuar me ekspertë me përvojë nga vëndi por dhe nga jashtë vëndit sidomos nga vënde europiane; 12.50% shprehen për rrjetin AWEN të mbështetur nga Qeveria Suedeze përmes Sida si dhe Forumi I Gruas Elbasan një OJF me 23 vite eksperiencë në fushën e shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës, po 12.50% shprehen që trajnime me ekspertë nga vëndet europiane me përvojë kanë ndikuar dhe do të ndikonin pozitivisht në punën e përditëshme. Vetëm 4/17% shprehen se nuk dinë cfarë të thonë.



***- A ka ndonjë mekanizëm multidisiplinor për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore, i parashikuar në Konventën e Stambollit? (grupi i punës, protokollet, udhëzuesit) ?***

**BASHKITË:**

me përjashtim të 7.14% të personave që kanë plotësuar pytsorin që janë shprehur nuk e di, të tjerët në total 92.86%i njohin mirë këto mekanizma si MKR, ETN, GTN etj. Personat që e kanë plotësuar këtë pyetsor jnë KV në Bashki apo NJMF dhe NBGJ. Sipas VKM Nr 321 dt 2 qershor 2021, MKR përbëhet nga:

- Komiteti Drejtues që drejtohet nga Kryetari I Bashkisë, ky komitet është organ vendimarrës
- Ekipi Teknik Multidisiplinar që drejtohet nga KV
- Kordinatore Vendore



**OJF-të:**

rreth 70.84% e personave që kanë plotësuar pyetsorin njohin MKR, ETN, GTN. Nuk japin informacion të detajuar në lidhje me protokollet, udhëzuesit. Bien në sy dhe % e lartë e personave që nuk njohin mekanizmin multidisiplinar. Kjo tregon që një pjesë e mirë e OJFve që nuk e kanë këtë informacion dhe punojmë me të drejtat e njeriut sidomos me të mbijetuarat e dhunës në familje duhet të trajnohen.



***- Si e kuptoni dhe aplikoni qasjne e ndjeshme gjinore në punën me të mbijetuarit e dhunës ? (duke i dhënë përparësi sigurisë, qasja e përqendruar te e mbijetuara, fuqizimi*** ...)

**BASHKITË:**
Nisur nga eksperienca e tyre e përditëshme personat që e kanë plotësuar pyetsorin shprehin opinione të ndryshme nisur dhe puna e tyre e përditëshme dhe detyra funksionale që ato kanë për të mbijetuarat e dhunës. Pjesa dërmuese 21.43% shprehin mendimin për ri-integrimin e të mbijetuarave të dhunës në shoqëri, 17.86% për fuqizimin ekonomikme 3.57% janë shprehur për:

a) përfshirjen institucionale
b) trajimin me profesionalizëm nga ana e ETN-së
c) strehim dhe mbështetje sias nevojave
d) përkushtimi për të zbatuar protokollet në mbrojtje dhe mbështetje të rastit
e) mirqenien e saj fizike dhe emocionale

Përsëri të bie në sy fakti që 7.14% dhe 3.57% shprehen që nuk e kuptojnë dhe nuk e aplikojnë qasjen e ndjeshme gjinore në punën me të mbijetuarat

**Konkluzioni:** Duhet bërë trajnimi i strukturave shtetërore që merren me dhunën në familje në nivel vendor.



**OJF-të**:

- me 12.50% shprehen per sigurinë e të mbijetuarës dhe po kaq % për riintegrimin e saj; janë shprehur me 8.33% a) për ofrimin e një ambjenti të sigurtë për të mbijetuarën, b) qëndrimet, besimet dhe modelet e sjelljes së punonjësve që trajtojnë viktimat e dhunës luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e rasteve, c)ështëe rëndësishme të kemi në qëndër të vëmëndjes faktorin"gjini" viktima në qëndër, ç) nëpërmjet programeve rezidenciale dhe komunitare. Është interesant përgjigja nuk janë target I organizatës me 4.17%. Jemi munduar në përzgjedhjen e OJF-va që bëjnë shërbime për të mbijetuarat e dhunës në familje, të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut. Janë 29.17% që nuk janë përgjigjur fare dhe 8.33% që shprehen nuk kam informacion.



***- A merren institucionet e sistemit ligjor në mënyrë adekuate me sigurinë e të mbijetuarve ? Në çfarë mënyre ?***





Nuk i japin përgjigje kësaj pyetjeje: 7.14% nga struktat e bashkisë dhe 20.83% nga OJF-të.30.14% nga strukturat e bashkisë shprehen se institucionet e sistemit ligjor merren në mënyrë adekuate me sigurinë e të mbijetuarës, të njëjtin opinion ndajnë dhe 29.17% e të anketurëve nga OJF të. 12.50% e OJF-ve shprehen qe institucionet e sistemit nuk merren në mënyrë adequate në të gjithë rastet. Po kështu shprehen dhe 10.71% e strukturave të bashkisë.

***-Çfarë procedurash përdoren në punën me të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore/dhunës seksuale/përndjekjes ?***

**BASHKITË:**

35.71% shprehen për protokollet standarte të veprimit, 14.29% për mbështejen psiko-sociale, 10.71% për identifikim dhe më pas menaxhim i rastit, 10.71% për strehim social Si e kemi thënë në prezantimin e elgjislavionit qeveria shqiptare ka pregatitur disa procdura standarte veprimi sidomos të aplikueshme në situata emergjente dhe për sektorin e shëndetësisë.7.14% shprehen me pagesën e parashikuar nga qeveria si e mbijetuar dhune dhe që brënda një viti qeveria e rriti trefish atë. Me 3.57% janë shprehur për:asistencë sociale, protokolenga ministria e shëndetësis dhe ajo që bie në sy është fakti 3.5% e punonjësve të Bashkisë nuk I njohin këto procedura sepse nuk kanë patur raste, po kaq 3.57% shprehen nuk e di.

**Konluzioni:** është shumë e çuditshme përse bashkitë në vend nuk kanë raste apo eksperienca me të mbijetuarat e dhunës në familje, por dhe nëse kjo gjë ndodh tek disa punonjës bashkie pasja e procedurave dhe njohja e tyre është detyrim ligjor.



**SDHFMF** shprehen:
50% kanë proçedura standarte të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit
16.7% protokolli imenaxhimit të rasteve të dhunës familje në nivel vendor përmes MKR
16.7% udhëzim i prokurorit të Përgjithëshëm
16.7% protokoll i menaxhimit të rasteve të dhunës seksuale për të rritur në nivel vendor



**OJF-të:**

20.83% dhe 4.17% nuk kanë plotësuar ose nuk kanë informacion. Pjesa tjetër njohin Protokollin e Menaxhimit të Rasteve të Dhunës në Familje në nivel vendor, MKR, VKM etj.



***- Në çfarë mënyre i referoni të mbijetuarat e dhunës tek shërbimet e specializuara të ndihmës dhe mbështetjes ? Si e informoni të mbijetuarën për të drejtat dhe shërbimet e specializuara të ndihmës dhe mbështetjes ? Si e informoni të mbijetuarën për të drejtat dhe shërbimet e saj ? Cilat janë kriteret ?***

**BASHKITË:**

17.87% e personave shprehen se të mbijetuarat informohen për cdo gjë për të drejtat dhe për përfitimet, 4.29% e tyre shprehen se bashkëpunojnë me zyrat që ofrojnë shërbime, me OJF të, 14.29% nëpërmjet mekanizmitkombëtar të referimit MKR dhe Ekipeve Teknike Ndërdisiplinore , (ETN) 10.71% shprehen se i referojnë në shërbimet e nevojshme bazuar në nevojat e tyre, 7.14% përdorin marveshjet që kanë nënshkruar me institucione të ndryshme qeveritare dhe me OJF që bëjë shërbime, 3.57% shprehen se nuk kanë sistem referimi. Megjithëse janë vetëm 3.57% që nuk kanë informacion përsëri është shqetësuese pasi janë struktura shtetërore dhe kanë detyrimin ta informojnë dhe ta orientojnë të mbijetuarën drejt shërbimeve të specializuara të ndihmës dhe mbështetjes



**OJF-të:**

Të bën përshtypje që 37.50% e OJF ve nuk i është përgjigjur kësaj pyetje, pra nuk kanë informacion mbi mënyrën si referohen të mbijetuarat e dhunës drejt shërbimeve të specializuara të ndimës dhe mbështetjes

**Konkluzion:** duhen bërë trajnime të OJF-ve që merren me shërbime për të mbijetuarat e dhunës për hapat që duhet të ndjekin në ciklin e punës me të mbijetuarat e dhunës deri në riintegrimin e tyre



***-Me cilat shërbime të specializuara bashkëpunoni? Cilat procedura përdorni për të lidhur të mbijetuarën me këto shërbime?***

**BASHKITË:**

100% e tyre shprehen për institucionete ndryshme me të cilët bashkëpunojnë si drejtoria e Shërbimit Social, Kordinatoren Vendore të Dhunës conform VKM 321 dt 02.06.2021, Zyrën e Punës, Policinë, Gjykatën, OJF të që ofrojnë këshillim psikologjik, juridik, strehim, MKR etj



**OJF-të:**

12.50% nuk kanë informacion, 20.83% nuk janë përgjigjur fare. Të tjerët në 16.67% për sejcilin rast shprehen se bashkëpunojnë me:

- KV të Dhunës në Bashki dhe NJMF; dhe të gjithë antarët e MKR
- Me OJF-të dhe Strehëzat Kombëtare
- Drejtorinë Vendore të Policisë në çdo bashki; Gjykatën e Rrethit Gjyqsor
- Shërbimet shëndetësore, arsimore, të punësimit



***-A kanë grupet vulnerabël akses të barabartë në këto shërbime? Po të mbijetuarat që nuk i përkasin kategorive vulnerabël? Cilat zgjidhje janë zgjidhjet më të zakonshme për ta?***





Si Bashkitë 67.86% ashtu dhe OJF 62.50% shprehen për aksesin e barabartë që grupet vulnerabël kanë në shërbime. Shumë pak nga bashkitë dhe 12.50% nga OJF të nuk kanë informacion. Shumë nga SDHFMF nuk janë shprehur për këtë pyetje dhe për shumë pyetje të tjera.

***-Cilat janë masat për reduktimin e barrierave ligjore dhe praktike ?***

Konstatohen një numër i madh si nga bashkitë ashtu dhe nga OJF të që nuk japin përgjigje për këtë pyetje. Është një çështje me shumë interes për të mbijetuarat e dhunës për të reduktu barrierat ligjore por sidomos dhe ato praktike. Kemi patur raste që pagesat e UMM/UM nuk janë bërë në kohën e duhur, kërkohet e mbijetuara me UM të paraqitet çdo tre muaj në administratën shtetërore kur UM mund të jetë me afat 1 vjeçar.etj. Është detyrë e administratës shtetërore në rradhë të parë që ti reduktojë këto barriera por dhe OJF të që merren me shërbime duhet ti vënë para përgjigjësisë strukturat shtetërore për mos zbatim korrekt të legjilacionit në fuqi.

Ndryshe shprehen SDHFMF në Polici mbi 33% e vlerësojnë shumë njohjen e kornizës ligjore, 33.33% shprehen se ofrimi I ndihmës së menjëhershme për viktimat e dhunës në familje dhe po 33.33% shprehen për rëndësinë e organizimit të trajnimeve për zbatimin në praktikë të ligjeve, akteve nënligjore në zbatim të tyre si dhe të detyrimet që çdo institucion ka në zbatim të tyre.




28. Cilat janë masat për reduktimin e barrierave ligjore dhe praktike?
Kodi penal
Nuk kam informacion


28. Cilat janë masat për reduktimin e barrierave ligjore dhe praktike?

***- A kryejnë apo kërkojnë gjyqtarët procedurën e vlerësimit të riskut ?***

Si bashkitë 50 % dhe OJF të 33.33% , SDHFMF 29.17% shprehen PO, gjyqtarët nisur nga ndryshimet e fundit ligjore sidomos Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 866, datë 20.12.2018" Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje" e kërkojnë për çdo rast. Të bën përshtypje 29.17% e rasteve të policisë që nuk japin informacion apo nuk I janë përgjigjur kësaj pyetje.




29. A kryejnë apo kërkojnë gjyqtarët proceduren e vlerësimit të riskut?
Jo
Nuk kam informacion
Po


30. A kryejnë apo kërkojnë gjyqtarët proceduren e vlerësimit të riskut?
Jo
Nuk kam informacion
Po

**NENI.51:**

***- A ekzistojnë mjete detyruese të standartizuara, të përdorura nga institucionet dhe në çfarë mase aplikohen ato për vlerësimin e riskut (për vrasje, sulme të përsëritura?)***

17.86% nuk i përgjigjen dhe 21.43% shprehen qe nuk kanë informacion nga Bashkitë. E njëjta situatë është edhe me OJF të të cilat 41.67% nuk japin asnjë informacion ndërsa 8.33% shprehen nuk kanë informacion. Kanë informacion 21.43% nga Bashkitë dhe 37.50% nga OJF-të. Ky është një tregues për nevojën për t'u trajnuar sidomos strukturat e policisë por dhe KDH, NJMF nga njëra anë, por dhe e OJF-ve nga ana tjetër për tju kërkuar këtyre strukturave të zbatojnë detyrimet ligjore.






***- Si e vlerësoni bashkëpunimin me shërbimet e specializuara të grave përsa i përket vlerësimit të riskut?***

37.50% e OJF-ve nuk shprehen, po ashtu dhe 14.29% nga strukturat e bashkisë. Sipa udhëzimit të përbashkët të dy ministrive në momentin e plotësimit të riskut policia dhe strukturat në bashki me të cilët bashkëpunon, mund të bëjnë vendosjen e menjëherëshme të viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence për viktimat e dhunës në familje deri në marrjen e vendimit nga gjykata; 83.33% SDHFMF shprehen që mund të asistojnë në vlerësimin e rriskut, ndërsa 16.67% shprehen nuk kemi shërbime të specializuara për gratë.

Konform legjislacionit të dhunës në fuqi OJF të e grave nuk kanë detyrimin ligjor për plotësimin e rriskut. Ka eksperienca positive te OJF ve të grave që kanë punësuar avokat për UM dhe e asistojnë të mbijetuarën që nga momenti I denoncimit të dhunës në polici dhe deri tek marrja e vendimit të gjykatës dhe futja në sistmin e ndihmës ekonomike. Në proçesin e plotësimit të UM avokati bashkëpunon me policinë për të plotësuar sa më mirë jo vetëm UM por dhe raportin e rriskut




31. Si e vlerësoni
bashkëpunimin me
shërbimet e
specializuara të grave
përsa i përket vlerësimit
të rrezikut?
Te mira


31. Si e vlerësoni
bashkëpunimin me
shërbimet e
specializuara të grave
përsa i përket vlerësimit
të rrezikut?

***- A jeni njohur me rekomandimin e komitetit GREVIO për dhënien e urdhërave të menjëhershëm të mbrojtjes për të gjitha të mbijetuarat e dhunës në familje, pavarësisht nga aktakuzat nga prokurorët apo nisja e procedimeve penale nga të mbijetuarat e dhunës? Nëse po, a e zbatoni atë në praktikë ?***

Përsëri në këtë pyetje kemi një numur të madh të punonjësve si nga bashkia ashtu dhe nga OJF-të (21.43% dhe 25%) që nuk i janë përgjigjur pyetjeve, çka dëshmon që nuk kanë informacion. Në faqen e web të MSHMS-së është i publikuar një “RAPORT MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE ADRESUAR SHQIPËRISË NGA KOMITETI I PALËVE TË KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE, (KONVENTA E STAMBOLLIT)”. Ky raport, ndërmjet të tjerave jep informacion për IX urdhërat e ndalimit, kufizimit ose mbrojtjes emergjente (nenet 52 dhe 53)




Deri diku
Jo
Po

**Sipas këtij raporti çdo shtet raporton për 8 nene të Konventës.** Raportin e Shtetit Shqiptar e gjeni nw faqen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: **raporti-i-zbatimit-të-Rekomandimeve-të-KP-per-Konventën-e-Stambollit**

| | |
|---|---|
| **I.** | **Të drejtat themelore, barazia dhe mosdiskriminimi (Neni 4)** |
| 1 | A kanë ndërmarrë autoritetet tuaja masa për të siguruar që dispozitat e Konventës së Stambollit zbatohen pa diskriminim për ndonjë arsye të renditur në nenin 4, paragrafi 3, të Konventës, përsa i përket disponueshmërisë së shërbimeve dhe mbrojtjes nga agjencitë e zbatimit të ligjit? |
| 2 | A kanë ndërmarrë autoritetet tuaja masa që kontribuojnë për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave, të cilat janë ose mund të jenë të ekspozuara ndaj diskriminimit ndërsektorial? |
| 3 | Në rast se autoritetet tuaja kanë ndërmarrë masa të mëtejshme që kontribuojnë në zbatimin e rekomandimeve në lidhje me nenin 4, të cilat nuk janë mbuluar nga pyetjet më sipër, lutemi raportoni mbi këto masa këtu. |
| **II.** | **Politikat gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara të zbatuara nën përgjegjësinë e një organi koordinues të mandatuar dhe me burime të përshtatshme (Nenet 7 dhe 10)** |
| 4 | A kanë hartuar autoritetet tuaja një plan / strategji afatgjatë për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave? |
| 5 | Cilat forma të dhunës ndaj grave të mbuluara nga Konventa e Stambollit adresohen nga plani / strategjia? Ju lutemi jepni një përshkrim të shkurtër ku të tregoni specifikisht format e dhunës që nuk ishin adresuar më parë në planet ose strategjitë në nivelin kombëtar. |
| 6 | A iu kushtua vëmendje e veçantë vendosjes së të drejtave të grave viktima në qendër të të gjitha masave të planifikuara? |
| 7 | A i përfshijnë plani / strategjia dhe masat e parashikuara në to gjithë aktorët përkatës, siç janë agjencitë qeveritare, parlamentet dhe autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile? |
| 8 | A i kanë caktuar autoritetet rolin e organit koordinues një ose më shumë entiteteve të institucionalizuara plotësisht? |
| 9 | Ju lutemi specifikoni mandatin, kompetencat, si dhe përbërjen e organit / organeve koordinuese. |
| 10 | Ju lutemi specifikoni burimet njerëzore dhe financiare të alokuara për organin/organet koordinuese. |
| 11 | Nëse autoritetet tuaja kanë ndërmarrë masa të tjera që kontribuojnë në zbatimin e rekomandimeve në lidhje me nenet 7 dhe 10, të cilat nuk janë mbuluar nga pyetjet më sipër, lutemi raportoni mbi këto masa këtu. |

| | |
|---|---|
| **III.** | **Burimet financiare (neni 8)** |
| 12 | A kanë alokuar autoritetet tuaja fonde specifike në nivelin e mëposhtëm të qeverisjes, për aktivitete për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave që mbulohen nga Konventa e Stambollit? |
| 13 | A janë rritur këto fonde që nga publikimi i Raportit të Vlerësimit Fillestar të GREVIO-s? |
| 14 | A kanë marrë autoritetet tuaja masa për të rritur mbështetjen financiare afatgjatë dhe të qëndrueshme për organizatat joqeveritare që punojnë për të mbështetur viktimat dhe për të parandaluar dhunën? |
| 15 | Në rast se autoritetet tuaja kanë marrë masa të mëtejshme që kontribuojnë në zbatimin e rekomandimeve në lidhje me nenin 8, të cilat nuk janë përfshirë nga pyetjet e mësipërme, ju lutemi raportoni për këto masa. |
| **IV.** | **Organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile (neni 9)** |
| 16 | A kanë marrë autoritetet tuaja masa që kontribuojnë për të njohur më tej, inkurajuar dhe mbështetur punën e organizatave përkatëse joqeveritare dhe të shoqërisë civile aktive në luftimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave të mbuluara nga Konventa e Stambollit, përfshirë përsa i përket financimit dhe bashkëpunimit? |
| **V.** | **Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave (neni 11)** |
| 17 | Në zbatim të rekomandimit drejtuar autoriteteve tuaja, a kanë filluar sektorët e rinj të administratës mbledhjen e të dhënave në përputhje me kërkesat e nenit 11, paragrafi 1? |
| 18 | Në zbatim të rekomandimit drejtuar autoriteteve tuaja, a kanë përmirësuar sektorët e administratës mbledhjen e të dhënave? |
| 19 | A mundëson mbledhja e të dhënave statistikore nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe gjyqësori që të gjurmohen rastet e dhunës ndaj grave për të treguar |
| 20 | Përsa i përket sondazheve të bazuara në popullsi, ju lutemi jepni informacion mbi çdo sondazh të kryer që nga botimi i raportit të vlerësimit fillestar të GREVIO, si dhe specifikoni format e dhunës të mbuluara. |
| 21 | Në rast se autoritetet tuaja kanë marrë masa të mëtejshme që kontribuojnë në zbatimin e rekomandimeve në lidhje me nenin 11, të cilat nuk janë përfshirë nga pyetjet e mësipërme, ju lutemi raportoni për këto masa. |
| **VI.** | **Kujdestaria, të drejtat e vizitës dhe siguria (neni 31)** |
| 22 | A kanë marrë autoritetet tuaja masa që kontribuojnë për të siguruar që incidentet e dhunës të mbuluara nga fusha e Konventës së Stambollit të merren parasysh në përcaktimin e të drejtave të kujdestarisë dhe vizitës së fëmijëve, veçanërisht nga autoritetet gjyqësore? |
| 23 | A kanë marrë autoritetet tuaja masa duke kontribuar për të siguruar që të drejtat e vizitës nuk rrezikojnë të drejtat dhe sigurinë e viktimës ose fëmijëve? |
| 24 | Në rast se autoritetet tuaja kanë marrë masa të mëtejshme që kontribuojnë në zbatimin e rekomandimeve në lidhje me nenin 31, të cilat nuk janë përfshirë nga pyetjet e mësipërme, ju lutemi raportoni për këto masa. |

| | |
|---|---|
| VII | **Reagimi, parandalimi dhe mbrojtja e menjëhershme (neni 50)** |
| 25 | A kanë marrë autoritetet tuaja masa që kontribuojnë për të përmirësuar reagimin e shpejtë dhe të duhur të agjencive të zbatimit të ligjit, veçanërisht nga: |
| | - Rritja e trajnimit të profesionistëve të zbatimit të ligjit mbi natyrën e gjinizuar të dhunës ndaj grave dhe pasojat e saj |
| | - Sigurimi i një numri të mjaftueshëm të punonjëseve të policisë gra |
| | - Krijimi i mjediseve për të vendosur një marrëdhënie besimi midis viktimës dhe profesionistëve/profesionisteve të zbatimit të ligjit |
| | - Sigurimi i mbledhjes efikase të provave në mënyrë që mbështetja në dëshminë e viktimës të zvogëlohet |
| 26 | A kanë marrë autoritetet tuaja masa që kontribuojnë për të mundësuar identifikimin dhe analizën e kujdesshme të ndonjë dëshmie të mbrojtjes? |
| 27 | Në rast se autoritetet tuaja kanë marrë masa të mëtejshme që kontribuojnë në zbatimin e rekomandimeve në lidhje me nenin 50, të cilat nuk janë përfshirë nga pyetjet e mësipërme, ju lutemi raportoni për këto masa. |
| VIII. | **Urdhrat e ndalimit, kufizimit ose mbrojtjes emergjente (nenet 52 dhe 53)** |
| 28 | Në lidhje me urdhrat e mbrojtjes emergjente, a kanë marrë autoritetet tuaja masa që kontribuojnë për të siguruar që autoriteteve kompetente u jepet fuqia për të urdhëruar, në situata të rrezikut të menjëhershëm, një autor të dhunës në familje për t'u larguar nga vendbanimi i viktimës ose personit në rrezik, dhe që ndalojnë dhunuesin të hyjë në banesën e tij ose të kontaktojë viktimën ose personin në rrezik |
| 29 | A kanë marrë autoritetet tuaja masa duke kontribuar për të siguruar disponueshmërinë e urdhrave ndalues ose mbrojtës për viktimat e formave të mëposhtme të dhunës ndaj grave? |
| | - Dhunës në familje |
| | - Përndjekjes |
| | - Dhunës seksuale |
| | - Ngacmimit seksual |
| | - Martesës së detyruar |
| | - Gjymtimit gjenital femëror |
| | - Abortit të detyruar |
| | - Sterilizimit të detyruar |
| 30 | A kanë marrë autoritetet tuaja masa që kontribuojnë për të siguruar zbatimin efektiv të urdhrave të ndalimit, kufizimit ose mbrojtjes? |

***- A e dini nëse analiza retrospektive e feminicidit në kontekstin e dhunës në familje përdoret për të indentifikuar mangësitë sistematike me qëllim parandalimin ?***

Kanë informacion 29.17% OJF-të dhe 21.49% Bashkitë. 64.29% nga bashkitë dhe 62.50% nga OJF të nuk kanë informacion.






***- Përveç ardhjes në komisariat, a mund të denoncojë një grua dhunën? A është e mundur të dorëzohet një raport përmes kanaleve elektronike dixhitale ?***

Kjo pyetje ishte specifike vetëm për policinë dhe 66.67% shprehen që mund të përdorin numrin pa pagesë 129, duke përdorur aplikacionin Komisariati Dixhital ndërsa 33.33% shprehin po këto gjëra por shtojnë dhe punonjës social apo ndonjë punonjës tjetër. Ndëra në lidhje me dorëzimin e një raporti përmes kanaleve elektronike digjitale nuk japin asnjë informacion. Konform nenit 13 të ligjit të dhunës, kërkesën për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje mund ta paraqesin:

a) vetë viktima;

b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;

c) policia/prokuroria;

ç) personi me të cilin viktima ka marrëdhënie familjare;

d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktima, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;

dh) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Eksperienca në Shqipëri po tregon se vetëm policia e cila punon 24 orë në 7 ditë të javës plotëson të gjithë UM.



***- A keni oficerë/njësi policie të specializuara për hetimin e rasteve të dhunës në familje dhe të formave të tjera të dhunës sipas përcaktimeve nga Konventa e Stambollit ? (Dhuna seksuale, ndjekja, dhuna në internet?)***

83.33% shprehen se kanë officer të specializuar për të miturit dhe për dhunën në familje. Ndërsa 16.67% shprehen se mungojnë specialistët për krimet seksuale sipas formave të dhunës të mbuluara nga Konventa



***- A mund të përshkruani çdo masë të ndërmarrë për të krijuar besim tek oficerët e policisë dhe për të inkurajuar dhe fuqizuar të mbijetuarat që të raportojnë format e dhunës, që mbulon Konventa e Stambollit, tek autoritetet e zbatimit të ligjit ?  Jepni një shembull, duke përfshirë ato në lidhje me tejkalimin e barrierave gjuhësore dhe të specifikave të tjera për: të varurit nga droga, pakicat etnike, etj.***

50% e SDHFMF shprehen duke i trajtuar viktimën me prioritet, pa e paragjykuar, duke e mbështetur dhe inkurajuarguzimin. 16.67% duke e informuar për të drejtat dhe shërbimet që mund të përfitojë si e mbijetuar dhune .



**NENI.56:**

***- A e informojnë institucionet të mbijetuarën në rastet kur autori i dhunës lirohet nga burgu/ paraburgimi apo nëse arratiset ?***

**Bashkitë:**

25% po, OJF të 29.17% po. Bie në sy një numur i madh që shprehen jo, 64,29% nga Bashkitë dhe 62.50% nga OJF të. Rasti i ndodhur në Mars të vitit 2023, ku nje person i liruar nga burgu vret tre gra në Zonën e Paskuqanit dhe Kamzës. Nga informacionete transmetuara nga media askush nuk ishte informuar për lërimin e autorit .





***-A jeni njohur me rekomandimin e komitetit të GREVIO-s se të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore duhet t’u ofrohet ndihmë ligjore falas, duke ndërmarrë masa active për t’u siguruar që të mbijetuarat e përfitojnë këtë të drejtë? Nëse përgijgja është ‘po’, a e zbatoni atë dhe si?***

Kësaj pyetje 75% bashkitë dhe 70.85% OJF- të i janë përgjigjur pozitivisht. Skanë informacion 10.71% nga bashkitë dhe 25% nga OJF të. Është viti I tretë që Ministria e Drejtësisë ka akredituar 15 OJF në të gjithë Shqipërinë në ofrimin e ndihmës ligjore parësore falas për njerëz në nevojë ku gratë viktima të dhunës në familje janë të përfshira, dy nga këto OJF dhe janë financuar. Gjithashtu në sajë të një projekti që po zbaton UNDP me mbështetjen financiare të Ambasadës Austriake në Tiranë janë hapur në 10 qytete të Shqipërisë zyra për ofrimin e këshillimit ligjor falas për njerëz në nevojë. Objektivi është të happen në të 61 bashkitë në vënd






***- A janë të disponueshme shërbimet e mbështetjes për të gjitha të mbijetuarat, pa përjashtim?***

Bie në sy 16.67% e SDHFMF dhe 29.17% e OJF-ve që nuk i përgjigjen kësaj pyetje,ndërsa në Bashki ky numur është më i vogël 7.14%. Bashkitë 50% , OJF-të - 37.50% dhe SDHFMF 16.67% shprehen se shërbimet e mbështetjes për të gjithë të mbijetuarat e dhunës pa përjashtim, janë të disponueshme.








***-A është e mundur të sigurohet mbrojtja ndërkombëtare për të mbijetuarat nëse është e nevojshme? Jepni një shembull nga praktika juaj.***

Ligjërisht është e mundur, pasi legjislacioni shqiptar e parashikon një gjë të tillë. Para disa kohësh FGE kishte një rast të tillë. Nga ndërhyrjet që bëmë në mbështetje të të mbijetuarës konstatuam një procedurë jo korrekte në lidhje me komunikimin ndërmjet institucioneve. Për raste të tilla cdo institucion përfshirë dhe Gjykatën duhet t’i drejtohet Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe jo Drejtorisë Vendore të Policisë







***-A bashkëpunon gjykata me institucionet kompetente në procesin e vendimmarrjes për shembull në lidhje me kujdestarinë, modalitetin e të drejtave të visitës, etj? A ka ndonjë normë ligjore që e lejon këtë?***

Rreth ½ epersonave që kanë plotësuar pyetsorin I përgjigjen jo kësaj pyetje apo nuk e plotësojnë fare.vetëm një % shumë e vogël shprehen PO. Ka dhe eksperienca pozitive në Shqipëri ku OJF-të që bëjnë shërbime për të mbijetuarat punojnë me marveshje bashkëpunimi me gjykatat duke ndikuar pozitivisht në punën e të dy institucioneve por dhe të mbijetuarave të dhunës në fund të fundit





***- Si i identifikoni fëmijët e mbijetuar ndaj dhunës dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore?***

**BASHKITË:**

39.29% shprehen për referim nga institucione të ndryshme, 14.29% nga NJMF dhe KDH, me 3.57% sejcila janë: bashkëpunimi ndërinstitucional, intervistojnë fëmijët nëse kanë patur dhunë,kur paraqiten si pale e tretë në Gjykatë, me anë të nënës, nëpërmjet bashkëpunimit me aktorë të tjerë, nëpërmjet vizitave në teren , rastet që denoncohen në polici. Ndërsa 17.86% dhe 3.57% .



***- A i merr parasysh legjislacioni kombëtarformat e dhunës të mbuluara nga KOnventa e Stambollit në rastet e përcaktimit të të drejtave të kujdestarisë/vizitës? Për shembull, kur merret një vendim për kudjestarinë, jepet një opinion, apo përcaktohet modaliteti për të drejtat e vizitës?***

**BASHKITË:**

42.86% nuk e plotësojnë ose shprehen nuk kanë informacion.17.86 % shprehen po legjislacioni kombëtar i ka të përcaktuarqartë tëdrejtat e kujdestarisë/vizitës, 14.29% shprehen se realizohen vlerësimet social ekonomike dhe I vendosin në dispozicion të proçesit gjyqësor.



***- A bashkëpunon gjykata me institucionet/organizatat kompetente në procesin e vendimmarrjes në lidhje me kujdestarinë, ose modalitetin e të drejtave të visitës, etj ? A ka ndonjë normë ligjore që e lejon këtë ?***

**BASHKITË:**

42.86% shprehen se gjykata bashkëpunon. Me ndryshimet e fundit ligjore, bazuar në Nenin 10 të ligjit të dhunës .



# MASAT MBOJTËSE NDAJ DHUNËS NË FAMILJE

Gjykata, si masë mbrojtëse të dhunës në familje, urdhëron menjëherë largimin e dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktima dhe dhunuesi banojnë në të njejtën strehë. Gjykata kur është rasti, në vendosjen e kësaj mase merr në konsideratë nevojat e vecanta të dhunuesit të mitur, të moshuar ose personit me aftësi të kufizuar dhe në këto raste urdhëri I largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna.

***- Si e shmangni rrezikun që një prind jo i dhunshëm të jetë i sigurt nga vuajtja e mëtejshme e dhunës ?***

**BASHKITË:**
Përgjigjet janë: duke bërë denoncimin, duke bërë monitorim të vazhdueshëm, duke e fuqizuar individin, duke informuar instancat ligjzbatuese, duke e njohur me të drejtat dhe detyrimet ligjore, me mbështetje psikologjike, strehim, ofrim i sigurisë etj. Përsëri është një numër i madh: 21.43% e punonjësve të bashkisë që nuk i përgjigjen kësaj pyetje:



***- A janë fëmijët dëshmitëarë të dhunës të dukshë dhe të mbrojtur në sistem?***

**BASHKITË:**

46.43% shprehen që fëmijët janë dëshmitarë të dhunës dhe të mbrojtur në sistem.10.71%, në të shumtën e rasteve, NJMF marrin të gjitha masat përmenaxhimin e rastit pasi është detyra e tyre parësore, por përsëri janë 14.29% që nuk e plotësojnë, gjë që tregon se nuk kanë informacion.



***-Si merret parasysh historia e dhunës si tregues gjatë rishqyrtimit të vendimit për të drejtat e kujdestarisë/vizitës?***

**BASHKITË:**

Jepen opinione të ndryshme por ajo që bien ë sy është numri I lartë që nuk e kanë plotësuar 39.29% dhe I atyre që nuk kan informacion 10.715 dhe I atyre që nuk kanë patur praktika të tilla 3.57%.



*- Si e përcaktoni interesin më të mirë të fëmijëve në lidhje me të drejtat e kujdestarisë/vizitës ?*

**BASHKITË:**

Japin opinione të ndryshme bazuar në eksperiencën e tyre të përditëshme. Interesante përgjigja që kërkohet nivel i lartë njohurish. Fakti që dhe 39.28% nuk e plotësojnë ose shprehen nuk kan informacion apo nuk kam praktika të tilla nxjerrnevojën që këto struktura kanë nevoj për trajnime.



***- Si e vlerësoni nivelin e njohurive mbi diamikën e dhunës nga partneri në familje, duke përfshirë efektin psikologjik te fëmijët – dëshmitarë të dhunës ?***

Mbi 50% e vlerësojnë nivelin e njohurive jo të mjaftueshëm, përsëri del nevoja e trajnimeve të stafit të Bashkive sidomos të bashkive të vogla që mund të kenë dhe raste më të pakta të dhunës në familje apo për shkak të mentalitetit ende nuk e denoncojnë dhunën



***- Si e shmangni rrezikun që fëmija të jetë dëshmitar i dhunës apo të përjetojë dhunë ? A keni staf të arsimuar dhe mjediset të përshtatura për fëmijët të mbijetuar/dëshmitarë të dhunës ?***

**SDHFMF** me 50% shprehen se përmes fushatave të sensibilizimit në komunitet dhe me prindër dhe mësues, eleminojnë rrezikun që fëmija të deshmitar I dhunës, me 16.67% ndajnë opinionet intervistimin e të miturve që nuk bëhet as edhe në një rast të vetëm në prani të dhunuesit, kanë specialist për dhunën në familje që marrin shumë trajnime edhe për këtë çështje

**BASHKITË**: përveç një pjese që nuk e kanë plotësuar, pjesa tjetër ngrenë dhe problemin e mos pasjes së një stafi të arsimuar dhe sidomos mos pasjes së ambjenteve të përshtatëshme për fëmijët e mbijetuar /dëshmitarë të dhunës .





***- A jeni njohur me rekomandimin e komitetit GREVIO për marrjen masave për të siguruar përhapjen e ndërgjegjësimit për pasojat e dëmshme tek fëmijët dhe burimet e duhura për këshillimin psikosocial për këta fëmijë. Nëse po, a zbatohet ? Si ?***

32.14% shprehen po por nuk japin informacion si apo cfarë duhet bërë për marrjen e masave për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me pasojat e dëmshme të dhunës në familje tek fëmijët dhe për shërbimet që ekzistojnë në teren për këto raste.



***- A ka ngritur institucioni juaj qendra sociale të rehabilitimit për viktimat dhe si e sa e koordinon punën me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe të qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të të mbijetuarave të dhunës në familje? Nëse po, cilat janë shërbimet e mbështetura dhe sa është fondi i dhënë ?***

Vetëm 7.14% shprehen qëndra e Emergjencës 72 orëshe dhe 7.14 % shprehen po. 21.43% nukpërgjigjen dhe 42.86% shprehen jo: është një shifër që tregon për mungesën e qëndrave sociale të reabilitimit për viktimat e dhunës. Nuk jepet asnjë informacion në lidhje me fondin e dhënë. Në raportin GREVIO jepen financimet e bëra nga shteti shqiptar, por që janë krejtësisht të pamjaftueshme në lidhje me shërbimet që ekzistojnë, nevojat për shërbime të reja konform Konventës së Stambollit.



## XI. Shtojca Nr 1: Pyetsorët

# PYETESOR MBI ZBATIMIN/KUPTIMIN E KONVENTËES SË STAMBOLLIT NË MALIN E ZI, NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË.

Kjo bisedë po zhvillohet për nevojat e hulumtimit rajonal mbi nivelin e të kuptuarit dhe të zbatimit të standardeve të kërkuara nga Konventa e Stambollit në veprimet e institucioneve të përfshira në sistemin e mbrojtjes kundër dhunës me bazë gjinore.

Përgjigjet do të përpunohen dhe do të interpretohen përmes një rishikimi të përgjithshëm, në të cilin nuk do të zbulohen emra apo të dhëna personale.

**Emri i institucionit:** ___________________________
**Pozicioni:** ______________________________
**Gjinia:** ______________________________

**SEKSIONI I PËRGJITHSHËM për të gjitha institucionet**

1. Rretho përgjigjen e saktë:

Sipas njohurive tuaja Shqipëria:

a) a e firmosi Konventën e Stambollit
b) e firmosi dhe ratifikoi
c) nuk e firmosi
d) nuk e ratifikoi

2. Që kur filloi të implementohet Konventa e Stambollit në Shqipëri?

3. Cila është rëndësia e Konventës së Stambollit për Shqipërinë? Pse?

4. Në çfarë mënyre/deri në çfarë mase zbatohen standardet/masat/detyrimet nga Konventa në Shqipëri?

5. A ka nevojë Shqipëria për Konventën e Stambollit? A është legjislacioni kombëtar i zhvilluar mjaftueshëm për mbrojtjen efektive nga dhuna për gratë dhe fëmijët të mbijetuar të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje?

6. Si do t’i vlerësonit njohuritë tuaja mbi Konventën e Stambollit nga 1 në 5 ? Rrethoni.
   1 2 3 4 5

7. A mund të përmendni një ligj/akt nënligjor të ri që është miratuar/dekretuar nga shteti në përputhje me Konventën? Cila?

8. A mund të jepni një përkufizim në legjislacionin kombëtar që është ndryshuar dhe përafruar me Konventën e Stambollit?

9. A mendoni se shteti ndan burime të mjaftueshme, njerëzore dhe financiare, për zbatimin e politikave/masave/programeve?

10. Si e kuptoni rolin/rëndësinë e Komitetit GREVIO?

11. A jeni njohur me rekomandimet e Komitetit GREVIO për forcimin e zbatimit të Konventës? Nëse po, a keni pasur mundësi t'i lexoni ato?

12. A mund të tregoni për një progres specifik të bërë që nga miratimi i raportit/ rekomandimeve të komitetit GREVIO në fushën e mirëqenies sociale/veprimit policor/hetimit/ ndjekjes...?

13. A janë lehtësuar/përmirësuar ndonjëherë procedurat tuaja për shkak të Konventës së Stambollit? A i jeni referuar ndonjëherë një dispozite të veçantë të Konventës në marrjen e një vendimi? Kur?

14. A ju kujtohet ndonjë veprim/procedurë specifike në lidhje me Konventën?

15. Në çfarë mënyre institucioni juaj kontribuon në zbatimin e Konventës së Stambollit? Si kontribuoni në zbatimin e Konventës së Stambollit?

16. A keni pasur ju apo institucioni juaj një mundësi për të kontribuar në raportimin mbi zbatimin e Konventës? Në çfarë mënyre?

17. Si i mbledh, klasifikon dhe ruan institucioni juaj të dhëna (lloji i dhunës, gjinia, mosha e viktimës/ dhunuesit, marrëdhënia, vendi, numri i urdhrave të ndalimit dhe mbrojtjes, shkeljet e urdhrave të mbrojtjes, ndalimi, dënimet, heqja e të drejtave prindërore/ kufizimi i të drejtave prindërore, kujdestaria...)

18. A mbani mend/ mund të paraqisni ndonjë masë në lidhje me ndryshimin e qëndrimeve, normave për reduktimin e dhunës? Keni marrë pjesë?

19. Sa shpesh merrni pjesë në trajnime? Në cilat tema? Keni material edukativ? Cilat tema mungojnë?

20. Sipas mendimit tuaj, kush është në gjendje të ofrojë trajnimet më të mira për Dhunën me Bazë Gjinore në Shqipëri? Pse?

21. A ka ndonjë mekanizëm multidisiplinar për mbrojtjen nga Dhuna me Bazë Gjinore i parashikuar në Konventën e Stambollit (grupi i punës, protokollet, udhëzuesit)?

22. Si e kuptoni dhe aplikoni qasjen e ndjeshme gjinore në punën me të mbijetuarat e dhunës (duke i dhënë përparësi sigurisë, qasja e përqendruar te viktima, fuqizimi ...)

23. A merren institucionet e sistemit në mënyrë adekuate me sigurinë e viktimave? Në çfarë mënyre?

24. Cilat proçedura përdoren në punën me të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore/dhunës seksuale/përndjekjes/...?

25. Në çfarë mënyre i referoni të mbijetuarat e dhunës tek shërbimet e specializuara të ndihmës dhe mbështetjes? Si e informoni të mbijetuarën për të drejtat dhe shërbimet e saj? Cilat janë kriteret?

26. Me cilat shërbime të specializuara bashkëpunoni? Cilat procedura përdorni për të lidhur të mbijetuarën me këto shërbime?

27. A kanë grupet vulnerabël akses të barabartë në këto shërbime? Po të mbijetuarat që nuk i përkasin kategorive vulnerabël? Cilat zgjidhje janë zgjidhjet më të zakonshme për ta?

28. Cilat janë masat për reduktimin e barrierave ligjore dhe praktike?

29. OJF/P/GJ: A kryejnë apo kërkojnë gjyqtarët procedurën e vlerësimit të riskut?

30. Neni.51: QPS/P/PO/GJ: A ekzistojnë mjete detyruese të standardizuara të përdorura nga institucionet dhe në çfarë mase aplikohen ato për vlerësimin e riskut (për vrasje, sulme të përsëritura)?

31. QPS/P/PO/GJ: Si e vlerësoni bashkëpunimin me shërbimet e specializuara të grave përsa i përket vlerësimit të rriskut?

32. QPS/P: A jeni njohur me rekomandimin e Komitetit GREVIO për dhënien e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes për të gjitha të mbijetuarat e dhunës në familje, pavarësisht nga aktakuzat nga prokurorët apo nisja e procedimeve penale nga të mbijetuarat e dhunës? Nëse po, a e zbatoni atë në praktikë? Si?

33. QPS/p/PO/GJ: A e dini nëse analiza retrospektive e feminicidit në kontekstin e dhunës në familje përdoret për të identifikuar mangësitë sistemike me qëllim parandalimin?

34. P: Përveç ardhjes në komisariat, a mund të denoncojë një grua dhunën? A është e mundur të dorëzohet një raport përmes kanaleve elektronike dixhitale?

35. P: A keni oficerë/njësi policie të specializuara për hetimin e rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit? (dhuna seksuale, ngacmimi, ndjekja, dhuna në internet)

36. P: Përshkruani një masë të marrë për kryerjen e një hetimi dhe/ose ndjekjeje urgjente për shembull, prioritizimi i rasteve dhe analiza krahasuese e treguesve të rasteve etj.

37. P: Përshkruani çdo masë të ndërmarrë për të krijuar besim tek oficerët e policisë dhe për të inkurajuar dhe fuqizuar të mbijeturat që të raportojnë format e dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit tek autoritetet e zbatimit të ligjit?

38. P/PO: Si siguron policia mbledhjen e provave për rastet e formave të dhunës të mbuluara nga Konventën e Stambollit, përveç marrjes së deklaratës nga e mbijetuara e dhunës? A ka procedura/protokolle standarde për mënyrën e marrjes së deklaratës, udhëheqjes së bisedës, hetimit, mbledhjes së provave?

39. P/PO: Çfarë veprimesh ndërmerrni për të identufikuar dhe trajtuar faktorët që kontribuojnë në rrëzimin e disa çështjeve?

40. Neni .52. P: A janë marrë masa të reja për zbatimin më të mirë të urdhrit të policisë? A mund të qëndrojë e mbijetuara në banesën e saj derisa gjykata të japë masën?

41. GJ/PO: A janë të disponueshme masat mbrojtëse në procedimet penale për të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa?

42. Neni.56: A e informojnë institucionet të mbijetuarën në rastet kur autori lirohet nga burgu/paraburgimi apo nëse arratiset?

43. GJ: A jeni njohur me rekomandimin e Komitetit të GREVIO-s se të mbijetuarat e formave të dhunës me bazë gjinore duhet t'u ofrohet ndihmë ligjore falas, duke ndërmarrë masa aktive për t'u siguruar që të mbijetuarat e përfitojnë këtë të drejtë? Nëse përgjigja është “po”, a e zbatoni atë dhe si?

44. QPS/OJF/P/GJ: A janë të disponueshme shërbimet e mbështetjes për të gjitha të mbijetuarat, pa përjashtim?

45. QPS/OJF/P/GJ: A është e mundur të sigurohet mbrojtja ndërkombëtare për të mbijetuarat nëse është e nevojshme? Jepni një shembull nga praktika juaj.

## FËMIJËT

46. QPS/P/GJ: Si i identifikoni fëmijët e mbijetuar të dhunës dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore?

47. QPS/GJ: A merr parasysh legjislacioni kombëtar format e dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit në rastet e përcaktimit të të drejtave të kujdestarisë/vizitës? Për shembull, kur merret një vendim për kujdestarinë, jepet një opinion, apo përcaktohet modaliteti për të drejtat e vizitës?

48. OJQ/QMS/GJ: A bashkëpunon gjykata me institucionet/organizatat kompetente në procesin e vendimmarrjes në lidhje me, për shembull, kujdestarinë, modalitetin e të drejtave të vizitës etj? A ka ndonjë normë ligjore që e lejon këtë?

49. QPS/PO/GJ: Si e eliminoni rrezikun që një prind jo i dhunshëm të jetë i sigurt nga vuajtja e mëtejshme e dhunës?

50. QPS/GJ/PO: A janë fëmijët dëshmitarë të dhunës të dukshëm dhe të mbrojtur në sistem?

51. QPS/GJ: Si merret parasysh historia e dhunës si tregues gjatë rishqyrtimit të vendimit për të drejtat e kujdestarisë/vizitës?

52. QPS/GJ: Si e përcaktoni interesin më të mirë të fëmijëve në lidhje me të drejtat e kujdestarisë/vizitës?

53. QPS/P/GJ: Si e vlerësoni nivelin e njohurive mbi dinamikën e dhunës nga partneri në familje duke përfshirë efektin psikologjik te fëmijët dëshmitarë të dhunës?

54. QPS/P/GJ: Si e eliminoni rrezikun që fëmija të jetë dëshmitar i dhunës apo të përjetojë dhunë? A keni staf të arsimuar dhe ambiente të përshtatura për fëmijët viktima/dëshmitarë të dhunës?

55. A jeni njohur me rekomandimin e Komitetit GREVIO për marrjen e masave për të siguruar përhapjen e ndërgjegjësimit për pasojat e dëmshme të dëshmimit të dhunës në familje tek fëmijët dhe burimet e duhura për këshillimin psikosocial për këta fëmijë. Nëse po, a po zbatohet? Si?

## Shtojca Nr 2. Kërkesë për bashkëpunim

Si pjesë e programit rajonal "SMART Balkans", organizata SOS Hotline Për Gratë dhe Fëmijët Viktima të Dhunës Niksic, (Mali i Zi), organizata Forumi i Gruas Elbasan (Shqipëri) dhe Qendra për Mirëqenien e Gruas (Kosovë) po zbatojnë një projekt ndërkufitar të quajtur "Zbatimi i përmirësuar i Konventës së Stambollit në Rajonin e Ballkanit Perëndimor ".

Projekti kontribuon në aderimin më të shpejtë të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian:
a) duke fuqizuar OJF-të e grave për të monitoruar në mënyrë aktive zbatimin e Konventës së Stambollit;

b) duke siguruar një bashkëpunim më të fortë multisektorial ndërmjet sektorëve qeveritarë dhe joqeveritar, për mbështetje më të mirë për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, të gjitha nëpërmjet harmonizimit të kuadrit legjislativ, social dhe kulturor me standardet që dalin nga ratifikimi i Konventës së Stambollit.

Përfitues të drejtpërdrejtë të këtij projekti janë të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, OJF-të e grave, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe lokale, dhe indirekt të gjithë qytetarët e Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi.

Plani është të kryhen kërkime në 3 vende dhe të mblidhen të dhëna të besueshme nga burimet përkatëse, për të bërë një analizë realiste të situatës në kuadër të zbatimit të Konventës së Stambollit duke kryer intervista me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse të grave që përfshihen në procesin e përmbushjes së detyrimeve që shteti mori përsipër duke ratifikuar Konventën e Stambollit.

Lidhur me këtë, ju kërkojmë të lehtësoni një intervistë me Ju deri më 31 Mars 2023. Tema e diskutimit është zbatimi i Konventës së Stambollit në Shqipëri. Bashkëngjitur po ju sjellim dhe disa nga pyetjet që do të bëhen gjatë intervistës

Për çdo informacion shtesë, mos ngurroni të kontaktoni organizatën Forumi i Gruas Elbasan në numrin e telefonit: 068 485 3147, ose në adresën e emailit:
forumigruaselbasan1991@gmail.com.

PRESIDENTE Shpresa BANJA

## XII. SHTOJCA Nr 3: STRATEGJI, LIGJE, VKM, UDHËZIME, URDHËRA NË SHQIPËRI NË ZBATIM TË KONVENTËS SË STAMBOLLIT

Më poshtë po citojmë Strategji, Ligje, VKM, Udhëzime të përgatitura prej vitit 2014, kur shteti Shqiptar filloi të përgatisë bazën ligjore, duke marrë në konsideratë Konventën e Stambollit, pasi e ratifikoi atë me datë 4 Shkurt 2013.

### STRATEGJIA KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE, 2021-2030

SKBGJ 2021-2030 është e katërta e këtij lloji dhe reflekton (sikurse dhe strategjitë e mëparshme), përparësinë dhe vëmendjen e veçantë që Qeveria e Shqipërisë i kushton arritjes së barazisë gjinore, si dhe zvogëlimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kushte drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. SKBGJ 2021-2030 u hartua përmes një procesi gjithëpërfshirës e konsultues dhe u paraprì nga vlerësimi i zbatimit të SKBGJ 2016-202011 dhe planit të saj të veprimit.

### STRATEGJIA E STREHIMIT SOCIAL 2016-2020

Qëllimi kryesor i strategjisë është: "Ofrimi i zgjidhjeve të gatshme, të arritshme, të përballueshme dhe cilësore për strehim për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, që nuk mund të përballojnë një shtëpi në treg të hapur dhe, në veçanti, për familjet me tregues të pozitave të pafavorizuara që çojnë në përjashtim nga strehimi." Objektivat e strategjisë janë kategorizuar sipas katër drejtimeve strategjike, të cilat përfshijnë:

(1) sigurimin e evidencës rreth strehimit social dhe kapaciteteve vendore;
(2) përmirësimin e kuadrit ligjor, institucional, dhe rregullator;
(3) fuqizimin e instrumenteve financiare për grupet në pozita të pafavorizuara; dhe
(4) zgjerimin dhe riorientimin e programeve të strehimit social.

### STRATEGJIA KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE DHE PLANIN E VEPRIMIT 2016-2020

Parimet kryesore që udhëheqin këtë strategji janë:

→ Barazia gjinore, kusht për një shoqëri të drejtë, të qëndrueshme e socio-ekonomikisht të zhvilluar
→ Ndjeshmëri dhe trajtim i barabartë ndaj nevojave të veçanta të të dyja gjinive
→ Njohja, vlerësimi dhe respektimi i diversitetit
→ Tolerancë zero kundrejt dhunës ndaj grave e dhunës në familje Koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional

# LIGJE

**Ligji nr. 22/2018"për strehimin social"** dhe aktet nënligjore në zbatim të tij Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

"Viktimë e dhunës në familje" ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në ligjin nr. 104/2012 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"".

"Viktimë trafikimi" ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore".

"Viktimë e mundshme e trafikimit" është personi, për të cilin agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar gjykojnë se mund të jetë trafikuar dhe ka të njëjtin kuptim, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 582, datë 27.7.2011, "Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të mundshme të trafikimit".

"Vajzat nëna" janë vajzat që bëhen ose janë në pritje për t'u bërë nëna, të vetme, pavarësisht nga mosha e tyre, të cilat marrin përsipër të gjitha përgjegjësitë për të lindur dhe rritur fëmijën e tyre pa ndihmë financiare.

**Ligji nr. 62/2022, datë 21.7.2022** për regjistrin kombëtar të të dënuarve për krime seksuale "Autor i krimeve seksuale" është çdo person i dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë Për kryerjen e veprave penale të parashikuara në pjesën e posaçme, kreu II, seksioni VI

1. "Krimet Seksuale" të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

2. "Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve" është organi kompetent, i cili krijon, përditëson dhe mirëmban bazën e të dhënave që vërtetojnë gjendjen gjyqësore

3. "Drejtoria e Përgjithshme e Policisë" është organi kompetent që për qëllime të këtij ligji Do të shfrytëzojë dhe do të përditësojë me të dhëna të tjera sipas këtij ligji Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale, si pjesë përbërëse e bazës së të dhënave që vërtetojnë gjendjen gjyqësore.

4. "Drejtoria Vendore e Policisë" është organi kompetent që do të mbledhë të dhënat për regjistrimin e autorëve të krimeve seksuale.

5. "Komisariati i policisë" është organi kompetent që do të mbledhë të dhënat e përditësuara të autorëve të krimeve seksuale.

**Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 – Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013, ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 35/2020, datë 16.4.2020)**

**Neni 130/a**
**Dhuna në familje konsiderohet:**
Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune fizike, psikologjike, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim deri në tre vjet

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim deri në katër vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet burgim

**Ligji "Për strehimin social", nr. 22/2018**

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

"Viktimë e dhunës në familje" ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në ligjin nr. 104/2012 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"".

“Viktimë trafikimi” ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

“Viktimë e mundshme e trafikimit” është personi, për të cilin agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar gjykojnë se mund të jetë trafikuar dhe ka të njëjtin kuptim, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 582, datë 27.7.2011, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të mundshme të trafikimit”.

“Vajzat nëna” janë vajzat që bëhen ose janë në pritje për t’u bërë nëna, të vetme, pavarësisht nga mosha e tyre, të cilat marrin përsipër të gjitha përgjegjësitë për të lindur dhe rritur fëmijën e tyre pa ndihmë financiare.

**Ligji nr. 111/2017 datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.**

K**ategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike**

Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:
a) viktimave të dhunës në familje;
b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesit shoqëror;
d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
h) personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

## VENDIME

**VKM Nr. 806, datë 26.11.2014 për miratimin e raportit të katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave"**

Raporti IV-rt periodik kombëtar, paraqitur në zbatim të nenit 18 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), u hartua në përputhje me udhëzimet mbi formën dhe përmbajtjen e raporteve që duhen paraqitur nga shtetet palë, për periudhën kohore 2010 –2014. Raporti përmban informacion mbi zbatimin e dispozitave të Konventës dhe rekomandimeve të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, bazuar dhe në Vërejtjet Përmbyllëse (shtator 2010). Vend të rëndësishëm zënë progresi i arritur në aspektin ligjor dhe institucional, politikat e hartuara dhe vështirësitë/sfidat për garantimin e të drejtave të grave pa asnjë diskriminim.

**VKM Nr. 930, datë 18.11.2015 për miratimin e strategjisë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe planit të veprimit**

Duke qenë se ekstremizmi i dhunshëm është një dukuri bashkëkohore globale dhe, aktualisht, përbën një kërcënim serioz ndaj paqes e sigurisë ndërkombëtare, qeveria shqiptare e konsideron luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm një prej përparësive themelore të programit të saj politik.

Nxitja e një mjedisi të sigurt, bazuar në respektimin e të drejtave dhe vlerave themelore. Angazhimi i Shqipërisë për të luftuar kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.
Masat e brendshme të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimi duhet të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre brenda normave që shoqëria ka vendosur.

**Vendim nr. 430, datë 8.6.2016 "Për miratimin e standarteve të shërbimit të linjës kombëtare të këshillimit për viktimat e dhunës në familje."**

**Standarti:** Mbrojtja, siguria, e drejta për të vetvendosur dhe fuqizimi i përfitueseve
**Rezultati i pritshëm;** Përfitueseve të shërbimit iu garantohet mbrojtja, siguria dhe e drejta për të vetvendosur bazuar në parimin e fuqizimit.

**Vendimi nr.73 DT.27.01.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 27, datë 11.1.2012, të Këshillit të Ministrave, "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË FEMRAVE NGA GRUPET E VEÇANTA", të ndryshuar**

Shënim: grupe të veçanta sipas këtij vendimi janë: gratë dhe vajzat
• punëmarrësin e përfshirë, sipas këtij programi, duhet ta përfshijnë deri në gjashtë paga, në masën 115 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajin e katërt, të pestë, të gjashtë e të shtatë dhe në muajin e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës. Ndërsa, për muajt e tjerë, financon punëdhënësi.

• Punëdhënësit e rinj, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë të përfshijnë në program deri në 40 për qind të numrit të punonjësve të punësuar.
• Përfituesit e këtij programi janë gra kryefamiljare dhe vajza nëna, të cilat kanë në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç.

**VKM nr.107, datë 15.2.2017, për jnë ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 114, datë 31.1.2007, të Këshillit të Ministrave "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KONTRIBUTEVE TË PERSONAVE QË VENDOSEN NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE PUBLIKE, TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR", të ndryshuar.**

- Fëmijëve të moshës 6-15 vjeç që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 1 000 (një mijë) lekë në muaj.

- Fëmijëve të moshës 16-18 vjeç që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë në muaj.

- Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

**VKM nr. 106, datë 15.2.2017, për një ndryshim në vendimin nr.425, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR PRANIMIN E PERSONAVE NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE, PUBLIKE DHE JOPUBLIKE, TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE", të ndryshuar.**

Mosha e pranueshme për t'u vendosur në shtëpitë e fëmijës është nga 0-18 vjeç, përkatësisht, fëmijët:
a) nga mosha 0-5 vjeç vendosen në shtëpitë e fëmijës që ofrojnë shërbim të përkujdesjes shoqërore për këtë grupmoshë;
b) nga mosha 6-15 vjeç vendosen në shtëpitë e fëmijës që ofrojnë shërbim të përkujdesjes shoqërore për këtë grupmoshë;
c) nga mosha 1-18 vjeç vendosen në shtëpitë e fëmijës që ofrojnë shërbim të përkujdesjes shoqërore për këtë grupmoshë.

Riorganizimi i institucioneve të përkujdesjes shoqërore publike, të cilat do të transformojnë shërbimin sipas përcaktimeve në pikën 1, të këtij vendimi, do të realizohet brenda një periudhe 4-mujore nga hyrja në fuqi e tij.

**Vendimin me nr. 161, datë 21.3.2018 i cili vendosi të miratojë programin me pagesë të së ardhurës nga papunësia, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.**

Personave që përfitojnë të ardhura nga papunësia, u paguhet e ardhura e pagesës së papunësisë në varësi të periudhës së kontributit në sigurimet shoqërore, derdhur nga punëdhënësi, si në vijim:
a) 3 (tre) muaj, për personat me një periudhë kontributi, të paktën, 1 (një) vit;
b) 6 (gjashtë) muaj, për personat me një periudhë kontributi, të paktën, 3 (tre) vjet;
c) 9 (nëntë) muaj, për personat me një periudhë kontributi, të paktën, 5 (pesë) vjet;
ç) 12 (dymbëdhjetë) muaj, për personat me një periudhë kontributi mbi 10 (dhjetë) vjet;
d) Personat gra mbi 55 (pesëdhjetë e pesë) vjeç dhe burra mbi 60 (gjashtëdhjetë) vjeç përfitojnë pagesë papunësie 12 (dymbëdhjetë) muaj, me kusht që të kenë kontribuar 1 (një) vit në sigurimet shoqërore, për çdo rast përfitimi. Ndërsa për rastet e paraqitjes së kërkesave të përsëritura për përfitim, llogaritja e periudhës së kontributeve fillon me përfitimin e fundit të pagesës të të ardhurave nga papunësia.

Gjithashtu, vendimi parashikon edhe dokumentacionin që duhet të paraqesin personat të cilët aplikojnë për të përfituar të ardhura nga papunësia, si dhe dokumentacionin që duhet të sigurohet nga zyrat e punësimit, rastet kur personave përfitues të pagesës të së ardhurës nga papunësia u ndërpritet përfitimi, rastet për të cilat duhet të njoftojnë zyrën përkatëse të punësimit për të evituar që të kthejnë shumën e të ardhurave që kanë përfituar, të drejtat për të marrë të ardhura shtesë familjare mbi masën e nivelit bazë (ky I fundit është 50% e pagës minimale në shkallë vendi), detyrimin për tu paraqitur në zyrën e punësimit një herë në muaj për të konfirmuar prezencën ose sa herë thirret nga kjo zyrë, me qëllim punësimin e tij, si dhe rastet e përligjura kur përfituesi është i justifikuar për mosparaqitje.

Pagesa e së ardhurës nga papunësia është mujore dhe paguhet përpjesëtimisht me numrin e ditëve kalendarike, për kohën që përfituesi ka të drejtë ta marrë këtë të ardhur. Pagesa merret një herë në muaj, pranë bankës përkatëse. Periudha, gjatë së cilës përfituesi merr pagesën e së ardhurës nga papunësia, njihet si vjetërsi pune, e siguruar për efekt pensioni pleqërie, familjar dhe invaliditeti.

**Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 55, datë 6.2.2019 "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR AUTORIZIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE, QË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI".**

Organizatat jofitimprurëse japin shërbimetë ndihmës juridike parësore të garantuar ngashteti, në përputhje me autorizimin e miratuarnga ministri i Drejtësisë. Kriteret ligjore, që duhet të përmbushin organizatat jofitimprurëse që autorizohen për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, janë ato të përcaktuara në nenin 15, të ligjit nr. 111/2017"Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"

Forumi I Gruas Elbasan është njëra prej tyre

**VKM nr. 150, datë 20.3.2019, Për metodologjinë e llogaritjes s-ë fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.**

Ky vendim ka për qëllim hartimin e metodologjisë së llogaritjes së fondeve të financimit të shërbimeve sociale e të shpërndarjes së tyre nëpërmjet vendosjes së kritereve e hapave që do ndjekë procesi.
Procesi i realizimit të procedurave të financimit nga buxheti i shtetit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në nivel vendor, do të kryhet si në kuadrin e Fondit Social, ashtu dhe të transfertave të tjera, përfshirë këtu dhe financimin e shërbimeve të specializuara e unike të ofruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në nivel qarku, si dhe linjat kombëtare të këshillimit telefonik për gratë e fëmijët, që kanë marrëveshje bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale.

**VKM nr.288, datë 10.4.2020 PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE TË PROCEDURËS SË DHËNIES SË NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE PËR FOSHNJAT E PORSALINDURA DHE MËNYRËN E BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET INSTITUCIONEVE TË SHËRBIMIT SPITALOR DHE ATYRE TË GJENDJES CIVILE**

1. Ndihma e menjëhershme financiare (bonusi) për prindin/prindërit me foshnja të porsalindura është, si më poshtë vijon:
a) Në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë për lindjen e foshnjës së parë;
b) Në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për lindjen e foshnjës së dytë;
c) Në masën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për lindjen e foshnjës së tretë dhe të foshnjave të tjera në vijim;
ç) Për prindërit që sjellin në jetë dy foshnja të lindura njëherësh (binjakë), masa e përfitimit do të jetë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për secilën foshnjë;
d) Për prindërit që sjellin në jetë më shumë se dy foshnja të lindura njëherësh (trinjakë dhe më shumë), masa e përfitimit do të jetë në masën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për secilën foshnjë.
2.Në masën e ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi), të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfshihet edhe shpërblimi në masën 5 000 (pesë mijë) lekë për regjistrimin e lindjes brenda afatit,

**VKM nr. 898 datë 29.12.2021 "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.597, DATË 4.9.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR PËRCAKTIMIN EPROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT DHE MASËS MUJORE TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE PËRDORIMIT TË FONDIT SHTESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE"**

Bazuar në këtë VKM u ndryshua masa e ndihmës ekonomike për disa kategori dhe duke filluar nga data 1 janar 2022, masa e ndihmës ekonomike që përfitojnë viktimat e dhunës në familje me Urdhër Mbrojtjeje do trefishohet (pra nga 3000 lekë bëhet 9000 lekë).

**Vendim nr. 617, datë 22.9.2022 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS MUJORE TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE PËRDORIMIT TË FONDIT SHTESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE", të ndryshuar.**

Gratë kryefamiljare, përfituese në programin e ndihmës ekonomike, që kanë në përbërje të familjes deri në dy fëmijë të moshës nga 0 në 18 vjeç, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes

Përfituesit e programit të ndihmës ekonomike që kanë mbushur moshën 65 vjeç, të vetmuar, dhe nuk trajtohen me pension pleqërie apo pension social, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike.

Anëtarët e familjeve përfituese të programit të ndihmës ekonomike, që kanë mbushur moshën 65 vjeç dhe nuk trajtohen me pension pleqërie apo pension social, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes

**Vendim nr. 899, datë 29.12.2022 "PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR ZBUTJEN E IMPAKTIT TË KRIZËS".**

Përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar u jepet mbështetje financiare e menjëhershme për zbutjen e impaktit të krizës, sipas kategorive të mëposhtme:
a) familje me gra kryefamiljare, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, në masën 20,000 (njëzet mijë) lekë
b) familjet e tjera, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë;
c) familje, të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP në masën 8 000 (tetë mijë) lekë;
ç) individët përfitues të "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", në masën 8 000 (tetë mijë) lekë;
d) individët përfitues "Për statusin e të verbërit" në masën 8 000 (tetë mijë) lekë.

## UDHËZIME dhe URDHËRA

**UDHËZIM NR. 751, DATË 1.12.2022 PËR NJË MBROJTJE TË VEÇANTË NGA SHTETI PËR GRATË E PAPUNA ME TRE APO MË SHUMË FËMIJË TË MOSHËS DERI NË 18 VJEÇ**

Gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njeri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 mijë lekë bruto në muaj, të cilat janë kategori ekonomikisht joaktive, mbulohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe shëndetësor dhe pagesa e kontributeve të tyre financohet nga buxheti i shtetit, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare.

**UDHËZIM NR. 631, DATË 21.11.2022 PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËROR E NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE, PËR FËMIJËT 6-15 VJEÇ**

Rishkrimi i standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet rezidenciale, për fëmijët pa kujdes prindëror nga 6–15 vjeç, ka për qëllim të ofrojë një dimension të ri, në frymën e të gjitha ndryshimeve ligjore, në sistemin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë. Standardet plotësojnë detyrimet për zbatimin e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2015–2023 dhe ligjit nr.121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

**UDHËZIM I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE NR. 354, DATË 2.6.2022 PËR MIRATIMINE STANDARDEV PËR SHËRBIMIN E STREHIMIT EMERGJENT TË SIGURT**

Përfituesit e shërbimit të strehimit emergjent të sigurtë përfshijnë
a) çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje të shoqëruar dhe të pashoqëruar, ë abuzuar, viktima të dhunës në familje, viktima të trafikimit, viktima të mundshme të trafikimit
b) fëmijë me nevoja të veçanta (me aftësi të lehta të kufizuara)
c) të rriturit në rastet kur janë prindër të shoqëruar me fëmijët e tyre, me problem sociale, viktima të dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkolit
d) vajzat shtëzëna apo nënat fëmijë me fëmijë
e) të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit, ose që kanë dalë nga institucionet residenciale të përkujdesjes dhe kanë nevojë për shërbime përkohëshme të strehimit të sigurtë, në kushtet e marrjes në mbrojtje.

**DORËZIMI NË 30.06.2021 PRANË KOMITETIT TË PALËVE TË KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EVROPËS, PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE, I “RAPORTIT TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE ADRESUAR SHQIPËRISË”**

Ky raport përmbledh një periudhë kohore tre vjeçare (2018 - 2020) megjithatë, në disa çështje është dhënë shkurtimisht edhe informacion që përkon me gjashtë mujorin e parë të vitit 2021, për vetë rëndësinë që mund të kenë pasur zhvillimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe kohore në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Raporti u përgatit në emër të Qeverisë së

Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përmes një procesi konsultues e gjithëpërfshirës, ku u angazhuan ministritë kryesore të linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura. Informacioni i dhënë përmban edhe kontributin e organizatave të shoqërisë civile, akademisë, medias e organizatave ndërkombëtare, evidentuar përmes tryezave online të realizuara gjatë proceseve paralele për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe të politikave kryesore në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.

**AKT NORMATIV NR.7, DATË 23.3.2020 PËR QËNDRIMIN E PËRKOHSHËM NË SHTËPI TË TË DËNUARVE**

Ky akt normativ ka për objekt përcaktimin e kushteve dhe të kritereve për qëndrimin e përkohshëm në shtëpi të të dënuarve, si një leje e veçantë, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19
Ky akt normativ ka për qëllim të marrë masa të përkohshme për të parandaluar përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale si dhe mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë në sistem, nëpërmjet garantimit të kushteve për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të të dënuarve.

**URDHËR NR. 100, DATË 21.2.2020 PËR PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT (PSV) PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE NGA PUNONJËSET/ PUNONJËSIT E SHËRBIMEVE TË KUJDESITSHOQËROR, NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT SI ANËTARË TË MEKANIZMAVE TË KOORDINUAR TË REFERIMIT(MKR)**

1. Miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/ punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR), sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme ePolitikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, njësitë vendore të Kujdesit Shëndetësor, Shërbimi Social Shtetëror, drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe drejtuesit e shërbimeve shëndetësore e të mbrojtjes sociale për zbatimin e këtij urdhri.

**URDHËR I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE NR. 102, DATË21.2.2020, PËR MIRATIMIN PROCEDURATSTANDARDE TË VEPRIMIT PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE NGA PUNONJËSET DHE PUNONJËSIT E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR, NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT SI ANËTARË TË MEKANIZMIT TË KOORDINUAR TË REFERIMIT.**

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat/cilët trajtojnë rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të

Referimit (MKR), u përgatitën nën kujdesin e MinistrisësëShëndetësi së dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), me mbështetjen e Zyrës së UNFPA-së Shqipëri përmes organizatës së saj partnere në zbatim "Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin". PSV-të adresojnë çështjet që duhet të njohin dhe hapat që duhet të ndjekin punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, që në këtë rast janë parë si anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR) të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor.

**URDHËR NR. 792, DATË 20.12.2019 PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA TË KUJDESIT SHOQËROR TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET PUBLIKE, ORGANIZATA JOQEVERITARE (OJF) OSE ENTITETE PRIVATE PËR PERSONA OSE GRUPE TË RREZIKUARA OSE TË PREKURA NGA HIV/AIDS, TB DHE INFEKSIONET SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME**

Miratimin e standardeve të shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror të ofruara nga institucionet publike, organizata joqeveritare (OJF) ose entitete private për persona ose grupe të rrezikuara ose të prekura nga HIV/AIDS, TB dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij urdhri.

**MBI PLANIFIKIMIN E SIGURISË PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, NGA KOMUNITETI ROM DHE NGA KOMUNITETI LGBTI.**

Qëllimi i këtij materiali është të mbështesë institucionet përgjegjëse që punojnë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, anëtare të MKR për të forcuar kapacitetet e tyre në përgatitjen e planeve të sigurisë për viktimat e dhunës në familje nga grupet e margjinalizuara si viktimat e dhunës në familje me aftësi të kufizuara, viktimave të dhunës në familje nga komuniteti rom si edhe viktimave të dhunës në familje nga komuniteti LGBTI. Gjithashtu ai synon të rrisë aftësitë e profesionistëve në ndihmë të grave dhe vajzave të dhunuara për përgatitjen e planeve të sigurisë.

Protokolli i Menaxhimit të rasteve të Dhunës në familje në nivel vendor përmes MKR. procedurat standarde të veprimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror si dhe standardet e shërbimeve në strehëzat emergjente si edhe në qendrat rezidenciale afatgjata i kanë kushtuar një rëndësi të vecantë vlerësimit të nevojave përfshi nevojën për siguri si edhe përgatitjes së planit individual për rastet e viktimave të dhunës në familje.

**Udhëzim nr.816, dt. 27.11.2018 "PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE DHE TË FUNKSIONIMIT TË QENDRAVE TË MENAXHIMIT TË KRIZËS, PËR RASTET E DHUNËS SEKSUALE"**

Standardet e shërbimit për qendrat e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale synojnë mbrojtjen e jetës së viktimave, qofshin këta gra dhe vajza, djem e burra, fëmijë, të rritur dhe të mitur, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre, përmes një shërbimi emergjent, me një ndalesë, të integruar, 24/7, afatshkurtër (24 orë deri në 72 orë). Mbështetur në nevojate të mbijetuarve/rave, pas trajtimit emergjent, ata/ato referohen për trajtime afatgjatë pranë qendrave të specializuara.



FORUMI I GRUAS ELBASAN